

Raporti Vjetor i Monitorimit

Menaxhimi i Financave Publike

2021

Transparencë

Gjithëpërfshirje

Përgjegjshmëri

PREAMBULA

Viti 2021 nuk ishte i lehtë jo vetëm për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, por edhe për institucionet e tjera. Krizat të cilat goditën vendin tonë, tërmeti i nëntorit të vitit 2019 dhe pandemia Covid-19 vështirësuan arritjen e shumë objektivave përfshirë dhe ato të strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike, efektet e të cilave vijuan edhe gjatë vitit 2021. Shumë nga përmirësimet ligjore të nevojshme nuk arritën të finalizoheshin në kohë për shkak të masave kufizuese të Covid-19, kjo shpjegon një pjesë të vonësive të ndeshura gjatë 2021. Së fundmi, Shqipëria po përballlet me krizën energjitike dhe impaktin e rritjes së çmimeve, e cila ka filluar të japë efektet në ekonomi duke penguar arritjen e objektivave të vendosura.

Megjithatë, sfida dhe prioriteti kryesor gjatë vitit që lamë pas, ishte patjetër zhvillimi i ekonomisë dhe ofrimi i shërbimeve më të mira për qytetarët. Kjo duke rritur përgjegjshmërinë, transparencën, efikasitetin dhe disiplinën fiskale në planifikimin dhe shpenzimin e fondeve publike.

Pavarësisht sfidave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me të gjithë palët e përfshira për zbatimin e strategjisë, ka rritur përpjekjet gjatë vitit 2021 për të (i) vijuar me konsolidimin fiskal; (ii) Mobilizuar mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe doganore; (iii) Shlyer dhe parandaluar detyrimet e prapambetura; (iv) Përmirësuar menaxhimin e projekteve të investimeve publike duke përfshirë Partneritetin Publik Privat dhe dhënien me koncesione; (v) Siguruar një lidhje më të mirë të planeve strategjike me Programin e Buxhetit Afatmesëm; (vi) Siguruar një angazhim më të strukturuar dhe në kohë me qytetarët, me organizatat e shoqërisë civile dhe me akademinë në planifikimin, monitorimin dhe raportimin e buxhetit; (vii) Forcuar sistemin e monitorimit dhe zbatimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, reformimin e sistemit dhe rolin e auditit të brendshëm, nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor; si dhe (viii) Rritur përpjekjet për të përmirësuar shkallën e zbatimit të rekomandimeve dhe gjetjeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Pas devijimit të përkohshëm, të pashmangshëm dhe në fakt adekuat do thoja të devijimit nga politika fiskale konsoliduese gjatë vitit 2020 në interes të menaxhimit të krizës së pandemisë, më vjen mirë të ndaj me ju që për vitin 2021, borxhi publik si raport ndaj Produktit të Brendshëm Bruto ju rikthye sërish dhe qartësisht trajktores rënëse të tij, në përputhje me objektivat afat-mesëm dhe afatgjatë të politikës fiskale, që patjetër përbëjnë një ndër komponentët më themelor të menaxhimit të financave publike. Në vitin 2021 borxhi publik ra në 73.2% të PBB nga 74.5% që kulmoi në 2020.

Për më tepër, viti 2021 shënon një përmirësim dhe rritje të të ardhurave nga taksat dhe doganat, dhe ulje të informalitetit si pasojë e përmirësimit të vetëdeklarimit. Janë ulur detyrimet e prapambetura dhe është rritur roli mbikëqyrës i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për procesin e monitorimit të stokut të tyre duke siguruar transparencë më të lartë bazuar në informacion të besueshëm të gjeneruar nga sistemi i Thesarit.

Gjithashtu, e vlerësueshme është puna e bërë gjatë vitit 2021 për të forcuar planifikimin strategjik dhe menaxhimin e buxhetit në nivel lokal; përmirësimi i Raportit Vjetor të Ekzekutimit të Buxhetit, duke përfshirë Tregues Kyç Performance që janë në përputhje me Sistemin Informatik të Menaxhimit Financiar të Shqipërisë dhe informacionin financiar; Përfshirje më e madhe e shoqërisë civile dhe ngritja e kapaciteteve të tyre nëpërmjet organizimit të një sërë takimesh online. Përpjekje janë bërë edhe në mobilizimin e të ardhurave ku ndër të tjera është përmirësuar menaxhimi i rimbursimeve të TVSH-së.

Është përmirësuar kuadri ligjor në fushën e prokurimeve publike, si dhe tashmë është krijuar dhe po zbatohet sistemi elektronik i menaxhimit të ankesave elektronike. Progres ka patur edhe në hartimin e akteve ligjore dhe standardeve të kontabilitetit, si edhe në krijimin e një sistemi më të fortë të menaxhimit financiar dhe mjedisit të kontrollit të brendshëm. Është rritur zbatimi i rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, si edhe ka patur rritje të konsiderueshme të auditimeve financiare si pasojë edhe e interesit të lartë publik për të audituar çështje sensitive.

Megjithatë, ende ka fusha të cilat kërkojnë angazhim dhe vëmendje më të lartë për të arritur në nivelet e duhura. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me njësitë përgjegjëse do të rrisë përpjekjet për të ulur stokun e detyrimeve të prapambetura në nivel lokal me qëllim forcimin e menaxhimit financiar në qeverisjen lokale; konsultuar dhe finalizuar strategjinë afatmesme të të ardhurave; përmirësuar cilësinë e të dhënave ekzistuese për tokën, ndërtesat dhe pronarët dhe rritjen e numrit të ndërtesave të regjistruara dhe faturuara; ulur kohën e përpunimit të deklaratave doganore; rritur vëllimin total të buxhetit të ekzekutuar përmes Sistemit Informativ Financiar të Qeverisë në raport me shumën totale të buxhetit të ekzekutuar nga qeveria qendrore; regjistruar asetet publike në Sistemin Informativ Financiar të Qeverisë; rritur pranimin dhe zbatimin e rekomandimeve të auditit të brendshëm dhe të jashtëm, si edhe për të rritur auditimet e performancës.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë është përpjekur dhe synon të vendosë standarte të reja për rritjen e transparencës në planifikimin dhe shpenzimin e fondeve publike. Kjo strategji vazhdon të jetë baza e një angazhimi të plotë drejt përmirësimit të administrimit fiskal, mbledhjes së taksave dhe uljes së informalitetit në ekonomi. Strategjia siguron një sistem të përmirësuar të menaxhimit financiar, në përputhje me kuadrin ligjor dhe një nivel më të lartë kontrolli për shpenzimet publike.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë si dhe të gjitha institucionet e tjera relevante mbeten plotësisht të angazhuar në këtë proces, me vullnetin maksimal për përmbushjen e objektivave të parashikuara në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike, patjetër kjo falë edhe suportit mjaft të çmuar të partnerëve tanë ndërkombëtarë, të cilëve ju jemi shumë mirënjohës për të gjithë kontributin e tyre të dhënë në forma të ndryshme.

JU FALEMINDERIT!


Znj. Delina IBRAHIMAJ

Ministër i Financave dhe Ekonomisë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

**Niveli i arritjes
së Rezultateve**

100%



**Niveli i arritjes
së Produkteve**

OS1

Tre Ndërmarrje Shtetërore shtesë u monitoruan si pjesë e DRF

Raporti i konsoliduar mbi detyrimet e prapambetura të Qeverisë së Përgjithshme është përmirësuar më tej

Raporti i **borxhit** ndaj PBB-së **u ul** (73.2%)

PBB-ja nominale e parashikuar në krahasim me parashikimin e FMN - World Economic Outlook ishte -0.03 miliardë lekë, **15% më e ulët** se në vitin 2020.

U rrit mbledhja e të ardhurave nga DPT dhe DPD (**336.8 miliardë lekë**)

OS2

U përmirësua procesi i **rishikimit të cilësisë** për strategjitë

3 IB të reja zbatuan Buxhetim të Bazuar në Performancë.

20 OSHC janë trajnuar për BPGJ

U mbajt **Lista e Unifikuar e Projekteve**

U miratua **Dokumenti i Politikave Prioritare**

U përgatitën **udhëzuesit** për marrëveshjet e vlerësimit të investimeve

U forcua planifikimi strategjik dhe **menaxhimi i buxhetit** në nivelin e qeverisë vendore

U përmirësua norma e mbjedhjes së tatimeve në qeverinë vendore (**21.3%**)

OS3

U rrit raporti i **borxhit tatimor të mbledhur**

U përmirësua **regjistri i tatimpaguesve**.

2 sektorë të mbuluar për të reduktuar informalitetin

U përgatitën **raportet për reduktimin e informalitetit**

8 kompani morën miratimin për statusin OEA

Mbledhja e të ardhurave doganore u përmirësua në nivelin 25.7%

OS4

Integrimi **SIMBNJ-SIFQ** u realizua me sukses. Për herë të parë 45 IB mundën të ekzekutonin listën e pagave nëpërmjet SIFQ

Norma e detyrimeve të prapambetura si përqindje e shpenzimeve totale u ul në 2.2%

62 Njësi të AB kryen auditimin mbi detyrimet e prapambetura

Parashikimi i likuiditetit u përmirësua

U miratua **legjislacioni sekondar** i LPP

U krijua dhe u zbatua **Sistemi elektronik i Menaxhimit të Ankesave**

Proceset e brendshme të SIMAJ u thjeshtëzuan dhe u organizuan trajnime.

Janë zhvilluar **2 takime** për Ndhmën Shtetërore dhe është përgatitur **raporti vjetor** për vitin 2020 .

OS5

75 % të tabelave të plotësuar dhe dërguara në Eurostat

5 tabela SFQ janë shpërndarë në EUROSTAT

10 nga 39 raportet e monitorimit të dorëzuara nga ML **janë raportuar në përputhje me SIMFSH**

Është përgatitur udhëzuesi për Buxhetin për Qytetarët dhe janë trajnuar OSHC-ve

10% e progresit të paraqitjes së pasqyrave financiare të qeverisë bazuar në Kontabilitetin mbi bazë të drejtash dhe detyrimesh të konstatuara (hartimi i akteve ligjore dhe standardeve të kontabilitetit, analiza e mangësive, draft udhëzimet e kontabilitetit)

OS6

Është zbatuar **Plani i Veprimit të KBFP** për vitin 2021.

Është rishikuar **Ligji** i MFK dhe AB

Vlerësimi i cilësisë në **20** njësi publike.

Janë përditësuar **bazat e të dhënave** për MFK dhe AB dhe janë raportuar problemet.

Udhëzimi për Delegimin e detyrave është zbatuar në **5** njësi publike.

Janë përgatitur **3** udhëzime për AB.

Janë identifikuar dhe raportuar **problemet** për MFK.

Është përgatitur **VNT** për inspektorët financiar publik.

Janë trajnuar **67%** e inspektorëve.

OS7

Janë zbatuar **55%** e rekomandimeve.

Janë kryer 36.7% auditime financiare.

Është përgatitur **draft ligji** i KLSH

Është përgatitur plani vjetor i auditimit të KLSH për vitin 2021 bazuar në **analizën e riskut**.

Është përditësuar **Manuali i Auditimit të Performancës**.

Mesatarisht **26.7 ditë** trajnimi për audituesit e KLSH.

Raportet vjetore të konsoliduara janë dërguar në Parlament.

Tabela e Përmbajtjes

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1 PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME LIDHUR ME ZBATIMIN E STRATEGJISË 2019-2022	7
1.1 HYRJE.....	7
1.2 METODOLOGJIA E MONITORIMIT	7
1.3 VIZIBILITETI I MFP-SË DHE KONSULTIMET	8
2. PROGRESI I STRATEGJISË NË VITIN 2021	9
2.1 Arritjet në zbatimin e Objektivave Specifike të Strategjisë së MFP-së për vitin 2021	9
2.2 NDIKIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË MFP NË PËRPUTHJE ME AGJENDËN E INTEGRIMIT EVROPIAN.....	10
2.3 Ndikimi në sektorin e zhvillimit në rajon dhe/ose më tej	11
2.4 Produktet e Objektivave Specifike që nuk ecën sipas planit.....	12
2.5 Zbatimi i përgjithshëm i buxhetit	14
3 Ecuria në zbatimin e Objektivave Specifike të Strategjisë së MFP-së.....	15
3.1 Ecuria për Objektivin Specifik 1 “Kudër Fiskal i Qëndrueshëm dhe i Matur”	15
3.2 Ecuria për Objektivin Specifik 2 “Planifikim i mirëintegruar dhe efikas”	18
3.3 Ecuria për Objektivin Specifik 3 “Mbledhja e të ardhurave”	27
3.4 Ecuria për Objektivin Specifik 4 “Zbatim efikas i buxhetit”	33
3.5 Ecuria për Objektivin Specifik 5 “Transparenca e Financave Publike”	40
3.6 Ecuria për Objektivin Specifik 6 “Kontroll i Brendshëm Efektiv”	46
3.7 Ecuria për Objektivin Specifik 7 “Mbikëqyrja e jashtme efektive e financave publike”	51
4. Performanca e kategorizuar sipas standarteve	55
5. Risqet dhe hapat për t’i trajtuar	57
6. Kostoja e Strategjisë MFP.....	62
7. Përfundime dhe Rekomandime	63
SHKURTIME DHE AKRONIME	64
Shtojca 1: Treguesit e Rezultateve të Performancës	66
Aneks 2: Statusi i Objektivave të Produkteve	70

1 Përmbledhje e përgjithshme lidhur me zbatimin e Strategjisë 2019-2022

1.1 Hyrje

Ky është Raporti i shtatë Vjetor i Monitorimit mbi Zbatimin e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (MFP), që mbulon periudhën 1 janar 2021 - 31 dhjetor 2021. Raporti mbulon një vit tjetër përpjekjesh për këtë reformë dhe ofron informacion të detajuar për Komitetin Drejtues dhe Komitetin Teknik të MFP-së sa i takon progresit të arritur dhe sfidat e hasura në përmbushjen e objektivave dhe rezultateve të Strategjisë.

Ky raport ofron një vlerësim të kritereve të pranueshmërisë së MFP-së për Bashkimin Evropian (BE) për të ofruar mbështetje buxhetore për Shqipërinë. Kriteri i pranueshmërisë së MFP-së kërkon ekzistencën e një programi të besueshëm dhe të rëndësishëm për të përmirësuar menaxhimin e financave publike, si dhe progres të kënaqshëm në zbatimin e programit. Sipas vetë-vlerësimit tonë, progresi i MFP-së ka qenë përgjithësisht **i kënaqshëm, me 100% progres në nivelin e rezultateve dhe 79.31% të progresit në nivelin e produkteve.**

Qeveria e Shqipërisë ka bërë progres të mirë për zbatimin e Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike. Zhvillimet për secilin Objektiv Specifik përshkruhen në seksionet vijuese.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) u mbështet nga ekipi i Asistencës Teknike nga Mbështetja për Përmirësim në Menaxhim dhe Qeverisje (MPMQ) për hartimin e raportit vjetor, një nismë e përbashkët nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZhE). Mbështetja e Asistencës Teknike të MPMQ/OBZhE ishte kryesisht në përmirësimin e formatit të monitorimit dhe në procesin e përgatitjes së raportit të monitorimit të MFP-së për vitin 2021, për një përafrim më të mirë me metodologjinë e Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS).

1.2 Metodologjia e Monitorimit

Drejtoria e MFP-së udhëheq procesin e përgatitjes së raportit vjetor të monitorimit të MFP-së dhe dërgon kërkesën për raportim tek të gjithë drejtuesit e OS-ve, të cilët janë struktura përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë kundrejt planit të veprimit të kostuar, performancës kundrejt vlerave të synuara, vonesave apo ndryshimeve, identifikimin e risqeve të materializuara, risqeve të reja dhe masat për zbutjen e tyre. Raporti është përgatitur bazuar në udhëzimin e monitorimit të miratuar nga Komiteti Drejtues nr.11 i datës 7 prill 2020, dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020, “Për krijimin e bazës së dhënave shtetërore për Sistemin Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS)”. Struktura e raportit vjetor të monitorimit për vitin 2021 është e njëjta strukturë e përdorur për raportin vjetor të monitorimit të vitit 2020, i cili është hartuar në përputhje me metodologjinë SIPI/IPSIS bazuar në VKM nr. 290, datë 11 prill 2020. Gjatë vitit 2022 MFE ka intensifikuar përpjekjet për një prezantim më të mirë të informacionit dhe rezultateve në secilin nga seksionet e raportit, duke synuar përafrimin e mëtejshëm me standardet SIPI/IPSIS. Në këtë aspekt, përmirësimet kryesore përfshijnë: **i) u përgatit një format i ri monitorimi për raportin vjetor të MFP-së** me mbështetjen e MPMQ/OBZhE duke synuar një model më të përshtatshëm për përdoruesit, për njësitë përgjegjëse dhe për të mbledhur informacionin e përgjithshëm për shkrimin e raportit; **ii) rezultati i përgjithshëm i vetëvlerësimit u bazua në progresin e bërë në nivelin e rezultateve dhe në nivelin e produktit.** Përcaktimi i nivelit të arritjes për secilin prej treguesve të performancës së rezultateve dhe “ngjyrave të semaforit” për çdo OS është bërë sipas metodologjisë SIPI/IPSIS, e llogaritur me të njëjtën formulë të përdorur në vitin 2020, e cila përfshin objektivin e vitit 2021 të treguesit të performancës së rezultatit në raport me faktin e vitit 2021. Për ato objektiva pa vlerë të specifikuar (psh. “≤ (t-1) tendencë në rënie”) si objektiv për vitin 2021 përdoret fakti i vitit 2020, ndërsa për ato objektiva për të cilat fakti/plani i raportit nuk është i aplikueshëm (psh. Me objektiv "N/A" ose shkronjat "B") konsiderohet 100% kur janë arritur plotësisht

dhe 0% kur nuk janë arritur sipas objektivit. Progresi i përgjithshëm në nivelin e produktit është llogaritur si përqindje totale e atyre treguesve të performancës 2021 të produkteve “të përmbushura” dhe “në progres”. Statusi i treguesve të performancës së rezultateve u prezantua në tre nivele: “të përmbushura” me 100% të objektivave të arritura në krahasim me objektivin e vendosur; “në progres” për ato objektiva që kanë përparuar gjatë vitit 2021 por kanë ende punë për të bërë; dhe “të papërmbushura” për ato produkte që nuk kanë shënuar progres gjatë vitit 2021; **iii) Përmbledhja ekzekutive është më e shkurtër** se vitet e kaluara dhe e paraqet informacionin me më shumë vlera numerike; **iv) Vlerësimi i riskut paraqitet në mënyrë më të detajuar dhe duke përdorur “ngjyrat e semaforit” duke i klasifikuar ato në bazë të “Probabilitetit për të ndodhur” dhe “Ndikimit”.** **Metodologjia për identifikimin dhe kategorizimin e riskut është bërë në përputhje me udhëzuesin nr. 16, datë 20.07.2016 në zbatim të ligjit nr. 10 296, datë 07.08.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”,** sikurse kërkohet nga SIPI/IPSIS. Në këtë aspekt, risqet janë vlerësuar sipas faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe janë identifikuar risqet e materializuara për të cilat janë marrë masa zbutëse.

1.3 Vizibiliteti i MFP-së dhe konsultimet

Strategjia për reformën e MFP-së shërben si kornizë për dialogun strategjik për të gjithë donatorët dhe aktorët e shoqërisë civile në këtë sektor. Dy mbledhje të Komitetit Drejtues të MFP-së (KD) të MFP-së dhe një mbledhje e Komitetit Teknik (KT) janë mbajtur gjatë vitit 2021.

Në janar 2021, MFE përfundoi procesin e ndryshimeve të disa prej objektivave të treguesve të performancës të Objektivave Specifikë dhe të produkteve përkatëse, për të marrë parasysh ndikimin negativ të tërmetit të nëntorit 2019 dhe pandemisë COVID-19 në arritjen e rezultateve, që korrespondojnë me KD-në e 13-të MFP-së. Rishikimi i Planit të Veprimit të MFP 2020-2022 u miratua dhe u publikua në faqen e internetit të MFE¹. Në korrik 2021, MFE miratoi raportin vjetor të monitorimit të MFP-së 2020 në mbledhjen e KD nr. 14 të MFP-së. Në takimet e KD të MFP-së pati pjesëmarrje nga palët kryesore të interesit të QSH-së për MFP-në, si dhe donatorët/partnerët ndërkombëtar dhe organizatat e shoqërisë civile. Për më tepër, draft raporti dhe plani i veprimit i rishikuar 2020-2022 u shpërnda për konsultime me të gjithë aktorët paraprakisht dhe komentet e tyre u reflektuan, ose në rast se reflektimi nuk ishte i mundur u paraqit argumenti i mosreflektimit dhe iu është shpjeguar zyrtarisht aktorëve specifikë.

Gjatë përgatitjes së raportit vjetor 2021, Drejtoria e MFP-së zhvilloi komunikime intensive me përfaqësuesit e strukturave të përfshira në MFP, me qëllim prezantimin e drejtë dhe të qartë të arritjeve dhe problematikave të hasura gjatë periudhës raportuese. Faza e raportimit nisi me një takim online më 25 mars 2022 të organizuar me mbështetjen e asistencës teknike nga MPMQ/OBZhE, ku ishin të ftuar të gjithë drejtuesit e OS-ve, me synimin për t’u prezantuar atyre formatin e ri të monitorimit. Pas këtij takimi, Drejtoria e MFP-së dërgoi kërkesën për raportim drejtuesve të OS-së, dhe gjatë fazës së mbledhjes së të dhënave, secili drejtues i OS-së organizoi takim të dedikuar për OS-në e tyre përkatëse. Në këto takime morën pjesë dhe ekspertë nga MPMQ/OBZhE dhe stafi i Drejtorisë së MFP-së.

Pas një procesi intensiv, MFE-ja hartoi raportin vjetor të monitorimit dhe u diskutua me të gjitha palët e përfshira në MFP. Fillimisht, drafti i parë u prezantua në një takim të organizuar me ndihmën e asistencës teknike të MPMQ/OBZhE me qëllim diskutimin e statusit të produkteve për vitin 2021, dhe më pas në Takimin Teknik. Drafti përfundimtar u prezantua në mbledhjen e KD të kryesuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, ku morën pjesë përfaqësues të institucioneve dhe drejtorive brenda MFE-së të përfshirë në strategjinë e MFP-së dhe anëtarë të tjerë të KD-së, gjithashtu partnerët ndërkombëtar dhe organizata të shoqërisë civile. Të gjitha komentet apo sugjerimet e palëve diskutohen dhe pasqyrohen në raport. Në kuadër

¹ <https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/PPM-Action-Plan-Revised-2020-2022.pdf>

të transparencës dhe komunikimit me publikun, MFE-ja publikon në faqen e saj zyrtare² të internetit çdo raport vjetor monitorimi në gjuhën shqipe dhe angleze.


2. PROGRESI I STRATEGJISË NË VITIN 2021

2.1 Arritjet në zbatimin e Objektivave Specifike të Strategjisë së MFP-së për vitin 2021

Pavarësisht pasojave nga pandemia COVID-19, zbatimi i objektivave specifike të MFP-së gjatë vitit 2021 ka pasur **ecuri shumë të mirë** në nivelin 100% të arritjeve, të cilat dëshmojnë se mbeten në të njëjtin nivel arritjeje si në vitin 2020 (progres shumë i mirë me nivel të arritjeve 97,3%).

Në përgjithësi, grafiku i mëposhtëm paraqet një përmbledhje të nivelit të arritjeve për secilin objektiv specifik. Niveli i arritjes së strategjisë në nivelin e rezultateve ishte 100%, që është një mesatare e nivelit të arritjes së objektivave specifike, përkatësisht OS1 100%, OS2 106%, OS3 86%, OS4 106%, OS5 80%, OS6 104 % dhe OS7 120%.

Grafiku 1: Niveli i arritjes së OS për vitin 2021



Gjatë vitit 2021, treguesit kryesorë të performancës që kanë kontribuar kryesisht në arritjet në nivelin e rezultateve janë: raporti i borxhit ndaj PBB-së; Bilanci Primar; devijimi i mbledhjes aktuale të të ardhurave; pjesa e projekteve të investimeve publike që propozohen në bazë të prioriteteve strategjike të qeverisë; nivelin e mbledhjes së të ardhurave tatimore dhe doganore; detyrimet e prapambetura; stoku i borxhit të brendshëm të rifiksuar brenda një viti; publikimi i raporteve financiare vjetore dhe gjatë vitit që përmbajnë informacion për performancën financiare dhe jofinanciare, duke përfshirë TKP-të; pasqyrat financiare të qeverisë në bazë të drejtash dhe detyrimesh të konstatuara; zbatimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm; mekanizmat për llogaridhënien menaxheriale; rekomandimet e bazuar në sistem; zbatimi i rekomandimeve të inspektimit financiar; zbatimi i rekomandimeve të auditimit dhe auditimet financiare të kryera.

² <https://www.financa.gov.al/raportet-e-monitorimit-2/>

2.2 Ndikimi i zbatimit të Strategjisë së MFP në përputhje me agjendën e Integritimit Evropian

Reforma për menaxhimin e financave publike vazhdon të jetë një prioritet i qeverisë shqiptare jo vetëm si një nga parakushtet për anëtarësimin në Bashkimin Evropian në kuadër të Reformës së Administratës Publike (RAP), por gjithashtu synon mbështetjen e një ekonomie më të zhvilluar me shërbime më të mira për qytetarët. Ecuria e kënaqshme në zbatimin e reformave për përmirësimin e menaxhimit të financave publike, duke përfshirë mbledhjen e të ardhurave kombëtare dhe vazhdimi i rëndësisë dhe besueshmërisë së programit të reformës është një nga kushtet e përgjithshme për disbursimin e kësteve të mbështetjes buxhetore.

Rrugëtimi i zhvillimit ekonomik dhe social i Shqipërisë dhe perspektiva e harmonizimit të saj me standardet evropiane nuk është një proces i lehtë. Ai kërkon vizion, ide të qarta dhe kurajë nga ana e shtetit, institucioneve dhe faktorëve të tjerë të rëndësishëm social. Në këtë drejtim, Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022, trajton një sërë sfidash që Shqipëria duhet të përballojë në rrugën e saj drejt BE-së. Për më tepër, progresi i MFP-së është pjesë e disa raporteve të monitorimit dhe vlerësimit si: Raporti i Grupit të Posaçëm të RAP-it, raporti i vlerësimit nga MPMQ dhe Raporti i BE-së për Progresin e Shqipërisë.

Lidhur me **Grupin e Posaçëm të RAP BE-Shqipëri**, ai shërben si një platformë për të nxitur procesin e reformës së administratës publike. Qeveria e Shqipërisë përgatit raporte periodike mbi ndjekjen e konkluzioneve të Grupit të Posaçëm të RAP dhe çdo vit në takimet vjetore nxirren konkluzione për fushat që kanë nevojë për përmirësim. Në takimin e 10-të të Grupit të Posaçëm të RAP të mbajtur në janar 2022 u raportua zbatimi i konkluzioneve të MFP-së, përkatësisht për vendet ende vakante, veçanërisht në funksionet kyçe brenda MFE-së; akumulimi i detyrimeve të reja të prapambetura si në nivel vendor dhe qendror; proceset e vendimmarrjes dhe menaxhimit për investimet publike; mbledhja e të ardhurave në vend; dhe aktet nënligjore të ligjit për financat vendore. Në këtë takim u lanë disa konkluzione operationale si: parandalimi i detyrimeve të reja të prapambetura; proceset e vendimmarrjes dhe menaxhimit për investimet publike; konsultimi publik për hartimin, miratimin e strategjisë afatmesme të të ardhurave (SAA) dhe monitorimin e zbatimit të saj.

Referuar **raportit të monitorimit MPMQ (SIGMA) të vitit 2021**³, trajektorja e përgjithshme për Shqipërinë në MFP është në rritje, nga 2.8 në 2017 në 3.3 në 2021 dhe është mbi mesataren rajonale prej 3.1. Krahasuar me mesataren rajonale, performanca është e njëjtë ose më e mirë në secilin tregues në fushën e MFP-së, me përjashtim të funksionimit të auditimit të brendshëm (AB). Më e theksuar është performanca e lartë në fushën e prokurimit publik dhe themelet për funksionimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK), AB dhe auditimit të jashtëm.

Lidhur me **raportin e BE-së për Shqipërinë për vitin 2021**⁴, gjetjet kryesore paraqiten në kutinë më poshtë.

³ <https://www.sigmaweb.org/countries/albania-sigma.htm>

⁴ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

“...Të gjitha detyrimet e prapambetura tani regjistrohen në një llogari thesari të veçantë dhe raportet e detyrimeve të prapambetura nxirren direkt nga sistemi. Programi Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 u përgatit duke përdorur Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar Shqiptar (SIMFSh), i zhvilluar rishtazi, dhe u miratua sipas rregullave. Buxheti i vitit 2021 dhe ekzekutimi i buxhetit të vitit 2020 ishin në përputhje me Ligjin Organik të Buxhetit të rishikuar. Drafti i Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave është në pritje të finalizimit...”

...Në prokurimin publik, ku Shqipëria është mesatarisht e përgatitur, vendi ka bërë progres të mirë, veçanërisht duke miratuar ligjin e ri për prokurimin publik. Për sa i përket statistikave, ku Shqipëria është gjithashtu e përgatitur mesatarisht, ka bërë progres në përafrimin me standardet SELL 2010, publikimin më të shpejtë dhe miratimin e Ligjit për Regjistrimin e Popullsisë. Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në shumicën e fushave për kontrollin financiar, ku vendi ka bërë progres, veçanërisht në kontrollin e brendshëm financiar publik dhe auditimin e jashtëm...

...Transparenca buxhetore mbetet e kënaqshme me publikimin e të gjitha dokumenteve kyçe buxhetore. Publikimi në kohë i raporteve të ekzekutimit të buxhetit, në veçanti raportimi i detyrimeve të prapambetura. Transparenca në të gjithë qeverinë vazhdon të tregojë nivele të ndryshme. Pjesëmarrja e publikut në procesin buxhetor duhet të forcohet më tej...

...Në vitin 2020, u arrit përparim thelbësor në monitorimin e zbatimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) dhe miratimin në kohë të planit të ri për 2021-2022. Norma e zbatimit të PKIE-së është përmirësuar në 87% nga 60% që ishte një vit më parë...”

Për më tepër, njësitë përgjegjëse të MFP-së raportuan se për 13 nga 24 komponentët e reformës së MFP-së paraqesin progresin e tyre në kapitujt e PKIE-së. Për secilin nga kapitujt janë dhënë rekomandime dhe janë marrë masat përkatëse për adresimin e tyre.

2.3 Ndikimi në sektorin e zhvillimit në rajon dhe/ose më tej

Në këtë pjesë paraqitet një analizë krahasimore mes vendeve të Ballkanit Perëndimor me fokus në fushën e financave publike dhe në performancën ekonomike që është arritur përmes reformave në vazhdimësi. Sipas studimeve të kryera në gjashtë vendet e BP-së (Shqipëri, Kosovë, Bosnje dhe Hercegovina, Serbi, Mal i Zi dhe Maqedoninë e Veriut) tregohet se janë pothuajse në të njëjtat faza lidhur me zbatimin e reformës së MFP-së. Është veçanërisht me rëndësi raporti për Ballkanin Perëndimor “Western Balkans Regular Economic Report, No. 20, Fall 2021: Greening the Recovery”⁵ ku paraqitet një pikëpamje e përgjithshme e treguesve kryesorë të financave publike dhe ndikimi i pandemisë në këto ekonomi. Tabela më poshtë paraqet pamjen e përgjithshme fiskale në vendet e Ballkanit Perëndimor për vitin 2019, 2020 dhe vlerësimin për 2021.

Tabela 1: Treguesit fiskalë në vendet e Ballkanit Perëndimor 2019, 2020, 2021⁶

⁵<https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/36402/Greening-the-Recovery.pdf?sequence=1&isAllowed=y>

⁶ Shifrat e vitit 2021 janë vlera të vlerësuar

Indicator	Real GDP growth (percent)			Public debt (percent of GDP)			Public Expenditures (percent of GDP)			Public revenues (percent of GDP)		
	2019	2020	2021	2019	2020	2021	2019	2020	2021	2019	2020	2021
Albania	2.2	-4.0	7.2	63.7	75.1	75.4	29.2	33.2	34.4	27.2	26.3	27.8
Bosnia and Herzegovina	2.8	-3.2	4.0	32.8	36.6	35.8	41.1	44.0	44.3	43.0	42.2	41.2
Kosovo	4.8	-5.3	7.1	17.0	22.0	22.7	29.7	33.0	29.8	26.8	25.4	28.9
North Macedonia	3.2	-4.5	4.6	40.7	51.4	53.9	33.7	38.4	42.0	31.5	30.2	36.1
Montenegro	4.1	-15.3	10.8	76.5	105.3	87.7	46.0	55.4	47.9	43.3	44.4	43.9
Serbia	4.3	-0.9	6	49.7	53.3	56.3	42.2	49.0	48.7	42.0	41.0	41.7

Burimi i Informacionit: Banka Botërore (2022)

Balancat fiskale kanë filluar të përmirësohen si rezultat i një performace ekonomike më të fortë, por do të duhen përpjekje të mëtejshme për të rivendosur balancat. Rimëkëmbja e rritjes po kontribuon në mbledhjen e të ardhurave në të gjithë rajonin.


Siç mund të shihet:

- Shqipëria duket në pozicionin e tretë më të keq në 2020 për rritjen faktike të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) pas Malit të Zi dhe Kosovës për shkak të pandemisë globale COVID-19, e cila detyroi mbylljen e sektorëve më të mëdhenj ekonomikë, për këtë arsye situata ekonomike u përkeqësua. Megjithatë, duke marrë parasysh vlerësimin për vitin 2021, Shqipëria shfaqet në vendin e dytë më të mirë pas Malit të Zi që është në vendin e parë.
- Një tregues tjetër i rëndësishëm që është ndikuar shumë nga efektet e pandemisë është borxhi publik, ku nëse krahasojmë vlerësimet midis vendeve, vihet re se Shqipëria është vendi i dytë nga 6 vendet e BP me borxhin publik më të lartë në përqindje të PBB-së, pas Malit të Zi.
- Shpenzimet publike në terma të PBB-së janë rritur në Shqipëri, si dhe në vende të tjera.
- Të ardhurat publike në vitin 2020 ranë jo vetëm në Shqipëri, por në përgjithësi në rajon, megjithatë një rritje e lehtë mund të vërehet në vlerësimin për vitin 2021. Duke marrë parasysh vlerësimin për vitin 2021, Shqipëria është vendi i dytë me të ardhurat publike më të ulëta pas Kosovës.

2.4 Produktet e Objektivave Specifike që nuk ecën sipas planit


Grafiku i mëposhtëm paraqet një përmbledhje të statusit të objektivave të produkteve për shtatë objektivat specifike. Niveli i arritjes së objektivave të produkteve për vitin 2021 ishte 79.31%. Siç mund të shihet në grafikun më poshtë, 57.76% e objektivave të produkteve u arritën plotësisht në vitin 2021, ndërsa 41.38% nuk progresuan siç ishte planifikuar (përfshin objektivat "nuk është përmbushur" dhe "në progres"), 21.55% prej të cilave janë në progres dhe puna do të vazhdojë edhe në vitin e ardhshëm. Siç u raportua nga njësitë përgjegjëse, faktori kryesor i mosarritjes së objektivave të produkteve për vitin 2021 ishte pandemia Covid-19, e cila rriti ndikimin e saj negativ në arritjen e objektivave të vendosur dhe duke u bërë pengesa kryesore e progresit të tyre, jo vetëm për vitin 2020, por ka dhënë efekte edhe për vitin 2021.

Grafiku 2: Statusi i Objektivave të produkteve për vitin 2021



Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur përqindjet e objektivave të produkteve për vitin 2021 për secilin prej Objektivave Specifike të cilët, gjatë vitit 2021, nuk kanë progresuar siç ishte planifikuar. OS3 ka numrin më të lartë të objektivave të produkteve që gjatë vitit 2021, nuk kanë progresuar sikurse ishte planifikuar (52.94%), ndjekur nga OS5 (50%), ndërsa OS6 ka numrin më të ulët (vetëm 20% nuk kanë progresuar siç ishte planifikuar).

Grafiku 3: Objektivat e produkteve për vitin 2021 që nuk progresuan sikurse ishte planifikuar



Sfidat kryesore që penguan arritjen e produkteve lidhen kryesisht me pandeminë Covid-19; proceset e organizimit të brendshëm; mungesa e burimeve njerëzore / kapaciteteve të qëndrueshme / qarkullimi i stafit; mungesa e ngritjes së kapaciteteve; mungesa e procedurave të qarta; mungesa e infrastrukturës së nevojshme; ngarkesa e punës në disa njësi; Sistemi i TI-së dhe risqet operationale; mungesa e të dhënave dhe mungesa e informacionit; mungesa e burimeve financiare; mungesa e koordinimit dhe mungesa e ekspertizës së jashtme të nevojshme.

2.5 Zbatimi i përgjithshëm i buxhetit

Shumica e reformave të përfshira në këtë strategji janë reforma të politikave. Puna për formalizimin e këtyre reformave në formën e legjislacionit dhe rregulloreve të reja dhe/ose të ndryshuara në përgjithësi nuk ka kërkuar burime financiare shtesë. Stafi ekzistues i institucioneve të përfshira në zbatimin e reformave kanë ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të arritur rezultatet e dëshiruara. Planit i Veprimit 2019-2022 paraqet që kostoja totale e zbatimit të aktiviteteve është 83 milion euro, nga të cilat 48.8 milion euro do të mbulohen nga buxheti i shtetit dhe 25.2 milion euro nga Partnerët Ndërkombëtar për Zhvillim (PNZh) dhe 8.9 milion u konsideruan si hendek financiar. Gjatë vitit 2021, burimet e përdorura për zbatimin e reformës ishin 93% e buxhetit të planifikuar ose 23.8 milion euro nga 25.6 milion euro (10.7 milion euro ishin nga buxheti i shtetit, ndërsa 13.1 milion euro nga PNZh). Me zbatimin e SIPI/IPSIS besohet se do të nxirret një pasqyrë e plotë e kostove të planit të veprimit, pasi do të ketë një përafrim më të mirë midis Strategjisë dhe PBA-së, kështu që buxheti i shpenzuar gjatë zbatimit të planit të veprimit do të nxirret lehtësisht. Gjatë vitit 2021, MFE-ja ka marrë disa financime dhe/ose asistencë të drejtpërdrejtë nga partnerët e saj të jashtëm të zhvillimit për të mbuluar shpenzimet që lidhen me zbatimin e sistemeve dhe ngritjen e kapaciteteve.

Gjatë përgatitjes së Planit të Veprimit të rishikuar të Strategjisë së MFP-së 2019-2022 ishte parashikuar një hendek financimi prej 8,9 milionë Euro për të gjithë periudhën e zbatimit të tij. Megjithatë, siç përmendet edhe në dokumentin kryesor të Strategjisë së MFP-së, Qeveria mbetet e përkushtuar për të siguruar hendekun financiar për të mundësuar zbatimin e aktiviteteve të reformës, dhe ky ishte rasti gjatë vitit 2021 ku disa aktivitete që nuk ishin planifikuar fillimisht të mbuloreshin nga buxheti i qeverisë ose donatorët janë kryer nga stafi i institucioneve buxhetore përgjegjëse për zbatimin. Detaje të mëtejshme rreth burimeve të përdorura për zbatimin e reformës janë paraqitur në kapitullin 6 të këtij raporti.

3 Ecuria në zbatimin e Objektivave Specifike të Strategjisë së MFP-së

Detajet specifike të zhvillimit për secilin Objektiv Specifik përshkruhen në paragrafët më poshtë.


3.1 Ecuria për Objektivin Specifik 1 “Kuangër Fiskal i Qëndrueshëm dhe i Matur”

Për të siguruar një kuangër fiskal të qëndrueshëm dhe të matur, u bënë përpjekje për (i) rritjen e besueshmërisë së kuangër fiskal (ii) identifikimin dhe kontrollin më efektiv të risqeve fiskale. Gjatë vitit 2021, niveli i arritjes së treguesve të performancës së rezultateve është vlerësuar si shumë i mirë, me 100% progres të bërë, duke qëndruar në të njëjtën kategori krahasuar me vitin 2020 (101%).

Tabela 2: Treguesit e Performancës së Rezultateve për OS1

Rezultati	Treguesi i performancës	Vlera Faktike VF 2020	Vlera e synuar VF 2021	Vlera faktike VF 2021
I) Rritja e besueshmërisë së kuangër fiskal	Ia) Raporti mes borxhit dhe PBB	76.1%	< FY 20	73.2%
	Ib) PBB nominale e parashikuar në krahasim me parashikimet e FMN-së Fondi Monetar Ndërkombëtar	ALL -0.2 bilion	< 0	-0.03 bilion ALL
	Ic) Bilanci primar	-4.7%	> FY20	-2.6%
	Id) Diferenca mes tepicës /deficitit të synuar të parashikuar në buxhet për vitin buxhetor	-17.0%	≤ deficieti i planifikuar	-29.2%
	Ie) Përqindja e devijimit të mbledhjes konkrete është brenda % të përcaktuar/miratur të vlerësimit buxhetor për të ardhurat tatimore dhe doganore	-16.80%	> -5%	1.20%
II) Identifikimi dhe frenimi i risqeve fiskale më efektivisht	Ila) Raportimi i riskut fiskal (PEFA PI 10)	B	B	B

Grafiku 4: Statusi i objektivave të produkteve të OS 1 për vitin 2021



Në legjislacion u përfshinë dispozita për të trajtuar parashikimet tepër optimiste. Dispozitat përfshinin rregulla të reja të borxhit, deficitit dhe bilancit primar aktual që synonin ta çonin raportin e borxhit ndaj PBB-së në nivele të qëndrueshme. Raporti i borxhit ndaj PBB-së ka shfaqur tendencë në rënie gjatë periudhës 2015-2019, ndërsa në vitin 2020 raporti u rrit në 76.1%. Qeveria Shqiptare mori masa të menjëhershme për tu adresuar procesi i dëmtimeve/rindërtimit nga tërmeti dhe frenimi i pasojave të pandemisë COVID-19, gjë që çoi në shpenzime dukshëm më të larta, duke rezultuar në një deficit buxhetor më të lartë në afat të shkurtër dhe nivel më të lartë të borxhit kombëtar. Në vitin 2021 raporti i borxhit ndaj PBB-së (73.2%) pati një rënie të lehtë në krahasim me vitin 2020. Parashikimet e PBB-së nominale ishin më të matshme dhe më të ulëta se parashikimet përkatëse të PBB-së nominale nga FMN për periudhën 2016-2021. Në vitet e mëparshme, veçanërisht në vitin 2020, proceset e planifikimit dhe buxhetimit u minuan nga parashikimet sistematike tepër optimiste të të ardhurave dhe parashikimet tatimore. Megjithatë, në vitin 2021 diferenca në parashikim ishte -0.03 miliardë lekë, e cila rezultoi 15% më e ulët se viti 2020. Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale krijoi një sektor të ri për analiza dhe statistika për të përmirësuar aftësitë e saj parashikuese në 2020, dhe gjysma e pozicioneve të planifikuara u plotësua gjatë vitit 2020. Katër vende vakante u plotësuan gjatë vitit 2021 përmes DAP. Stafi i sektorit për analiza dhe statistika nuk është trajnuar siç ishte planifikuar në vitin 2021.

Ecuria e mbledhjes së të ardhurave nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) për vitin 2021 krahasuar me vitin 2019 dhe 2020 kanë rezultuar në një tendencë rritëse. Këto të ardhura u vlerësuan në 336.8 miliardë lekë, 32 miliardë ose 10.5% më shumë krahasuar me vitin 2019 dhe 57.8 miliardë ose 20.7% më shumë krahasuar me vitin 2020. Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në ecurinë e realizimit të të ardhurave tatimore dhe doganore kundrejt planit janë: i) Vaksinimi i shpejtë i popullsisë, hapja graduale e ekonomisë dhe sezoni veror, rigjallërimi i turizmit dhe të gjithë sektorëve të tjerë të ekonomisë drejtpërdrejt ose të lidhura indirekt me turizmin, kanë ndikuar pozitivisht në rritjen ekonomike dhe të ardhurat që ekonomia ka krijuar për buxhetin e shtetit; ii) Ecuria pozitive e sektorit të ndërtimit, përfshirë rindërtimin për shkak të pasojave të tërmetit, ka rritur xhiron, importet, prodhimin vendas dhe të ardhurat buxhetore; iii) Rritja e të ardhurave doganore si rezultat i rritjes së vëllimit të importeve dhe rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare.

U krijua Njësia e Riskut Fiskal (NjRF) në MFE, përgjegjëse për analizimin, monitorimin dhe raportimin e risqeve fiskale. Deklarata e parë e Risqeve Fiskale (DRF) u publiku bashkë me Buxhetin Vjetor të vitit 2019. Gjatë vitit 2019 filloi puna për të thelluar dhe zgjeruar mbulimin e Deklaratës së Risqeve Fiskale duke e shtrirë analizën në një gamë më të gjerë risqesh, ku përfshihen ndërmarrjet shtetërore, detyrimet e prapambetura si dhe kontratat e Partneritetit Publik-Privat (PPP). Në vitin 2020, NjRF ka monitoruar rregullisht çdo muaj performancën financiare dhe jofinanciare të të gjitha kontratave koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore. Në vitin 2021, NjRF vazhdoi monitorimin e rregullt (çdo muaj) të performancës financiare dhe jofinanciare të të gjitha kontratave koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore. Në maj 2020, u publikua për herë të parë Raporti Vjetor Përmbledhës për vitin 2019 me informacion financiar dhe jofinanciar për PPP-të aktive. Tre Ndërmarrje Shtetërore (NSH) janë realizuar siç është planifikuar gjatë vitit 2021 me synim përmirësimin e DRF-së dhe zgjerimin e analizës së NSH-ve.

Ecuria e komponentëve gjatë vitit 2021

Komponenti 1.1: Rregullat fiskale dhe parashikimi

Lidhur me këtë komponent ka pasur vetëm produktin e “Besueshmërisë së parashikimit të të ardhurave” që kishte objektiv për vitin 2021. Vetëm gjysma e stafit të sektorit për analiza dhe statistika u plotësua në vitin 2020 siç ishte planifikuar dhe katër vende vakante u plotësuan gjatë vitit 2021 nëpërmjet DAP. Për vitin 2021 ishte parashikuar që stafi të trajnohej, por për shkak të kufizimeve të situatës me Covid 19 nuk u bë asnjë trajnim.

Komponenti 1.2: Menaxhimi i riskut fiskal

Janë bërë disa përmirësime për të përmirësuar FRS-në dhe për të zgjeruar analizën e NSH-ve. Në këtë drejtim shtimi i tre NSH-ve është realizuar siç është planifikuar gjatë vitit 2021. Fokusi i NjRF-së është monitorimi i NSH-ve të cilat mund të kenë ndikim potencial në buxhet, dhe jo domosdoshmërisht monitorimi i të gjitha NSH-ve, as rritja e numrit të NSH-ve në monitoruar aktualisht. Kështu, hapat e ardhshëm të NjRF-së janë monitorimi i NSH-ve të cilat mund të kenë ndikim potencial në buxhet, siç janë sektori i energjisë dhe sektori i furnizimit me ujë. Bazuar në Udhëzimin nr.4 të MFE-së, datë 25.01.2021 "Për Zbatimin e Buxhetit 2021", NjRF monitoron dhe përgatit në mënyrë periodike, në baza tremujore (3M) analizat e NSH-ve kryesore. Ky monitorim është fokusuar kryesisht në analizën e performancës financiare dhe jofinanciare të sektorit të energjisë. Këto raporte analitike, të cilat përgatiten rregullisht në baza tremujore, shpalosen/përfshihen në të gjitha raportet periodike të MFE/DMB, si ABER, Mes-Viti, Propozimi Buxhetor. Lidhur me monitorimin e performancës së NSH-ve për VF2021, NjRF po mbledh informacion nga kompanitë e sektorit të energjisë dhe gjithashtu nga UKT, Hekurudha Shqiptare, Posta Shqiptare dhe Albgas. NjRF monitoron periodikisht (në baza mujore) performancën financiare dhe jofinanciare vetëm për kontratat koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore. Pjesë e DRF-së janë edhe Detyrimet Kontingjente që vijnë nga Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg, vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit dhe vendimet përfundimtare të gjykatës administrative.

Një raport i konsoliduar mbi detyrimet e prapambetura të Qeverisë së Përgjithshme u përmirësua më tej në vitin 2021 siç ishte planifikuar. Monitorimi i detyrimeve të prapambetura është një proces i konsoliduar, nëpërmjet monitorimit periodik intensiv të të gjitha detyrimeve të prapambetura të institucioneve buxhetore. Duke filluar nga tetori 2020, ky monitorim dhe raportim i cili më parë kryhej në bazë të anketimit përmes raportimit me shkrim të institucioneve, gjenerohet automatikisht nga Sistemi Informativ Financiar i Qeverisë (SIFQ). Ky ndryshim zbatohet për të intensifikuar rolin mbikëqyrës të MFE-së në procesin e monitorimit të stokut të detyrimeve të prapambetura si dhe për një transparencë më të lartë bazuar në informacionin më të besueshëm të gjeneruar nga sistemi.

Sfidat kryesore dhe hapat e ardhshëm

Sfida kryesore në këtë objektiv specifik lidhet me trajnimin e stafit të sektorit për analiza dhe statistika. Për të kapërcyer këtë problem, ata po planifikojnë të marrin pjesë në trajnimet e organizuara nga ASPA për zonën e tyre.


3.2 Ecuria për Objektivin Specifik 2 “Planifikim i mirëintegruar dhe efikas”

Për të siguruar një planifikim të mirëintegruar dhe efikas, u bënë përpjekje për (i) përmirësimin e procesit dhe dokumentacionit të buxhetit vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) për të rritur besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e planifikimit afatmesëm; (ii) përmirësimin e Mbikëqyrjes së Menaxhimit të Investimeve Publike (MIP) dhe (iii) forcimin e menaxhimit financiar në qeverisjen vendore. Treguesi i performancës lidhur me stokun e detyrimeve të prapambetura në qeverinë vendore nuk ka ecur siç ishte planifikuar. Të dhënat për treguesin e rezultateve “Raporti ndërmjet fondeve totale të vlerësuara në strategjitë sektoriale dhe financimit total të identifikuar për sektorët përkatës brenda PBA-së” nuk janë të disponueshme për vitin 2021. Gjatë vitit 2021, niveli i arritjes së objektivave të treguesve të performancës së rezultateve, duke synuar sigurimin e një planifikimi të mirëintegruar dhe efikas u vlerësua si shumë i mirë, me 106% të progresit të bërë, duke qëndruar në të njëjtën kategori krahasuar me vitin 2020 (107%).

Tabela 3: Treguesit e Performancës së Rezultateve për OS2

Rezultati	Treguesi i performancës	Vlera Faktike VF 2020	Vlera e synuar VF 2021	Vlera faktike VF 2021
III) Dokumentet qeveritarë që shërbejnë për planifikim, si SKZHI, Strategjitë Sektoriale dhe PBA-ja janë harmonizuar plotësisht me njëra-tjetrën.	IIla) është identifikuar raporti mes financimit total tw parashikuar në strategjitë sektoriale dhe financimit total që është identifikuar për sektorët korespondues brenda PBA-së.	NA*	> (t-1) (tendencë në rritje)	NA*
IV) Përmirësimi i buxhetit vjetor dhe procesit dhe dokumentacionit të PBA-së për të rritur besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e planifikimit afatmesëm.	IVa) Totali i shpenzimeve të planifikuara për KPBA miratuar në vitin n/total i shpenzimeve të planifikuara në vitin n në buxhetin vjetor.	22.8% (2020)	< (t-1) (tendencë në rënie)	2.5%
	IVb) Realizimi faktik i shpenzimeve sipas funksionit (PEFA PI-2, 2.1)	B	C	B
V) Përmirësimi i Mbikëqyrjes së Menaxhimit të Investimeve Publike	Va) Pjesa e projekteve të investimeve publike që janë propozuar bazuar tek prioritetet strategjike të qeverisë (vlera e projekteve për vitin specifik)	82%	> (t-1) (tendencë në rritje)	90.5%
	Vb) Disbursimet aktuale për projektet e mëdha të investimit krahasuar me disbursimet e planifikuara shoqëruar me shpjegimet përkatëse në rastet kur ka devijime.	95%	97%	99.0%
	Vc) Raporti i investimeve të reja publike të dorëzuara në ciklin e PBA kundrejt totalit të investimeve të reja publike të miratuara në një vit	46.35%	> (t-1) (tendencë në rritje)	72.4%
VI) Forcimi i menaxhimit financiar në qeverinë vendore	Vla) Normat e mbledhjes së tatimeve (RLGRG)	-4.90%	15.7% (fact 2021/ 2020)	21.3%
	Vlb) Niveli vendor PEFA PI-22.1 Stoku i detyrimeve të prapambetura	6.9 bln ALL/51.6 billion ALL (13.3%)	3.5 bln ALL/56.8 bln ALL (6.1%)	6.5 bln ALL/52.583 bln ALL (12.3%)

Grafiku 5: Statusi i objektivave të produkteve të OS 2 për vitin 2021



Qeveria e Shqipërisë miratoi Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim SKZHI-II (2015-2020), e cila së bashku me strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, masterplanet dhe planet e veprimit përbëjnë kuadrin e zhvillimit strategjik gjithëpërfshirës të vendit. Pas katër vitesh nga zbatimi i tij u krye rishikimi afatmesëm (RA) i SKZHI-II dhe raporti u finalizua gjatë vitit 2020. Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje pranë Zyrës së Kryeministrit (DZHM/ZKM) përfundoi zbatimin e sistemit të automatizuar gjithëpërfshirës për forcimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), që lidh planifikimin e politikave strategjike me planifikimin buxhetor. Megjithatë nuk mund të përfundohej ndihma juridike për funksionimin e SIPI/IPSIS-it deri në fund të 2020 siç ishte planifikuar, u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave dhe udhëzimi për treguesit e performancës dhe monitorimin për të ndihmuar me procesin e zbatimit. Në korrik 2020, Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) akordoi operacionalizimin dhe gatishmërinë e SIPS/IPSIS-it për të filluar funksionimin dhe u bënë shumë aktivitete trajnuese. Treguesi i rezultatit “Raporti ndërmjet fondeve totale të vlerësuara në strategjitë sektoriale dhe financimit total të identifikuar për sektorët përkatës brenda PBA-së”, matet nga SIGMA dhe vlera për vitin 2020 është 60%. Për vitin 2021 ky tregues nuk është i disponueshëm. Deri më tani, SIMFSH është ndërtuar, është funksional dhe të gjitha LM-të dhe IB-të janë duke e përdorur atë, ndërkohë që SIPI/IPSIS është ende në proces. Pas krijimit të Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (ASHPSKN), sistemi SIPI/IPSIS do të jetë nën përgjegjësinë e kësaj agjencie dhe nga ky ristrukturim pritet që SIPI/IPSIS të jetë plotësisht funksional dhe të realizohet matja e treguesit. Gjatë vitit 2021, DZHM/ZKM shqyrtoi dhe komentoi 60% të dokumenteve strategjike, si dhe dha komente për 95.2% të raporteve të monitorimit të strategjive sektoriale.

Ndryshimet në Ligjin Organik të Buxhetit (LOB) në 2016 fuqizuan parlamentin të votonte dhe të miratonte tavanet e PBA-së në nivel programi dhe për t'i bërë detyruese për periudhën trevjeçare. Gjithashtu, u miratua Udhëzimi Standard i rishikuar për Përgatitjen e Buxhetit (USPB) për të reflektuar praktikatat më të mira ndërkombëtare në fillim të 2018, dhe këshillimi i zgjeruar dhe rishikimi i zbatimit të tij në të gjitha njësitë e qeverisë qendrore u krye midis 2019 dhe 2020. Rishikimi tregoi se ka ende hendeqe dhe mospërpunueshmëri në zbatimin e udhëzuesit nëpër sektorët e ndryshëm. Gjithashtu, moduli i ri i PBA-së i zhvilluar si shtesë e SIFQ-së ekzistuese u përfundua dhe u shtri në të gjitha ministratë e linjës (ML) dhe institucionet buxhetore (IB). Tre organizatat buxhetore shtesë, konkretisht Ministria e Drejtësisë, Ministria e Bujqësisë & Zhvillimit Rural, si dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, kanë përgatitur: parashikimin e nivelit bazë, nismat për politikën e reja dhe klasifikimin e programeve buxhetore & treguesit kryesorë të performancës (TKP). Gjithashtu, gjatë vitit 2021, janë trajnuar dhe asistuar 128 ekipe të menaxhimit të programit në procesin e përgatitjes së PBA-së në SIMFSH. Së fundi, për të ndihmuar më tej ML-të në zbatimin e udhëzimeve të reja, u finalizuan dhe u publikuan dy udhëzime sektoriale. Për të shqyrtuar si duhet dhe për të financuar nismat për politikën e reja, Komiteti për Planifikim Strategjik (KPS) miratoi Dokumentin e Politikave Prioritare në mars dhe korrik të vitit 2020 në dy takime të veçanta dhe për politikën e reja u vendos para përfshirjes së tyre në PBA. Gjatë vitit 2021, u përgatit nga ZKM Dokumenti i Politikave Prioritare dhe u diskutua me MFE-në në janar. Ky dokument shërben për të drejtuar procesin e planifikimit të tavaneve buxhetore 2022-2024, veçanërisht planifikimin e nismave të reja të politikave.

Lidhur me investimet publike, Këshilli i Ministrave⁷ miratoi një procedurë të re në vitin 2018 që synonte krijimin e kriterëve të reja për priorizimin dhe vlerësimin e projekteve të mëdha të investimit kapital. Gjatë viteve 2019 dhe 2020 Drejtoria për Menaxhimin e Investimeve Publike (DMIP) dhe KM-ja ofruan shumë trajnime lidhur me propozimet për investime publike që duhen dorëzuar për miratim dhe për modulet e reja të MIP-it në SIMFSH. Sa i takon PPP-ve pati ndryshime të rëndësishme ligjore që nga viti 2016 kur dispozitat e LOB-it vendosën kufizime vjetore për koncesionet dhe PPP-të. Gjithashtu, u ndryshua ligji për PPP-të në vitet 2014, 2015 dhe 2019 me qëllim krijimin e stimuljeve për disa sektore të reja të ekonomisë dhe për ndalimin e

⁷ Vendimi nr. 185 i Këshillit të Ministrave “Për Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike”.

propozimeve të panevojshme. Së fundi, ndryshime të tjera rregullatore për monitorimin e PPP-ve dhe koncesioneve rritën ndjeshëm numrin e kontratave nën shqyrtim nga Drejtoria e Koncesioneve krahasuar me vitin 2018. U publikua për herë të parë raporti vjetor për vitin 2019 me informacionin financiar dhe jofinanciar për të gjitha PPP-të aktive. Lista e Unifikuar e Projekteve për të gjitha projektet, pavarësisht burimit të financimit, u miratua nga KPS-ja në vitin 2020. U mirëmbajt Lista e Unifikuar e Projekteve për projektet e mëdha. Gjatë vitit 2021, u përgatit korniza rregullatore për menaxhimin e Listës së Unifikuar të Projekteve me mbështetjen e projektit të financuar nga Bashkimi Evropian. Gjatë vitit 2021, ZKM ka organizuar dy takime të KPS-së për miratimin e listës së projekteve strategjike që do të maturohen dhe financohen gjatë vitit 2021. KPS ka miratuar Dokumentin e Politikave Prioritare duke përfshirë listën e projekteve të reja strategjike, pjesë e Listës së Unifikuar të Projekteve, që do të përfshihen në PBA 2022-2024 (faza strategjike e PBA-së).

Përsa i përket MFP-së në qeverinë vendore, janë realizuar arritje të rëndësishme në kuadrin rregullator, si miratimi i ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe disa akteve nënligjore dhe udhëzimet. Puna për forcimin e planifikimit strategjik dhe menaxhimin e buxhetit në nivelin e qeverisë vendore përparoi mirë gjatë periudhës 2019 - 2021. Gjatë vitit 2021, u rishikua Udhëzimi Vjetor i Përgatitjes së PBA-së dhe u prezantua një model i ri për Dokumentin e PBA-së të NJVQV-ve si aneks i ri i Udhëzimit Vjetor. Një modul i ri i bazuar në Excel është përgatitur për Programin e Planifikimit të Shpenzimeve në kuadër të përgatitjes së PBA-së. Është realizuar një program trajnimi gjithëpërfshirës për përgatitjen e PBA-së për të gjitha 73 NJVQV-të. Në 18 bashki, paketat fiskale 2020, 2021 dhe 2022 janë miratuar plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor të taksimit vendor. Në vitin 2021, norma e mbledhjes së tatimeve ishte 21.3%, duke treguar një përmirësim në krahasim me vitin 2020 (-4.9%) dhe ka tejkaluar objektivin e vendosur për vitin 2021. Drejtoria e Financave Vendore (DFV) vazhdoi të monitorojë dhe publikojë Raportet mbi detyrimet e prapambetura në faqen zyrtare të MFE-së. Detyrimet e prapambetura në nivel të QV mbeten problem pasi stoku i tyre u rrit në krahasim me objektivat e vendosura, për shkak të ndikimit negativ të pandemisë COVID-19 në mbledhjen e të ardhurave. Detyrimet e papaguara më 31 dhjetor 2021 arrijnë në 6.5 miliardë lekë (në vend të 3.5 miliardë siç ishte planifikuar). Megjithatë, ka pasur një tendrënës krahasuar me vitin 2020 (6.9 miliardë lekë). Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (DPHKBFP) ka kryer shumë aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për të vendosur një funksion efektiv të kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm në qeverinë vendore. Të 73 dokumentet e PBA-së të dorëzuara nga NJVQV-të janë shqyrtuar nga MEF dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse për përmirësim. Objektivat e produktit në lidhje me ngritjen e SIPI/IPSIS në qeverinë vendore nuk u arritën.

Ecuria e arritur e komponentëve në vitin 2021

Komponenti 2.1: Zhvillimi i politikave dhe qeverisja e integruar strategjike

Objektivi i produktit i vendosur nga DZHM/ZKM për vitin 2021 për përmirësimin e cilësinë e procesit për rishikimin e strategjive, prioritetëve të politikave dhe kërkesat e PBA-së u arrit. 12 nga 20 dokumente strategjike (ose 60%) u rishikuan dhe u komentuan. Ka një rritje me 4% krahasuar me 2020 (56%). Qëllimi kryesor i rishikimit ishte të analizohej përputhshmëria dhe niveli i integritetit të strategjive me prioritetet e politikave dhe planifikimin buxhetor.

Objektivi i produktit i vendosur nga DZHM/ZKM për vitin 2021 për të koordinuar aktivitetet për një menaxhim më të mirë të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale u arrit. Në veçanti, DZHM/ZKM ka dhënë komente për 95,2% të raporteve të monitorimit të strategjive sektoriale (për 20 nga 21 raporte monitorimi të përgatitura nga (ML-të). Ka një rritje me 10,2% krahasuar me vitin 2020.

Në lidhje me produktin për zbatimin efektiv të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), objektivi nuk u arrit siç ishte planifikuar dhe analiza e mungesave ligjore në lidhje me proceset e menaxhimit të politikave nuk filloi.

Trajnimet e administratorëve, trajnerëve për menaxhimin dhe zbatimin efektiv të Sistemit SIPI/IPSIS, të planifikuara për vitin 2021, janë zhvilluar që në vitin 2020.

Komponenti 2.2: Programi buxhetor afatmesëm

Dy nga tre objektivat e produktit që synojnë zbatimin e buxhetimit të bazuar në performancë (BBP) në të gjitha institucionet buxhetore janë arritur plotësisht. Tre organizata buxhetore shtesë, konkretisht Ministria e Drejtësisë, Ministria e Bujqësisë & Zhvillimit Rural, si dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, kanë përgatitur: parashikimin e nivelit bazë, nismat për politika të reja dhe klasifikimin e programeve buxhetore & TKP-të. Gjithashtu, gjatë vitit 2021, janë trajnuar dhe asistuar 128 ekipe të menaxhimit të programit në procesin e përgatitjes së PBA-së në SIMFSH. Së fundi, është bërë progres për të ndihmuar më tej ML-të në zbatimin e udhëzimeve të reja. Edhe pse janë finalizuar dhe publikuar dy udhëzime sektoriale, ky objektivi produkti nuk është arritur ashtu siç ishte planifikuar për vitin 2021, sepse puna për përgatitjen e udhëzimeve të reja buxhetore ndaloi nga situata pandemike.

Objektivi i produktit, për të shqyrtuar dhe financuar siç duhet të gjitha nismat e reja të politikave, nuk u arrit. Kostoja e mandatit ligjor të pafinancuar nuk është identifikuar. Ky produkt duhet të shtyhet për në vitin 2022, sepse situata pandemike dhe ndryshimi i buxhetit vjetor për vitin 2021 disa herë (6 herë), e bënë të pamundur realizimin e këtij ushtrimi. Duke qënë se nuk ka vazhdimësi të politikave dhe politikave të reja të miratuara trajtonin vetëm nevojat imediate të lindura nga pasojat e pandemisë, ishte e pamundur të kryhej një analizë e tillë.

Një nga tre objektivat e produktit që synojnë përmirësimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor (BPGJ), në nivelin e qeverisë qendrore, u arrit plotësisht. 20 Organizata të Shoqërisë Civile (OSHC) janë trajnuar për buxhetimin me pjesëmarrje dhe BPGJ gjatë vitit 2021. Objektivi i produktit në lidhje me numrin e programeve buxhetore që janë integruar plotësisht në BPGJ nuk u arrit siç ishte synuar për vitin 2021, por megjithatë kishte progres. Për shkak të zgjedhjeve lokale, nëntë bashkitë e synuara nuk kanë mundur të angazhohen plotësisht në aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve. 33% e programeve buxhetore janë integruar plotësisht në BPGJ. Megjithatë ekipet e menaxhimit të buxhetit të 9 bashkive janë mbështetur teknikisht për të integruar në mënyrë efektive BPGJ-në në dokumentet e tyre të PBA-së, objektivi i produktit në lidhje me numrin e ekipeve të menaxhimit të programit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të trajnuara për BPGJ-në (planifikim dhe monitorim), nuk u arrit, por është arritur progres.

Objektivat e produktit për të përfshirë objektivat e politikave të pilotuara dhe TKP-të përkatëse si një aneks specifik në Ligjin Vjetor të Buxhetit nuk u arritën. Lista e TKP-ve për çdo program buxhetor nuk është përzgjedhur dhe raporti i ML/IB mbi objektivat e TKP-ve nuk është përgatitur. Për shkak të situatës së pandemisë, nuk ka pasur mundësi për ndryshimin e LOB-it për të krijuar të drejtën ligjore për ndryshimin dhe rritjen e cilësisë së dokumenteve buxhetore.

Produkti në lidhje me përmirësimin e cilësisë dhe përmbajtjen e dokumenteve buxhetore që shkojnë për miratim në Kuvend nuk u arrit siç ishte synuar për vitin 2021. Plani i veprimit nuk u zbatua. Formatet për prezantimin e të dhënave dhe përmbajtjen tekstuale nuk u përdorën.

Komponenti 2.3: Planifikimi dhe mbikqyrja e investimeve publike

Puna për krijimin e një Liste të Unifikuar të Projekteve, për të gjitha projektet, pavarësisht burimit të financimit, ka përparuar mirë. Vetëm një nga tre objektivat e produktit nuk u arrit siç ishte synuar për vitin 2021. Objektivi për hartimin dhe miratimin e strategjisë së MIP (përfshirë politika e PPP) nuk u arrit siç ishte synuar për vitin 2021. Procesi i bashkimit, që konsiston në krijimin e një departamenti të ri (duke bashkuar MIP dhe PPP) i cili do të funksionojë me një kuadër të ri ligjor, u shty pasi kërkon kohë për t'u realizuar.

U mirëmbajt Lista e Unifikuar e Projekteve për projektet e mëdha. Gjatë vitit 2021, u përgatit korniza rregullatore për menaxhimin e Listës së Unifikuar të Projekteve me mbështetjen e projektit të financuar nga Bashkimi Evropian. Gjatë vitit 2021, ZKM ka organizuar dy takime të KPS-së për miratimin e listës së projekteve strategjike që do të maturohen dhe financohen gjatë vitit 2021. KPS ka miratuar Dokumentin e Politikave Prioritare duke përfshirë listën e projekteve të reja strategjike, pjesë e Listës së Unifikuar të Projekteve, që do të përfshihen në PBA 2022-2024 (faza strategjike e PBA-së). Gjithashtu, gjatë vitit 2021, pesë projekte të reja strategjike pjesë e Listës së Unifikuar të Projekteve, kanë nisur ciklin e maturimit: Trajtimi i Ujrave të Zeza Durrës; Autostrada Murriqan-Lezhë; Zhvillimi rajonal i Broadband – Asistencë teknike – Projekti i Atlasit të broadband. Gjatë vitit 2021, ZKM udhëhoqi procesin e maturimit/financimit të projekteve strategjike, pjesë e Listës së Unifikuar të Projekteve. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2021, Shqipëria ka përthithur 175 milionë euro grant nga Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor (fondet e BE-së) për financimin e projekteve strategjike: Hekurudha Vorë-Hani i Hotit (grant investimi); BY Pass Tiranë (granti i dytë i investimit); Parku lundrues Fotovoltaik Vau i Dejës (grant investimi); informatikë me performancë të lartë për rrjetin e shkëmbimit të të dhënave të qeverisë dhe burimit të informacionit për ndërveprueshmërinë rajonale në Ballkanin Perëndimor (Asistencë Teknike); Evolucioni i sigurisë së Digave dhe potenciali i rezervuarve ekzistues për të përmirësuar ujitjen për të rritur elasticitetin ndaj ndryshimeve klimatike (AT); Trajtimi i ujrave të zeza Durrës (AT).

Gjithashtu, procedura për përfshirjen e projekteve aktive nga Lista e Unifikuar e Projekteve në ciklin e PBA-së, përgatitet dhe zbatohet me përgatitjen e Dokumentit të Politikave Prioritare, i cili është përgatitur dhe miratuar nga KPS në mars të vitit 2021. Dokumenti i Politikave Prioritare është pjesë e fazës strategjike të PBA-së dhe përbën një fazë të ndërmjetme përpara përcaktimit të kufijve buxhetorë për PBA 2022-2024.

U arrit objektivi i produktit që synonte rritjen e cilësisë së propozimeve për projektet madhore të investimeve publike që dërgohen për aprovim. Metodologjia e vlerësimit ex ante për vlerësimin e projektit është përgatitur në shtator 2021, me mbështetjen e asistencës teknike të MFP-së. Në shtator të vitit 2021 janë përgatitur modelet dhe udhëzuesit për aplikimin e metodologjisë. ML-tw janë trajnuar mbi metodologjinë gjatë periudhës nëntor-dhjetor 2021.

Objektivat e produktit që synojnë përmirësimin e procesit të monitorimit të investimeve publike, duke përfshirë projektet PPP dhe koncesionet nuk u arritën siç ishin parashikuar për vitin 2021, por megjithatë është bërë progres. Procesi i përafrimit të të dhënave historike me kodet e reja të projektit u shty pasi kërkonte një punë të jashtëzakonshme mekanike, ndërkohë që departamenti kishte mungesë të stafit. Objektivi i produktit në lidhje me raportin e kontratave të monitoruara nga MFE kundrejt totalit të kontratave të nënshkruara (PPP dhe Koncesione) nuk u arrit siç ishte synuar për vitin 2021, por megjithatë ka bërë progres.

Gjatë periudhës qershor-dhjetor 2021, MFE ka arritur të marrë informacion nga Autoritetet Kontraktuese për 184 nga 228 kontrata. Me informacionin e marrë deri më tani, MFE ka arritur të monitorojë rreth 81% të të gjitha kontratave (PPP dhe koncesione).

Komponenti 2.4: MFP-ja në qeverinë vendore

Të gjitha vlerat e synuara të produkteve që kanë si qëllim fuqizimin e planifikimit strategjik dhe menaxhimit të buxhetit në nivel të QV-së janë përmbushur. Gjatë vitit 2021, kuadri për planifikimin e programit buxhetor u lidh më mirë me efektivitetin dhe performancën e ofrimit të shërbimeve. U rishikua Udhëzimi Vjetor i Përgatitjes së PBA-së, duke përfshirë elementë të rinj të “Planifikimit të Shpenzimeve të bazuara në Produkt” si bazë për planifikimin dhe kostimin e ofrimit të shërbimeve sipas çdo programi buxhetor. Është përgatitur një model i ri për Dokumentin e PBA-së të NJVQV-ve dhe është prezantuar si aneks i ri i Udhëzimit Vjetor. Aneksi i ri u përfshi në Udhëzimin e Përgatitjes së PBA-së 2022-2024 duke ofruar një model të përmirësuar të dokumentit të PBA-së dhe raporteve për t'u përdorur nga të gjitha bashkitë. Metodologjia për përcaktimin e informacionit mbi performancën buxhetore dhe kostot e shërbimit ishte pjesë e përditësimit periodik të Udhëzimit Vjetor të Përgatitjes së PBA-së. 73 NJVQV-ve u janë ofruar trajnime për përdorimin e modelit të ri të dokumentit të PBA-së.

Një modul i ri i bazuar në excel është përgatitur për Programin e Planifikimit të Shpenzimeve në kuadër të përgatitjes së PBA-së. Moduli u pilotua pjesërisht nga bashkitë gjatë procesit të përgatitjes së PBA-së 2022-2024. Moduli: u mundëson NJVQVL-ve të krahasojnë performancën dhe detajet e kostos; automatizon llogaritjen e kostos për shërbime (produkte) dhe programe individuale; dhe udhëzon NJVQVL-të që të modifikojnë planet kur kostoja tejkalon burimet e disponueshme. Informacioni mbi performancën dhe kostot nuk ishte ofruar më parë në instrumentat e PBA-së, duke përfshirë Instrumenti i Planifikimit Financiar të MFE-së.

I mbështetur nga shtimi i praktikave online, u realizua një program trajnimi gjithëpërfshirës për përgatitjen e PBA-së për të 73 NJVQV-të (61 komuna dhe 12 këshilla të Qarqeve). Bashkitë kanë marrë trajnime duke përdorur platformën Zoom dhe janë grupuar sipas rajoneve. Trajnimi u organizua në tre raunde (nga gjashtë sesione trajnimi secili). Raundi i parë: 150 zyrtarë të lartë të trajnuar mbi udhëzimet dhe procesin e PBA-së. Raundi i dytë dhe i tretë: më shumë se 450 personel teknik, drejtues dhe anëtarë të Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP) të të gjitha 73 NJVL-ve të trajnuara për planifikimin e performancës së programeve buxhetore; mbi planifikimin e shpenzimeve të prodhimit dhe përdorimin e modelit të PBA-së; përdorimi i Paketës së Instrumenteve për Planifikimin e Shpenzimeve të Programit.

Është përgatitur plani për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Gjithashtu, janë përgatitur dhe publikuar raporte periodike për detyrimet e prapambetura të NJQV-së. Një raport vjetor për vështirësitë financiare të qeverisjes vendore është përgatitur nga MFE. Udhëzimi mbi paaftësinë paguese financiare i miratuar dhe zbatuar për dy vite radhazi (2019-2020). Kuadri i monitorimit të buxhetit është përmirësuar. Raporti vjetor, gjashtëmujor dhe 9 mujor për statistikën financiare të NJVQV-ve i përgatitur dhe publikuar për të tretin vit radhazi nga MEF. Të 61 bashkitë përgatisin dhe publikojnë raportin individual të monitorimit të ekzekutimit të buxhetit. MEF përgatiti një raport kombëtar të pajtueshmërisë.

Objekti i produktit për vitin 2021 me synimin për të krijuar një menaxhim efektiv të të ardhurave u arrit. 18 paketa fiskale 2020, 2021 dhe 2022 të bashkive, janë miratuar plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor të taksave vendore. 18 bashki miratuan dhe zbatuan fiskalin e tyre sipas metodologjisë së re të taksës së ndërtimit. Janë përmirësuar kapacitetet për përgatitjen e paketave fiskale bashkiake.

Objekti i produktit për vitin 2021 për të pasur një sistem të përmirësuar financimi të transfertave ndërqeveritare u arrit. MEF ka vazhduar financimin e arsimit parashkollor në bazë të numrit të nxënësve. Financimi i arsimit parashkollor është pjesë e vitit buxhetor 2021.

Për vitin 2021, MEF ka transferuar në të 61 bashkitë të ardhurat nga TAP. Në vitin 2021 TAP zbatohet plotësisht (pika (ç) e nenit 25 “Të ardhurat nga taksat e ndara” të ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes”). Në TM1 2021 janë ndarë 258.1 milionë lekë (në këtë shumë janë përfshirë 73.1 milionë lekë nga TM3

2020 dhe 185 milionë lekë për vitin 2021); në tremujorin e dytë janë ndarë 286 milionë lekë për bashkitë; Në tremujorin e tretë janë ndarë 250.5 milionë lekë për bashkitë (pjesa e mbetur prej 2% e TAP). Me këtë shpërndarje plotësohet shuma totale e pjesës së TAP që i përket bashkive për vitin 2021 (721.5 milionë lekë të akorduara për NJQV-të) Duke qenë se treguesit fiskalë për buxhetin e konsoliduar të vitit 2021 për dhjetor 2021, do të publikohen në janar 2022, pjesa e TAP do të ndahet atëherë (rregulluar në Udhëzimin "Për zbatimin e buxhetit për vitin 2022").

Madhësia e transfertave të përgjithshme të pakushtëzuara dhe të transfertave të pakushtëzuara sektoriale janë më shumë se 1.5 përqind e PBB-së. Faktikisht është 1,53 % e PBB-së 'Transferta e pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuar sektoriale janë ndarë përgjatë vitit buxhetor 2021.

DPHKBFP ka kryer shumë aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për të vendosur një funksion efektiv të kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm në nivel të qeverisjes vendore siç ishte planifikuar. Për të arritur rezultatet e synuara, gjatë vitit 2021, DPHKBFP ka ofruar asistencë teknike në 2 bashki (Krujë dhe Himarë). Bazuar në një plan të detajuar aktiviteti, është punuar për hartimin e planeve operacionale të punës, zbatimin e udhëzimit të miratuar të delegimit dhe përdorimin e linjave raportuese, hartimin e librit të proceseve të biznesit, gjurmës së auditimit, regjistrin të riskut dhe planit të veprimit për ngritjen e sistemit të MKF-së. Gjatë zbatimit të këtyre aktiviteteve është trajnuar stafi përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e instrumenteve të MKF-së (25 staf të trajnuar). Gjithashtu, është kryer vlerësimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm për 9 bashki, nga të cilat 4 janë vlerësuar pjesërisht efektive dhe 3 joefektive. Ndërkohë, në 2 bashki procesi i vlerësimit të cilësisë nuk është kryer pasi institucioni gjatë periudhës së vlerësimit nuk ka vënë në dispozicion të stafit të DPHKBFP asnjë dokument justifikues të krijuar.

Gjithashtu, në bashkëpunim me Projektin e Financave Lokale, është ofruar mbështetje për koordinorët e kontrollit të brendshëm të bashkive partnere, për procesin vjetor të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm gjatë vitit 2020 dhe rishikimin e planeve përkatëse të zhvillimit të rritjes së kapaciteteve për vitin 2021.

Gjithashtu, u përgatit manuali i procedurave (harta e proceseve dhe gjurmëve të auditimit) dhe planet e menaxhimit të riskut për tre procese komplekse që lidhen me parashikimin dhe mbledhjen e të ardhurave vendore. Manualët u përpunuan si pjesë e menaxhimit të riskut të bazuar në proces pas programit të trajnimit për koordinorët e riskut dhe auditorët e brendshëm. Stafi i 4 bashkive (Mirdite, Diber, Vlore & Dimal) u përfshinë në proces, duke shpërndarë eksperiencën dhe kontributin e tyre.

Gjatë vitit 2021, ekspertët e financave vendore mbështetën 3 bashki të tjera (Sarandë, Lushnjë dhe Tropojë) në ngritjen e grupeve të menaxhimit dhe koordinimit të riskut institucional dhe aktualisht po mbështesin bashkinë e Durrësit në ngritjen e Grupit Koordinues të Menaxhimit të Riskut.

Ekspertët mbështetën koordinorët e riskut të Bashkisë Lushnjë (sipas kërkesës), gjatë përgatitjes së (i) manualeve të procedurave dhe planeve përkatëse të menaxhimit të riskut në lidhje me shërbimet sociale, dhe (ii) planeve të menaxhimit të riskut në lidhje me planifikimin urban dhe objektivat e zhvillimit.

Gjatë këtyre aktiviteteve janë themeluar dhe funksionojnë 3 Grupe për Menaxhimin e Riskut dhe 80 koordinorë të riskut të 5 bashkive të trajnuara. Gjithashtu, janë përgatitur manualët e 3 proceseve për menaxhimin e të ardhurave dhe planet përkatëse të menaxhimit të riskut.

Të gjithë 131 auditorët e brendshëm që punojnë në bashkitë (49 bashki kanë njësi të auditimit të brendshëm) janë trajnuar mbi temën Auditimi i bazuar në risk në menaxhimin e aseteve (3 ditë). Përveç kësaj, të gjithë auditorët e brendshëm kanë marrë pjesë dhe janë trajnuar në kuadër të Programit të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional (CPD) për vitin 2021 (40 orë trajnim).

Objekti i produktit për vitin 2021 që synon rritjen e kapaciteteve të MOFE për të menaxhuar reformat e MFP-së në nivel të qeverisjes vendore u arrit. Të 73 dokumentet e PBA-së të dorëzuara nga NJVQV-të janë shqyrtuar nga MEF me rekomandime përkatëse për përmirësim. MEF ka krijuar procedura dhe kapacitete efektive për analizimin dhe shqyrtimin e dorzimeve të PBA-së.

Objektivat e produktit në lidhje me krijimin e SIPI/IPSIS në nivel të Qeverisjes Vendore nuk u arritën.

Asnjë nga NJQV-të nuk përdor sistemin SIPI/IPSIS për përgatitjen e kuadrit strategjik duke përfshirë pasaportat e treguesve. Udhëzimet për përdoruesit e SIPI/IPSIS nuk janë përgatitur dhe nuk janë mbajtur trajnime. Megjithatë, është zbatuar një mision AT në kuadër të Projektit STAR 3, me qëllim kryerjen e Rishikimit të Përputhshmërisë për Zbatimin e Planit Kombëtar të të Dhënave Sistemik dhe për të dhënë rekomandime për përmirësimin e zbatimit të tij.

Sfidat kryesore dhe hapat e ardhshëm

Në këtë Objektiv Specifik, komponenti më sfidues lidhet me Programin Buxhetor Afatmesëm. Pjesa më e madhe e produkteve që lidhen me këtë komponent nuk u arritën për shkak të situatës pandemike, mungesës së vullnetit politik për ndryshimin dhe miratimin e LOB-it, si dhe mungesës së stafit në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor (DAPB), të angazhuar në procesin e përgatitjes së udhëzimeve të reja buxhetore. Puna për finalizimin e tre udhëzuesve të tjerë sektorial, me qëllim zbatimin e Buxhetimit të Bazuar në Performancë, në të gjitha institucionet buxhetore, do të vazhdojë gjatë vitit 2022. Puna do të vazhdojë gjatë vitit 2022 duke vendosur një plan veprimi brenda DAPB, brenda qershorit, ku do të hartohen hapa specifikë për të arritur objektivin e produktit, në mënyrë që të shqyrtohen dhe financohen siç duhet të gjitha nismat e reja të politikave. Dy nga tre objektivat e produktit, që synojnë përmirësimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor (BPGJ) në nivelin e qeverisë qendrore, nuk u arritën. Sfida që ndikoi në këto objektiva të produkteve ishte vullneti politik dhe angazhimi i udhëheqjes në aspektin e Barazisë Gjinore nga NJQV-të. 10 bashki të reja dhe 4 bashki që janë mbështetur teknikisht në vitin 2021, do të mbështeten edhe gjatë vitit 2022. Do të zhvillohen aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve për ekipet e menaxhimit të buxhetit si dhe për Këshillat Bashkiak. Produkti në lidhje me përfshirjen e objektivave të politikave të pilotuara dhe TKP-ve përkatëse si aneks specifik në Ligjin e Buxhetit Vjetor nuk u arrit. Për shkak të situatës së pandemisë, nuk ka pasur mundësi për ndryshimin e Ligjit Organik të Buxhetit (LOB) për të krijuar të drejtën ligjore për ndryshimin dhe rritjen e cilësisë së dokumenteve buxhetore. Hapi tjetër është fillimi i punës për ndryshimin e LOB-it.

Sa i përket komponentit të Planifikimit dhe Mbikëqyrjes së Investimeve Publike, pavarësisht përpjekjeve të bëra nga MFE-ja për të marrë informacion nga Autoritetet Kontraktuese, ka pasur mungesë progresi në procesin e monitorimit për shkak të mungesës së raportimit periodik nga Autoritetet Kontraktuese. Risqet që ndikuan në zbatimin e këtij treguesi lidhen me organizimin e brendshëm dhe burimet njerëzore të Autoriteteve Kontraktuese, për shkak se nuk ka qënë e mundur ndarja e roleve dhe përgjegjësi për raportim dhe gjithashtu në disa raste ato nuk kanë pasur burime njerëzore të mjaftueshme për të përmbushur detyrimin e tyre lidhur me raportimin. MFE-ja do të vazhdojë të ndërgjegjësojë Autoritetet Kontraktuese mbi rëndësinë e procesit të monitorimit dhe raportimit të kontratave koncesionare/PPP, duke u dërguar herë pas here shkresë zyrtare për të theksuar detyrimin e tyre për të përcjellë raporte periodike për këto kontrata në MFE.

Procesi i përafrimit të të dhënave historike me kodet e reja të projektit u shty pasi kërkonte një punë të jashtëzakonshme mekanike, ndërkohë që departamenti kishte mungesë të stafit. Sfida kryesore mbetet identifikimi i projekteve pasi ka projekte të shumta investimi kryesisht nga ML-të. DRMIP është aktualisht duke bashkëpunuar me SIGMA për përfundimin e këtij aktiviteti. Puna për krijimin e një Liste të Unifikuar të Projekteve, për të gjitha projektet, pavarësisht burimit të financimit, ka përparuar mirë. Vetëm një nga tre objektivat e produktit nuk u arrit siç ishte synuar për vitin 2021. Një nga sfidat me të cilat përballlet procesi i krijimit të një departamenti të ri është hartimi i kuadrit ligjor të unifikuar për MIP dhe PPP. Procesi i bashkimit do të kërkojë ngritjen e kapaciteteve në fushën e PPP-ve dhe MIP-së. Duke qënë se bëhet fjalë për bashkim strukturor të këtyre departamenteve, hapi i parë është përgatitja e projektligjit për PPP-të & MIP-në, i cili do të çojë në bashkimin e dy departamenteve.

Lidhur me komponentin Zhvillimi i Politikave dhe Qeverisja së Integruar Strategjike, sfidat kryesore u lidhën me ndryshimet në fund të vitit 2021 me krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (ASHPSKN), në varësi të Kryeministrit. Kjo Agjenci do të jetë institucioni përgjegjës i cili do të sigurojë administrimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit

Informatik të Menaxhimit të Asistencës së Jashtme (SIMAJ) dhe Sistemit të Informacionit të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS), si dhe do të parashikojë kërkesat funksionale dhe do të propozojë ndryshime, në varësi të nevojës për funksionimin e duhur dhe përmirësimin e këtyre sistemeve elektronike.

Lidhur me komponentin MFP-ja në qeverinë vendore, objektivi i menaxhimit efektiv të të ardhurave është arritur, por disa sfida të hasura gjatë zbatimit ishin: mungesa e performancës në mbledhjen e taksave në disa bashki; procedura të paqarta; dhe nëse metodologjia e re e taksës së ndërtesës nuk miratohet mund të sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e qeverisjes vendore. Përsa i përket produktit për të siguruar funksionin efektiv të kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm, disa nga sfidat në kryerjen e aktiviteteve konsistojnë në: Mungesa e infrastrukturës së nevojshme për realizimin e aktivitetit; Disponueshmëria dhe mungesa e infrastrukturës së institucionit pritës gjatë datave të përcaktuara për realizimin e aktivitetit; dhe Ngarkesa e punës dhe disponueshmëria e ekspertëve të Projektit të Financave Lokale. Gjithashtu, objektivi i produktit në lidhje me rishikimin e PBA-së të 61 NJQV-ve nga MFE-ja u arrit, por një sfidë e hasur ishte se dokumentet e PBA-së nuk ishin sipas formateve të miratuara nga MFE-ja.


3.3 Ecuria për Objektivin Specifik 3 “Mbledhja e të ardhurave”

Për të përmirësuar mbledhjen e të ardhurave, u bënë përpjekje për (i) rritjen e nivelit të të ardhurave nga tatimet; (ii) reduktimin e informalitetit nëpërmjet rritjes së vet-deklarimit dhe rritjes së forcës së kontrollit të zbulimit; dhe (iii) rritjen e nivelit të të ardhurave nga doganat. Kadastra fiskale nuk ishte plotësisht funksionale. Treguesi i performancës në lidhje me kohën e përpunimit të deklaratave doganore nuk ka ecur siç ishte planifikuar. Gjatë vitit 2021, niveli i arritjes së objektivave të treguesve të performancës së rezultateve që synojnë përmirësimin e mbledhjes së të ardhurave u vlerësua si shumë i mirë, me 86% të progresit të bërë, duke qëndruar në të njëjtën kategori krahasuar me vitin 2020 (94, 1% shumë mirë).

Tabela 4: Treguesit e Performancës së Rezultateve për OS3

Rezultati	Treguesi i performancës	Vlera Faktike VF 2020	Vlera e synuar VF 2021	Vlera faktike VF 2021
VII) Rritja e nivelit të të ardhurave nga tatimi	VIIa) Baza e tatimit të bizneseve	47.6% (165,955 biznese në 2020)		62.4% (182,632 biznese në 2021)
	VIIb) % e mbledhjes faktike të tatimeve në vitin N /mbledhja faktike në vitin N-1 -100% (nga tatimet)	-7.20%	12.0%	14.5%
	VIIc) Përpjestimi i borxhit të tatimit të mbledhur në vitin N kundrejt shumës së prapambetur të detyrimeve tatimore	78.39%	62%	62.7%
VIII) Ulja e informalitetit nga rritja e vet-deklarimit dhe rritje e forcës së kontrollit të zbulimit	VIIIa) Raporti i deklarimeve tatimore kundrejt vitit paraardhës	2.21% (2,876,202 të kthyer në 2020, vs 2,814,005 në 2019)	< 0%	-8.08% (2,641,559 të kthyer në 2021 vs 2,876,202 në 2020)
IX) Kadastra fiskale tërësisht funksionale	IXa) Numri i ndërtesave të regjistruara dhe të faturuara	80% (1 200 000/1 500 000)	86.7% 1 300 000/1 500 000	80% (1 200 000/1 500 000)
X) Rritje e nivelit të të ardhurave nga doganat	Xa) % e mbledhjes faktike të ardhurave doganore në vitin N /mbledhja faktike e të ardhurave doganore në vitin N-1 -100% (nga doganat)	-6.10%	9%	25.7%
	Xb) Koha e përpunimit të deklaratave doganore	97	70	88

Grafiku 6: Statusi i objektivave të produkteve të OS3 për vitin 2021



Në përgjigje të kërkesës së MFE-së për mbështetje dhe udhëzim për përgatitjen e një Strategjie Afatmesme të të Ardhurave (SAA), një mision i Fondit Monetar Ndërkombëtar për administrimin e të ardhurave vizitoi Tiranën në nëntor të vitit 2019 dhe parashikoi mundësitë për të adresuar zonat me risk të lartë të mospërputhjes tatimore dhe për të forcuar administrimin e të ardhurave. SAA është një strategji e cila u hartua gjatë tremujorit të parë të vitit 2020 dhe pritej të dilte për konsultim publik gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020 dhe më pas të zbatohet në tremujorin e fundit të vitit 2020, por me nisjen e pandemisë së COVID 19 u bë më pak e përshtatshme. Objektivi i produktit që synonte miratimin e një strategjie afatmesme të të ardhurave nuk u arrit ashtu siç ishte synuar në vitin 2021. Strategjia u përditësua gjatë vitit 2021. Ndërkohë, gjatë vitit 2021 vazhdoi puna me rishikimin e draft strategjisë, si nevojë për ndryshimin e kushteve të tregut.

Një Sistem i ri i Teknologjisë së Informacionit (TI) për Administrimin e Taksave është vënë në punë që prej janarit të vitit 2015 dhe rishikimet e sistemit përfunduan në vitin 2017. Në vitin 2015, administrata tatimore filloi zbatimin e metodologjisë bashkëkohore të menaxhimit të riskut të pajtueshmërisë (MRP), duke synuar të përmirësojë pajtueshmërinë e tatimpaguesit bazuar në grupe (p.sh. e fokusuar në industri). Informacioni për tatimet është thjeshtuar dhe informacioni për tatimpaguesit është përmirësuar nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, fushatave të ndërgjegjësimit dhe krijimit të një qendre telefonike. Gjatë vitit 2019, administrata tatimore përfundoi modelin për procedurat e automatizuara të bazuara në risk për të gjitha rimbursimet e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) dhe pjesa dërrmuese e punës për zbatimin e rimbursimeve automatike të TVSH-së është kryer gjatë vitit 2020 dhe është realizuar 95% gjatë vitit 2021. Platforma e rimbursimit do të shfaqet drejtpërdrejtë brenda tremujorit të parë të vitit 2022.

Si përfundim, periudha e shlyerjes së rimbursimit të TVSH-së u përgjysmua dhe stoku i papaguar i rimbursimit të TVSH-së, në vitin 2020 u ul me 16% krahasuar me vitin 2019. Në dhjetor të vitit 2021, version Test (version përfundimtar i testit) u mor nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT). Vazhdoi testimi në mjedisin e provës (version përfundimtar) dhe u bënë përmirësimet e nevojshme nga Pala Zhvilluese. Demonstrimi përfundimtar i rrjedhës së punës u krye për funksionet e DPT-së të përfshira në proces.

Një pjesë e automatizimit të proceseve bazë të administrimit tatimor përfshinte përmirësimin e modulit të menaxhimit të faturave elektronike, i cili filloi në vitin 2019, më herët se sa ishte planifikuar. Është bërë përparim drejt përfundimit të kontrollit automatic të kryqëzuar që do të përdorej për të verifikuar informacionin e kthimit. Modulet përkatëse në kuadër të fiskalizimit janë zbatuar 100%. Moduli i asetit zbatohet në formatin “të pavarur”; ende në pritje të shërbimeve të internetit nga palët e treat (Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Rrugore, Noterët dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës). Gjatë vitit 2019, DPT krijoi një regjistër të plotë dhe të saktë të tatimpaguesve, i cili kontribuoi më tej në infomimin e të gjithë tatimpaguesve dhe inkurajoi korrigjimin vullnetar të detyrimeve tatimore. Bazuar në Marrëveshjen ndërmjet DPT-së dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), është realizuar transmetimi në kohë i të dhënave për regjistrimet dhe ndryshimet në regjistrime. Janë bërë zhvillime të reja në marrjen e informacionit nga QKB-ja për kompanitë e likuiduara, të bashkuara apo të ndara. Kjo e fundit, së bashku me analizat e kryera nga Departamenti i Menaxhimit të Riskut për përzgjedhjen për auditim të tatimpaguesve me rrezik të lartë, mbështeti një nga objektivat kryesore të Departamentit të Tatimeve lidhur me reduktimin e informalitetit. Me dorëzimin e pasqyrave financiare ka detyrim që të raportohen edhe të dhënat kontabël.

Çdo vit hartohet rregullorja për dorëzimin e pasqyrave financiare dhe në fund bëhet analiza e pasqyrave financiare të dorëzuara.

Reforma për taksën mbi pronën është vonuar për shkak të ngjarjeve të paparashikuara dhe për rrjedhojë gjatë vitit 2020 MFE, SIDA dhe Agjencia Shtetërore e Taksave kanë arritur një marrëveshje me qëllim shtyrjen e agjendës së reformës për taksën mbi pronën me dy vjet. Është krijuar një strukturë e dedikuar që synon të krijojë dhe menaxhojë në mënyrë qendrore sistemin e informacionit të kadastrës fiskale dhe reformën e tatimit në pronë si dhe është krijuar kuadri ligjor për tatimin në pronë bazuar në çmimet e referencës. Gjatë vitit 2019 nisi tatimi mbi pronën në bazë të vlerës së zonës fiskale për ndërtesat dhe funksionalizimi i mbledhjes së taksave. Duke qënë se projekti është i zgjatur, procesi i vlerësimit nuk është kryer ende për shkak të mungesës

së cilësisë së të dhënave ose mungesës së të dhënave. Analiza e të dhënave është në proces. Për shkak të mungesës së të dhënave dhe mungesës së informacionit, hapi tjetër është puna për një hulumtim tregu nga burime alternative, për të patur disa informacione shtesë për analizën krahasuese dhe procesin e vlerësimit. Një sistem i ri TI u prezantua në vitin 2018 dhe që atëherë është përditësuar. Sistemi i TI-së është përmirësuar dhe do të jetë gati për taksim. Në këtë aspekt, në vitin 2021 ka filluar një proces pilot në disa prej bashkive. Janë zhvilluar trajnime për stafin e bashkive.

Kuadri rregullator i DPD është rishikuar vazhdimisht për të qenë në përputhje me *Acquis Communautaire* të BE-së, duke përfshirë zhvillimin më të fundit, p.sh., përafrimi i Informacionit të Detyruar Tarifor dhe Nomenklaturës së Mallrave. Gjatë viteve 2015-2020 është përmirësuar efikasiteti dhe transparencja e dhënies së shërbimit doganor në pikat e kalimit kufitar. DPD-ja nuk arriti të miratojë Operatorët Ekonomikë të Autorizuar (OEA) të planifikuar në vitin 2019, megjithatë janë zhvilluar aktivitete ndërgjegjëse lidhur me përfitimet, procedurat dhe programet. Megjithatë, gjatë vitit 2021, tetë aplikime nga 16 morën miratimin për statusin e OEA. Moduli i garancisë së vetme u zbatua. Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifave dhe sistemi i TI-së për të ndihmuar në luftën kundër pastrimit të parave dhe terrorizmit janë në proces implementimi. Në vitin 2021, përqindja e mbledhjes aktuale të të ardhurave doganore ishte 25.7%. Ka pasur një rritje të të ardhurave të mbledhura krahasuar me vitin 2020 dhe ka tejkaluar objektivin e vitit 2021. Të ardhurat në 12M 2021 janë realizuar në vlerën 193.2 milionë lekë nga 169.05 mld lekë të planifikuara ose rreth 24.1 milionë lekë më shumë (rreth 240 milionë dollarë më shumë). 79% e suksesit të të ardhurave vjen si rezultat i rritjes ekonomike, rritjes së flukseve të importeve dhe qeverisjes së mirë, ndërsa 21% si rezultat i efektit të çmimit. Objektivi i rezultatit i lidhur me kohën e përpunimit të deklaratës doganore në nivelin 70 min/deklaratë nuk u arrit. Koha e përpunimit të deklaratës në vitin 2021 ishte 88 min/deklaratë. Megjithatë, ka një përmirësim krahasuar me vitin 2020 (97 min/deklaratë). Ka një rritje të kohës së përpunimit të deklaratave në kanalën e gjelbër me rreth 1 min. Rritja e kohës së deklarimeve në kanalën e gjelbër vjen nga faktorë jashtë ndikimit të administratës doganore.

Ecuria e komponentëve gjatë vitit 2021

Komponenti 3.1 Administrimi tatimor

Objektivi i produktit që synon miratimin e një strategjie gjithëpërfshirëse afatmesme të të ardhurave ka bërë disa përparime. Gjatë vitit 2021, puna vazhdoi me rishikimin e draft strategjisë, si nevojë për ndryshimin e kushteve të tregut.

Objektivi i produktit në lidhje me zbatimin e procedurave të automatizuara të bazuara në risk për të gjitha rimbursimet dhe kreditë e TVSH-së të bartura nuk u arrit siç ishte synuar për vitin 2021, por është bërë progres. U krye pjesa më e madhe e punës për zbatimin automatik të rimbursimit të TVSH-së dhe u realizua 95% gjatë vitit 2021. Platforma e rimbursimit do të dalë “live” brenda tremujorit të parë të vitit 2022. Për shkak të angazhimeve të paplanifikuara që kompania e zhvillimit kishte nga situata e Covid 19, nuk ishte e mundur që të vihej në dispozicion platforma/sistemi i rimbursimit të TVSH-së gjatë vitit 2020, aktivitet i cili u shty. Në dhjetor të vitit 2021 u mor nga DPT version test (version përfundimtar i testit). Vazhdoi testimi në mjedisin e provës (version përfundimtar) dhe u bënë përmirësimet e nevojshme nga Pala Zhvilluese. Demonstrimi përfundimtar i rrjedhës së punës u krye për funksionet e DPT-së të përfshira në proces.

Objektivat e produktit në lidhje me automatizimin e plotë të proceseve kyçe të administratës tatimore kanë bërë njëfarë progresi.

Objektivi i produktit në lidhje me kapacitetet e disponueshme të Data Warehouse (DWH) nuk u arrit siç ishte synuar në vitin 2021, por është bërë progres. Grupi i punës DWH u krijua në mars të vitit 2021 për të identifikuar regjistrat dhe të dhënat e përdorura nga AT dhe për të strukturuar të dhënat në mënyrë që të integrohen në DWH.

Një pjesë e automatizimit të proceseve kyçe të administratës tatimore përfshinte prezantimin e modulit të menaxhimit të faturave elektronike. Modulet përkatëse në kuadër të fiskalizimit janë zbatuar 100%. Moduli i

asetit zbatohet në formatin “të pavarur”; ende në pritje të shërbimeve të internetit nga palët e treta (Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Rrugore, Noterët dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës).

Objektivi i produktit lidhur me ndërlidhjen e sistemit të TI me sistemet bankare dhe me sistemin e menaxhimit të pasurive të paluajtshme nuk u arrit. Kriteret e Modullit të riskut janë përditësuar, përmirësuar dhe analizuar në bashkëpunim me një ekspert të FMN-së. Kriteret e riskut të Modullit të Fiskalizimit do të zbatohen në vitet në vijim.

Trajnimi i stafit për menaxhimin e riskut që synonte të ndërtonte një sistem gjithëpërfshirës të Menaxhimit të Riskut të Pajtushmërisë u përmbush sipas planifikimit. Ekspertët e FMN-së zhvilluan trajnime për 14 anëtarë të stafit të Departamentit të Menaxhimit të Riskut dhe në fushën e analizës së të dhënave.

U përmbushën të dy objektivat për krijimin e një regjistri të saktë të tatimpaguesve. Marrëveshja e nënshkruar ndërmjet DPT-së dhe QKB-së bëri të mundur transmetimin në kohë të të dhënave për regjistrimin dhe ndryshimet përkatëse të kompanive, përfshirë ato që ishin likuiduar, bashkuar apo ndarë. Një faktor tjetër që lehtësoi plotësimin e regjistrimit ishin tre fushatat sensibilizuese të organizuara në vitin 2021: plani i komunikimit për ndryshimet ligjore (takime online me tatimpaguesit, trajnime të stafit, përditësimi i ndryshimeve në internet, njoftimet në internet, etj); plani i komunikimit për sezonin turistik (njoftime në internet, takime me taksapaguesit, njoftime në media, etj) dhe i treti, plani i komunikimit për fiskalizimin (njoftimet në internet, takime online me taksapaguesit, trajnime intensive online me taksapaguesit, trajnime me stafin, njoftime në media dhe rrjete sociale, etj).

DPT-ja përmbushi gjatë vitit 2021 objektivat që synonin reduktimin e informalitetit. U mbuluan: a) Planin i Rindërtimit Sektorial. Janë identifikuar tatimpaguesit e pajisur me autorizim për përjashtim nga TVSH-ja në kuadër të procesit të rikonstruksionit me kritere risku të thyera; b) Planin i Sektorit të Turizmit. U zbatua plani sectorial në Hoteleri-Turizëm-Bar-Restorante në të gjithë zonën bregdetare gjatë sezonit veror; c) Vazhdimi i planit sectorial në tregun e punës. U zbatua plani i informalitetit në tregun e punës bazuar në katër komponentët e tij: mosregjistrimi i punonjësve; deklarimi i pasaktë i pagave; deklarimi i pasaktë i kategorisë së punonjësit dhe profesionit; deklarimi i pasaktë i kohës së punës. Janë miratuar nëntë kritere risqesh me ndikim në analizën dhe identifikimin e tatimpaguesve që nuk respektojnë planin e Informalitetit në tregun e punës. Gjithashtu janë miratuar rregullat e riskut për monitorimin e tatimpaguesve në kuadër të ndryshimit të pragut të regjistrimit në TVSH dhe detyrimin e tatimit mbi fitimin.

Janë përmbushur objektivat e produktit në lidhje me prodhimin e raportit. Janë miratuar rregullat e riskut për monitorimin e tatimpaguesve në kuadër të ndryshimit të pragut të regjistrimit në përgjegjësinë e TVSH-së dhe tatimit mbi fitimin. Janë identifikuar tatimpaguesit mujorë të bizneseve të mëdha që kanë raporte të pafavorshme shitblerje si dhe tatimpaguesit të cilët identifikohen me riskun e mosdeklarimit të xhiros reale për të përfutur pragun e regjistrimit të TVSH-së prej 10 milionë lekë dhe tatimit mbi fitimin 14 milionë lekë dhe tatimpaguesit me sjellje derivative dhe ndryshim të llojeve të biznesit sipas xhiros së deklaruar. Është monitoruar ecuria e regjistrimit dhe evidentimit të tatimpaguesve të mëdhenj që duhet të përfundonin procesin e fiskalizimit brenda datës 31.12.2021. Brenda vitit 2021, të gjithë tatimpaguesit (tatimpaguesit e mëdhenj dhe bizneset e vogla) me TVSH kanë aplikuar faturimin elektronik. Me dorëzimin e pasqyrave financiare është e detyrueshme që të raportohen edhe të dhënat kontabël. Çdo vit hartohet rregullorja për dorëzimin e pasqyrave financiare dhe në fund bëhet analiza e pasqyrave financiare të dorëzuara.

Komponenti 3.2: Kadastra fiskale e pronave

Objektivat e përcaktuar për vitin 2021 për krijimin e një takes mbi pronën “ndërtesë” të bazuar në vlerën fiskale të një zone dhe funksionaliteti i mbledhjes së taksave nuk janë arritur. Qëllimi i kadastrës ishte konsolidimi dhe përmirësimi i cilësisë së të gjitha të dhënave ekzistuese për tokën, ndërtesat dhe pronarët/banorët, si dhe llogaritja e detyrimit tatimor vjetor që lidhet me secilën pronë. Taksimi i parë i ndërte-

save nuk mund të kryhej për shkak të cilësisë së ulët të të dhënave të lartpërmendura dhe mungesës së angazhimit të bashkive në regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave në sistem. Objektivi i produktit në lidhje me procesin e vlerësimit të zonave me vlerë për ndërtesat e përcaktuara në të gjitha bashkitë nuk u arrit.

Komponenti 3.3: Menaxhimi doganor

Dy nga tre objektivat e produkteve të vendosura për vitin 2021, për të nxitur mbledhjen e detyrimeve duke përmirësuar politikat/procedurat dhe proceset doganore, janë përmbushur. Moduli i garancisë së vetme u zbatua dhe aktualisht është në fazën e testimit. Gjatë vitit 2021, vazhdoi zhvillimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë në laboratorin e Doganës me qëllim analizimin e të gjitha mallrave të importit dhe akcizës që mbërrijnë në Shqipëri. Për statusin e OEA aplikuan 16 subjekte dhe tetë prej tyre morën miratimin për statusin e OEA. Kontrata për Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Tarifave (ITMS) është në zbatim; pajisjet mbërritën dhe u testuan në ambientet e Agjencisë Kombëtare të Shqipërisë së Informacionit (AKSHI).

DPD po punon për të krijuar një sistem gjithëpërfshirës të menaxhimit të riskut në përputhje me BE-në. Sistemi i TI-së për të ndihmuar në luftën kundër pastrimit të parave dhe terrorizmit është në zbatim. Vonesat u lidhën me Abonimin e Kontratës së Përmirësimit të ASYCUDA me UNCTAD. Trajnimet vazhduan gjatë vitit 2021, por ishin të kufizuara për arsye të COVID19.

Sfidat kryesore dhe hapat e ardhshëm

Në këtë Objektiv Specifik, komponenti më sfidues lidhet me Kadastrën Fiskale të Pronave. Produkti që lidhet me këtë komponent nuk është arritur, për shkak të riskut të sistemit të TI-së dhe riskut operacional. Taksimi i parë i ndërtesave nga sistemi nuk mundi të kryhej për shkak të mungesës së angazhimit të bashkive në regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave në sistem dhe cilësisë së ulët të të dhënave. Sistemi i TI-së është përmirësuar dhe do të jetë gati për taksim. Në këtë aspekt ka filluar një proces pilot në disa prej bashkive. Gjashtë bashki pilote do të përdorin sistemin e kadastrës fiskale për të mbledhur taksën e ndërtimit. Objektivi i produktit, në lidhje me procesin e vlerësimit të zonave me vlerë për ndërtesat e përcaktuara në të gjitha bashkitë, nuk u arrit për shkak të riskut operacional. Duke qënë se projekti ka qënë i zgjatur, procesi i vlerësimit nuk u krye për shkak të të dhënave jo cilësore ose mungesës së të dhënave. Të dhënat e analizës janë në zhvillim e sipër. Për shkak të mungesës së të dhënave dhe mungesës së informacionit, hapi tjetër është puna për një hulumtim tregu nga burime alternative, për të patur disa informacione shtesë për analizën krahasuese dhe procesin e vlerësimit. Lidhur me Menaxhimin Doganor, gjatë vitit 2021, ka pasur vonesa në zbatimin e ITMS për shkak të nënshkrimit të kontratës nga Komisioni i BE-së. Gjithashtu, ka pasur vonesa në lidhje me sistemin e TI-së për të ndihmuar në luftën kundër pastrimit të parave dhe terrorizmit, për shkak të vonesave të lidhura me Abonimin e Kontratës së ASYCUDA-së me UNCTAD. Sfidat për zhvillimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë lidhet me mungesën e fondeve për mirëmbajtjen e pajisjeve.

Për sa i përket Administratës Tatimore, nuk u arrit ashtu siç ishte synuar për vitin 2021 objektivi i produktit që synon miratimin e një strategjie gjithëpërfshirëse afatmesme të të ardhurave, por janë bërë disa përparime. SAA-ja është një strategji e cila është hartuar gjatë tremujorit të parë të vitit 2020 dhe pritej të dilte për konsultim publik gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020 dhe më pas të zbatohet në tremujorin e fundit të vitit 2020. Situata e jashtëzakonshme dhe me të panjohura, me të cilën u përball jo vetëm vendi ynë, por e gjithë bota si pasojë e pandemisë Covid 19, ndikuan në marrjen e një hapi prapa për të gjitha planet që kishte vendi ynë, në mënyrë që të përballonte situatën e rënduar financiare dhe psikologjike të taksapaguesve dhe qytetarëve. Për shkak të pandemisë, në një situatë të rënduar ekonomike si për individët ashtu edhe për bizneset, propozimi i politikave të reja fiskale u bë thuajse i pamundur. Gjatë kësaj periudhe janë marrë masa emergjente fiskale për ngrirjen/shtyrjen e pagesave të taksave për të mbështetur bizneset në kushtet e vështira të pandemisë. Drafti i SAA-së do të miratohet brenda vitit 2022.

Objektivi i produktit në lidhje me zbatimin e procedurave të automatizuara të bazuara në risk për të gjitha rimbursimet dhe kreditë e TVSH-së të bartura nuk u arrit siç ishte synuar për vitin 2021. Është realizuar 95%

e objektivit gjatë vitit 2021 dhe sistemi do të fillojë të funksionojë në prill të vitit 2022 pasi të jenë finalizuar testet.

Objektivi i produktit në lidhje me aftësitë e disponueshme të Data Ëarehouse (DËH) nuk u arrit. Grupi i punës DWH u krijua në mars të vitit 2021 për të identifikuar regjistrat dhe të dhënat e përdorura nga AT dhe për të strukturuar të dhënat në mënyrë që të integrohen në DËH.

Objektivi i produktit lidhur me ndërlidhjen e sistemit të TI me sistemet bankare dhe me sistemin e menaxhimit të pasurive të paluajtshme nuk u arrit. Kriteret e Modulit të riskut janë përditësuar, përmirësuar dhe analizuar në bashkëpunim me një ekspert të FMN-së. Kriteret e riskut të Modulit të Fiskalizimit do të zbatohen në vitet në vijim.


3.4 Ecuria për Objektivin Specifik 4 “Zbatim efikas i buxhetit”

Për të siguruar përdorimin efikas dhe efektiv të burimeve buxhetore të miratuara, janë bërë përpjekje për të të (i) Stoku i shpenzimeve (detyrimet e prapambetura si përqindje e totalit të shpenzimeve për vitin fiskal); (ii) Monitorimi i detyrimeve të prapambetura të shpenzimeve (në SIFQ); (iii) Stoku i borxhit të brendshëm të risistemuar brenda një viti; dhe (iv) Maturimi mesatar i borxhit të brendshëm; v) % në vlerë për procedurat e përfunduara me fitues brenda semestrit të parë kundrejt shumës së parashikuar në regjistrin e parashikimeve; vi) Përqindja e rasteve kur organi i shqyrtimit nuk ka respektuar afatet kohore të shqyrtimit të rastit. Treguesi i performancës që lidhet me shumën totale të buxhetit që është ekzekutuar me anë të SIFQ në raport me shumën totale të buxhetit të ekzekutuar nga qeveria qendrore, nuk ka progresuar sikurse planifikuar. Gjatë vitit 2021, niveli i arritjes së objektivave të treguesve të performancës së rezultateve që synojnë të forcojnë përdorimin efikas dhe efektiv të burimeve buxhetore të miratuara u vlerësua si shumë e mirë, me 106 % të progresit të bërë, duke qëndruar në të njëjtën kategori krahasuar me vitin 2020 (93% - shumë mirë).

Tabela 5: Treguesit e Performancës së Rezultateve për OS4

Rezultati	Treguesi i performancës	Vlera Faktike VF 2020	Vlera e synuar VF 2021	Vlera faktike VF 2021
XI) Zbatimi efikas i buxhetit me anë të përdorimit të TI-së)	XIa) Shuma totale e buxhetit që është ekzekutuar me anë të SIFQ në raport me shumën totale të buxhetit të ekzekutuar nga qeveria qendrore.	78%	≥ (t-1) (tendencë në rritje)	75.5%
XII) Detyrimet e prapambetura minimizohen	XIIa) PEFA 22.1. Stoku i shpenzimeve (detyrimet e prapambetura si përqindje e totalit të shpenzimeve për vitin fiskal)	4.40%	nën 3%	nën 3% (2.2%)
	XIIb) PEFA 22.2 Monitorimi i detyrimeve të prapambetura të shpenzimeve (në SIFQ)	A	A (të dhënat jepen cdo tremujor, brenda 4 javëve në fund të secilit tremujor)	A (të dhënat jepen cdo tremujor, brenda 4 javëve në fund të secilit tremujor)
XIII) Ulet kostoja e huasë dhe likuiditeti është i disponueshëm kur nevojitet	XIIa) Stoku i borxhit të brendshëm të risistemuar brenda një viti	46.7	Max 48%	48.0%
	XIIb) Maturimi mesatar i borxhit të brendshëm	783	792 - 864 ditë	793
XIV) Rritet efikasiteti dhe transparencia e sistemit të prokurimit	XIVa) % në vlerë për procedurat e përfunduara me fitues brenda semestrit të parë kundrejt shumës së parashikuar në regjistrin e parashikimeve	47.4%	(tendencë në rritje)	60.2%
	XIVb) Përqindja e rasteve kur organi i shqyrtimit nuk ka respektuar afatet kohore të shqyrtimit të rastit	22.10%	≤ (t-1) (tendencë në ulje)	10.8%

Grafiku 7: Statusi i objektivave të produkteve të OS4 për vitin 2021



SIFQ-ja është mjeti kyç i bazuar në sistem për kontrollimin dhe monitorimin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Qeveria planifikon të shtrijë sistemin në të gjitha IB-të kryesore. Gjatë periudhës 2014-2021, 15 institucione buxhetore u regjistruan në SIFQ, duke përfaqësuar rreth 75.5 % të shpenzimeve totale. Treguesi është pak më i ulët në krahasim me vitin e mëparshëm për shkak të vëllimit buxhetor të IB-ve ekzistuese online në SIFQ dhe jo për shkak të rënies së numrit të IB-së online në sistem, numri i IB-ve mbetet i njëjtë gjatë vitit 2021. Progres i mirë u arrit me integrimin e SIFQ me Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), i cili realizua në nëntor 2021 dhe për herë të parë 45 IB mundën të ekzekutonin listën e pagave përmes SIFQ. Web Portal për arkivën elektronike ishte i aksesueshëm për 145 IB deri në fund të vitit 2021. Vitet e para të zbatimit të Strategjisë synonin të krijonin masa mbrojtëse të nevojshme për të parandaluar një grumbullim të ri të detyrimeve të prapambetura duke futur kontrole të angazhimeve shumëvjeçare. SIFQ u zgjerua për këtë qëllim, në mënyrë që IB-të të mos mbi-angazhoheshin. Gjithashtu, u lëshua një udhëzim i ri për të standardizuar procedurën për menaxhimin e tavaneve të angazhimeve. Megjithatë, ende shfaqen detyrime të reja të prapambetura dhe rrjedhimisht masat për të përforcuar angazhimin dhe kontrolluar shpenzimet kanë vijuar të jenë në fokus të MFE-së. Në vitin 2020, nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë u krijua një Grup Pune për detyrimet e prapambetura (DPMDP) për të monitoruar zhvillimin e tyre dhe për të dhënë rekomandime sistematike. Në vitin 2021, norma e detyrimeve të prapambetura si përqindje e totalit të shpenzimeve ishte 2.2%, duke arritur objektivin nën 3% dhe më të ulët se vlera faktike e vitit 2020 (4.4%). MEF po punon drejt forcimit të përputhshmërisë me kontrollet e angazhimeve dhe parandalimin e akumulimit të detyrimeve të reja të prapambetura dhe sigurimin e raportimit transparent për stokun e detyrimeve të prapambetura. Objektivi i lidhur me treguesin e rezultateve Shpenzimet Publike dhe Llogaridhënia Financiare (PEFA) 22.2 Monitorimi i detyrimeve të prapambetura të shpenzimeve është përmbushur, të dhënat gjenerohen çdo tremujor brenda katër javëve nga fundi i çdo tremujori. Një zhvillim pozitiv ishte angazhimi i auditorëve të brendshëm në auditimin e detyrimeve të prapambetura në subjektet më problematike. Gjetjet dhe rekomandimet u përfshinë në raportin vjetor të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (KBFP) 2021 dhe u diskutuan gjerësisht në mbledhjet e Bordit të KBFP.

DP e Thesarit ka punuar për të përmirësuar parashikimin dhe monitorimin e likuiditetit dhe pjesa më e madhe e objektivave u arritën gjatë viteve 2019 - 2021. Në vitin 2021, stoku i borxhit të brendshëm i risistemuar brenda një viti ishte 48%. Ka një rritje krahasuar me vitin 2020, por mbetet brenda objektivit të vitit 2021. Instrumenti standard dhe ai me Eurobond që maturohet në vitin 2022 nuk lejojnë përmirësim të mëtejshëm të këtij treguesi. Maturimi mesatar i borxhit të brendshëm është 793 ditë. Ka një tend në rritje, por brenda objektivit. Emetimi u fokusua në instrumente afatmesme. DPB po punon për përgatitjen e një Strategjie të re të Menaxhimit të Borxhit, e cila pritet të përfundojë brenda qershorit 2022.

Është arritur progres në ndryshimin e Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) për të përafruar më tej me *Acquis Communautaire* (direktivat e reja të BE-së). Një ligj i ri për prokurimin publik është miratuar në dhjetor 2020, duke transpozuar 4 direktiva të BE-së. Në vijim të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, legjislacioni sekondar u miratua në vitin 2021. Planet për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të prokurimit elektronik (SPE) që nuk u materializuan gjatë vitit 2020 u zbatuan gjatë vitit 2021. SPE ka pësuar ndryshime në funksionalitetin e tij për t’iu përshtatur kuadrit të ri ligjor dhe gjithashtu për të përmirësuar performancën e tij të përgjithshme. Ndërfaqja e SIFQ dhe SPE u krijua në vitin 2020 dhe kontrolli online i fondeve të disponueshme mund të kryhej përpara se të fillonte çdo procedurë prokurimi. Treguesi % në vlerë të procedurave të përfunduara me fitues brenda semestrit të parë kundrejt shumës së parashikuar në regjistrin e parashikimeve për vitin 2021 ishte 60.2%, ka pasur një tendencë në rritje krahasuar me vitin 2020. Përsa i përket Komisionit të Prokurimit Publik (KPP), masat ligjore dhe rregullatore janë ndërmarrë për të rritur pavarësinë e saj. KPP-ja e re u vu në zbatim në 16 korrik 2018 dhe të gjitha vendet vakante u plotësuan sipas planit për periudhën 2019 - 2021. Nga data 27 tetor 2021, sistemi elektronik i menaxhimit të ankesave në fushën e prokurimit publik është ngritur dhe zbatuar me sukses. Përqindja e rasteve kur organi shqyrtues tejkalon kohën maksimale ligjore të shqyrtimit për vitin 2021 ishte 10.8%, ka pasur një tendencë në rënie krahasuar me vitin 2020. Përmirësimi i këtij treguesi ka ardhur si rezultat i mirëmenaxhimit të punës.

Një sistem për menaxhimin e fondeve të jashtme, SIMAJ u vu në zbatim në qershor të vitit 2018 dhe po punohet për forcimin e pajtueshmërisë me futjen e të dhënave të kërkuara dhe përdorimin e tyre si burimin kryesor të informacionit për të gjitha fondet e donatorëve. Gjatë vitit 2019, të gjitha të dhënat në lidhje me projektet e BB-së janë futur për shkak të integritetit të plotë të SIMAJ me Lidhjen e Klientit të BB-së. Gjatë viteve 2020-2021, po bëhen përpjekje për të regjistruar të dhënat e ndihmës së jashtme të viteve 2017-2020. Është rritur ndërgjegjësimi i komunitetit të Partnerëve për Zhvillim dhe janë organizuar sesione trajnimi përditësuese sipas kërkesës.

Kuadri rregullator për ndihmën shtetërore u përmirësua për të qenë në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet e BE-së. Gjatë vitit 2019, MFE-ja punoi në përgatitjen e akteve nënligjore dhe u krijua një grup ndërministror pune për ndihmën shtetërore dhe takimi i parë u mbajt në dhjetor 2019. Me kalimin e viteve janë bërë përpjekje për të përmirësuar bazën e të dhënave për monitorimin e zbatimit të ndihmës shtetërore si dhe janë realizuar aktivitete për ndërgjegjësimin për rolin dhe detyrat e Komisionit të Ndihmës Shtetërore (KNSh). Gjatë vitit 2021, vazhdoi puna për përmirësimin e bazës së të dhënave për monitorimin e zbatimit të ndihmës shtetërore, ndërkohë që u miratuan vetëm dy vendime të KNSh-së për shkak të ndërgjegjësimi të ulët të ofruesve të ndihmës shtetërore për legjislacionin për ndihmën shtetërore. Aktivitetet ndërgjegjëse për rolin dhe detyrat e KNSh-së nuk u zhvilluan siç ishte planifikuar, ndaj do të rishikohet njoftimi për skemën e ndihmës shtetërore.

Ecuria e komponentëve gjatë vitit 2021

Komponenti 4.1 Zgjerimi i përdorimit të SIFQ-së

Objektivat e produkteve të lidhura me integrimin e SIFQ-së me sisteme të tjera qeveritare nuk janë arritur, edhe pse progress është bërë. Në nëntor 2021, integrimi SIMBNJ -SIFQ u realizua me sukses. Në vitin 2021 për herë të parë 45 IB mundën të ekzekutonin listën e pagave përmes SIFQ. Në vitin 2021 Web Portal për arkivën elektronike ishte i aksesueshëm për 145 IB nga 1100 IB, 110 prej tyre ishin që nga viti 2020 dhe vetëm 35 ishin të reja. Gjatë vitit 2021 nuk është bërë shumë progres pasi AKSHI ishte ende në proces për përmirësimin e harduerit SMIFSH.

Komponenti 4.2: Kontrollat e angazhimeve shumëvjeçare dhe detyrimeve

Të gjitha objektivat e planifikuara për aplikimin e kontrolleve të angazhimeve shumëvjeçare dhe regjistrimin e llogarive të pagueshme, përfshirë detyrimet e prapambetura, u arritën gjatë vitit 2021.

Raporti mbi të dhënat e angazhimeve shumëvjeçare publikohet në faqen e internetit të MFE-së⁸. Të dhënat vjetore të angazhimeve rakordohen ndërmjet degëve të thesarit dhe njësive shpenzuese të qeverisjes qendrore dhe vendore sipas udhëzimit të ministrit nr. 25 datë 9 dhjetor 2021 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2021”, përveç një pjese të IB-ve online me SIFQ. BI-të online me SIFQ trashëgojnë vetë (jo nga degët e thesarit) të dhënat e angazhimeve shumëvjeçare të vitit të kaluar në tre vitet e ardhshme kundrejt planit buxhetor (PBA) të regjistruar në SIFQ.

DH/AB ka institucionalizuar çdo vit auditimin e detyrimeve të prapambetura, në të gjitha subjektet publike ku është ngritur AB. Për vitin 2021, 62 Njësi të Auditimit të Brendshëm kanë kryer auditimin e detyrimeve të prapambetura dhe gjetjet dhe rekomandimet e tyre i janë raportuar titullarit të institucionit dhe DH/AB-së (si pjesë e Raportit Vjetor të Veprimtarisë). Drafti i udhëzimeve “Auditimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë publike” është shpërndarë dhe është diskutuar gjatë trajnimeve të dedikuara me të gjithë auditorët e brendshëm gjatë vitit 2021, dhe drafti përfundimtar i udhëzuesit pritet të miratohet nga MEF brenda muajit qershor 2022. Kontrollat dhe procedurat aktuale kanë rezultuar të jenë ndonjëherë joefektive në zbutjen e riskut të krijimit të detyrimeve të reja të prapambetura. Situata e pazakontë për shkak të pandemisë ka qenë ende e pranishme gjatë vitit 2021, veçanërisht në njësitë e qeverisjes vendore, ku stoku i detyrimeve të prapambetura është rritur.

⁸ <http://www.financa.gov.al/ecuria-e-investimit-te-projekteve-2/>

Gjetjet e AB në lidhje me detyrimet e prapambetura janë paraqitur në raportin vjetor të KBFP 2021 dhe në Bordin e KBFP në maj 2022.

Komponenti 4.3: Menaxhimi i borxhit dhe likuiditetit

DP e Thesarit ka punuar për të përmirësuar parashikimin e likuiditetit, dhe u arritën 2 objektivat e produkteve. Parashikimet e fluksit të parave të qeverisë (fluksi i parave) përgatiten çdo ditë për të gjithë vitin fiskal dhe azhurnohen të paktën çdo muaj. Të dhënat ditore brenda muajit përditësohen nga raporti i realizimit të Bankës së Shqipërisë duke respektuar objektivat mujore të miratuara nga Ministri (objektivat buxheti-Makro-Borxh). Devijimet midis parashikimeve dhe të dhënave aktuale maten, analizohen dhe monitorohen në baza mujore dhe vjetore në mënyrë që të përmirësohen të dhënat e parashikimit në periudhat e ardhshme.

Gjatë vitit 2021 IB-të u ndihmuan nga stafi përgjegjës për parashikimin e likuiditetit për përgatitjen e të dhënave dhe paraqitjen e tyre sipas formateve të përcaktuara.

Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit (DPB) nuk ka arritur rezultatin e synuar për të miratuar dhe publikuar Strategjinë e Menaxhimit të Borxhit 2022-2024 përpara fillimit të vitit. Dokumenti strategjik i miratuar dhe i publikuar (MTDMS 2021-2023) ofron një sërë vlera të synuara dhe objektiva të mirëpërcaktuara dhe jep një udhëzim të mirë për arritjen e objektivave në periudhën e mbuluar. Megjithatë, duke pasur parasysh zhvillimet e fundit që kanë ndikuar edhe në menaxhimin e borxhit, është parë i nevojshëm hartimi i një dokumenti më të përpunuar dhe DPB po punon për përgatitjen e një Strategjie të re për Menaxhimin e Borxhit, e cila pritet të përfundojë brenda qershorit 2022.

DPB po punon për zgjerimin e tregut primar dhe dytësor. Ndonëse gjatë vitit 2021 në tregun primar janë emetuar 2 instrumente bench-mark: i) instrument referenc 3 vjeçarë, në masën 21.50 miliardë lekë; dhe ii) instrument referencë 5 vjeçarë në masën 26.40 miliardë, transaksionet e aktivitetit të tregut dytësor janë ende shumë të ulëta në numër dhe madhësi.

Komponenti 4.4: Prokurimi publik

Agjencia e Prokurimit Publik (APP) ka arritur objektivin e produktit për rishikimin e LPP-së për t'u harmonizuar me direktivat e BE-së. Në veçanti, në zbatim të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, është miratuar legjislacioni dytësor si më poshtë:

1. VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”.
2. VKM nr.384, datë 30.06.2021 “Për mënyrën e komunikimit në prokurimin publik”.
3. VKM nr. 457, datë 30.07.2021 “Për fjalorin e përbashkët të prokurimeve”.
4. VKM nr. 768, datë 15.12.2021 “Për përcaktimin e shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike dhe miratimin e rregullave për prokurimin e tyre”.
5. 29 paketa të dokumente standarde të tenderit për procedurat e prokurimit
6. 8 Udhëzime.

Objektivat e produkteve të Komisionit të Prokurimit Publik (KPP) për të ofruar mbrojtje ligjore për tenderuesit dhe interesin publik në të gjitha fazat e prokurimit publik për vitin 2021 u arritën. KPP ka vijuar procesin e rritjes së kapaciteteve institucionale, në vijim të procedurave të rekrutimit për vendet vakante. Konkretisht gjatë vitit 2021 janë ndjekur procedurat për rekrutimin e këtyre pozicioneve: Drejtor i Monitorimit, Shërbimeve Mbështetëse dhe Financave, Drejtues i Departamentit të Monitorimit për Zbatimin e Vendimeve dhe Shërbimeve Ligjore, Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse dhe Burimeve Njerëzore, dy inspektorë, një redaktor letrar, një specialist IT. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik është plotësuar me tre anëtarë të rinj me mandat 5-vjeçar që nga qershori i vitit 2021.

Është krijuar dhe zbatuar me sukses sistemi elektronik i menaxhimit të ankesave elektronike në fushën e prokurimit publik. Nga data 27 tetor 2021 Komisioni i Prokurimit Publik funksionon përmes sistemit të ri dixhital të menaxhimit të ankesave. KPP do të vijojë më tej punën për plotësimin e Regjistrat Elektronik të Ankesave me elementët shtesë të nevojshëm, si lloji i procedurës dhe fondi limit për çdo procedurë prokurimi objekt ankimi.

Gjithashtu, KPP ka organizuar sesione të veçanta trajnimi në bashkëpunim me SIGMA-OECD, Euralius, ASPA, Shkollën e Magjistraturës dhe Universitetin e Tiranës, të fokusuara kryesisht në sfidat e reja të Komisionit të Prokurimit Publik dhe në kuadër të ndryshimeve ligjore që kanë ndodhur. Gjithashtu, ASPA organizoi trajnime për punonjësit e administratës së KPP-së për përditësimin, pasurimin dhe ndarjen e përvojave të tyre.

APP-ja ka arritur objektivin e produktit për vitin 2021 për të përmirësuar më tej sistemin e prokurimit elektronik (SPE). Në veçanti, janë bërë ndryshime në funksionalitetet e SPE për t'u përshtatur me kuadrin e ri ligjor dhe gjithashtu për të përmirësuar performancën e tij të përgjithshme. Disa nga këto ndryshime përfshijnë futjen e seksionit “Open Data”. Me ndryshimet në SPE, janë ndryshuar gjithashtu manualët dhe udhëzimet. APP ka miratuar manuale për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë për zhvillimin elektronik të procedurave të prokurimit publik, sistemin dinamik të blerjes së biletave të avionit, procedurat e blerjeve të vogla dhe përgatitjen e regjistrave të parashikimeve dhe realizimeve. Gjithashtu, APP ka miratuar edhe manualin për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dërgimin e ofertave në SPE. Së fundi, APP ka miratuar manualin për integrimin e SPE me SIFQ.

Komponenti 4.5: Menaxhimi i fondeve të jashtme

Popullimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit me të dhënat e ndihmës së jashtme nuk është finalizuar siç ishte planifikuar gjatë vitit 2021. Të dhënat e ndihmës së jashtme të vitit 2019 dhe 2020 u regjistruan pjesërisht në sistem. Megjithatë, MFE ka rritur ndërgjegjësimin e komunitetit të Partnerëve për Zhvillim mbi rëndësinë e angazhimit të tyre për të populluar SIMAJ. Proceset e brendshme të sistemit u thjeshtëzuan për ta bërë atë më miqësor dhe të përgjegjshëm për përdoruesit dhe u organizuan seancat e trajnimit përditësuese sipas kërkesës. Gjithashtu, mirëmbajtja e rregullt e sistemit është siguruar si pjesë e kontratës së mirëmbajtjes pas garancisë për të siguruar funksionimin normal të sistemit dhe adresimin e çështjeve teknike.

Komponenti 4.6: Forcimi i rolit të ndihmës shtetërore

Objekti që synonte përmirësimin dhe zbatimin e kuadrit rregullator të ndihmës shtetërore u arrit. Bazuar në Urdhrin e Kryeministrit⁹, u zhvilluan dy mbledhje të grupit ndërmnistror të punës për ndihmën shtetërore me qëllim a) koordinimin e punës me ofruesit e ndihmës shtetërore për konsultimet paraprake për projektaktet ligjore që përmbajnë elemente të ndihmës shtetërore, dhe b) përditësimin e grupit ndërmnistror të punës për procesin e menaxhimit të ndihmës shtetërore. Synimi është rishikimi dhe hartimi i akteve ligjore dhe nënligjore, projekteve dhe strategjive të zhvillimit, si dhe identifikimi i elementeve të ndihmës shtetërore, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator për ndihmën shtetërore.

Jo të gjitha objektivat që synonin të kishin një bazë të dhënash efektive për monitorimin e zbatimit të skemave të ndihmës shtetërore u arritën. MFE-ja ka punuar për përmirësimin e bazës së të dhënave të skemave të ndihmës shtetërore. Për vitin 2020¹⁰ u përgatit një raport për ndihmën shtetërore bazuar në informacionin e dhënë nga ofruesit e skemave të ndihmës shtetërore. Qëllimi i raportimit të rregullt vjetor për ndihmën shtetërore është të sigurojë transparencë në fushën e ndihmës shtetërore sipas metodologjisë së Komisionit Evropian. Ky raport ofron një pasqyrë të zhvillimeve kryesore në fushën e ndihmës shtetërore, si dhe mbi instrumentet kryesore të përdorura në periudhën 2015-2020. Gjatë vitit 2020, instrumenti më i përdorur ishte Garancia Shtetërore (48%), pasuar nga Subvencionet dhe grantet (44%) dhe Përrjashtimi tatimor, shtyrja e taksave, ulja dhe zbritja e normës tatimore, kontributi i sigurimeve shoqërore (8%). KNSh ka miratuar

⁹ Urdhri i Kryeministrit nr. 128, datë 1.10.2019 “Për ngritjen e Grupit të Punës për Ndihmën Shtetërore”.

¹⁰ VKM Nr. 348, datë 16.06.2021 “Për miratimin e raportit vjetor të ndihmës shtetërore për vitin 2020”.

vetëm dy vendime¹¹, më pak se sa ishte planifikuar për shkak të ndërgjegjësimit të ulët të ofruesve të ndihmës shtetërore për legjislacionin për ndihmën shtetërore.

Objektivi i vendosur për vitin 2021 për të rritur ndërgjegjësimin për rolin dhe detyrat e Komisionit të Ndhmës Shtetërore nuk u arrit siç ishte planifikuar. Publiku u informua vetëm për një skemë të re ndihme, konkretisht “Autorizimi i ndihmës shtetërore për fuqizimin e grave dhe nxitjen e sipërmarrjes, ndërsa synimi ishte që të kishte të paktën tre skema të reja të njoftuara sa vitin e kaluar. Skema e re e ndihmës është publikuar në Fletoren Zyrtare¹².

Sfidat kryesore dhe hapat e ardhshëm

Në këtë objektiv specifik, komponenti më sfidues lidhet me zgjerimin e përdorimit të SIFQ në Institucione të tjera Buxhetore, për shkak të mungesës së financave adekuate për marrjen e licencës së përdoruesve të rinj të SIFQ dhe shërbimeve të padisponueshme të ekspertizës/mbështetjes së specializuar funksionale të SIFQ. Marrja e një ndihme funksionale të jashtme shikohet e një rëndësie të madhe për adresimin e këtyre vështirësive. Për vitin 2022 është miratuar buxheti për licencat e reja të përdoruesve të SIFQ për 5 IB të reja. Megjithatë, ky numër varet nga çmimi i licencës së përdoruesit dhe nga kursi i këmbimit të euros gjatë procesit të prokurimit. Gjithashtu, procesi i trajnimit të stafit do të nisë menjëherë pasi të konfirmohet marrja e licencave të reja të përdoruesve të SIFQ. Një sfidë tjetër në këtë komponent ishte në aksesin i të gjitha IB-ve në Web Portal, i cili nuk u kompletua për shkak të mungesës së mbështetjes për Web Portalin dhe SIFQ, stabilitetit të mbështetjes funksionale të SIFQ dhe zhvillimit të stafit. Për të kapërcyer këtë sfidë, puna e menjëhershme do të jetë në vazhdimin e lançimit sapo të bëhen përmirësimet e harduerit të SIMFSH.

Përsa i përket monitorimit të pajtueshmërisë me kontrollin e angazhimeve shumëvjeçare objektivi u arrit, por një sfidë me të cilën u përballën ishin Burimet Njerëzore (ndërgjegjësimi për përgjegjësitë e stafit dhe bashkëpunimi, si dhe aftësitë profesionale).

Një sfidë për trajnimin e stafit përgjegjës për parashikimin e likuiditetit për përgatitjen e të dhënave dhe paraqitjen e tyre sipas formateve të përcaktuara, ishte mungesa e disponueshmërisë së IB-ve për t'u trajnuar si njësi pilot. DP e Thesarit do të vazhdojë përpjekjet për të komunikuar dhe ofruar asistencën e tyre për IB-të pilot dhe trajnimin e stafit të ri të njësive të menaxhimit të likuiditetit. DPB arriti rezultatin e synuar për të miratuar dhe publikuar Strategjinë e Menaxhimit të Borxhit 2022-2024 përpara fillimit të vitit, për shkak të ndryshimeve në sfondin makroekonomik dhe mungesës së burimeve njerëzore/kapaciteteve të qëndrueshme. Departamenti i Menaxhimit të Borxhit po punon për përgatitjen e Strategjisë së re Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (SAMB). Transaksionet e aktivitetit të tregut dytësor janë ende shumë të ulëta në numër dhe madhësi dhe sfida lidhet me mungesën e burimeve njerëzore në departamentin e huamarrjes. DPB do të përmirësojë raportimin në tregun sekondar. Komisioni i Prokurimit Publik ka arritur objektivat e produktit për vitin 2021, por gjatë zbatimit janë përballur me disa sfida, si p.sh.: kandidatët nuk i kanë plotësuar kriteret për rekrutim; përshtatja e operatorëve ekonomikë me përdorimin e sistemit të ri online të paraqitjes së ankesave, nëpërmjet portalit unik qeveritar E-Albania; dhe mbështetje financiare për organizimin e trajnimeve të specializuara.

Për sa i përket informacionit të SIMAJ për fondet e jashtme, të dhënat e 2019 dhe 2020 u regjistruan pjesërisht në SIMAJ për shkak të vëllimit të madh të të dhënave për t'u regjistruar dhe pjesa më e madhe e ngarkesës së punës kërkon që të kryhet manualisht nga pikat kontaktuese. Lidhur me forcimin e rolit të ndihmës shtetërore, jo të gjithë objektivat u arritën siç ishte planifikuar për shkak të ndërgjegjësimit të ulët të ofruesve të ndihmës dhe risqeve që kanë ndikuar në mos njoftimin e skemave. Për këtë arsye do të rishikohet njoftimi i skemës së

¹¹Vendimi i KNSH Nr. 103/2021 “Autorizimi i Ndhmës Shtetërore për Fuqizimin e Grave dhe Nxitjen e Sipërmarrjes” dhe Vendimi i KNSH Nr. 102/2021 “Për miratimin e Raportit Vjetor të Ndhmës Shtetërore për vitin 2020”.

¹² <https://qbz.gov.al/eli/fz/2021/141/e32295cc-e849-4cb0-908c-17044105b759>

ndihmës shtetërore për të rritur më tej ndërgjegjësimin mbi rolin dhe detyrat e Komisionit të Ndihmës Shtetërore.


3.5 Ecuria për Objektivin Specifik 5 “Transparenca e Financave Publike”

Për të përmirësuar mbulimin, cilësinë dhe mundësinë për të përdorur informacionin në financat publike, u kryen përpjekje **(i)** për të fuqizuar sistemet dhe kapacitetet për të përgatitur statistika financiare të qeverisë nëpërputhje me standardet ndërkombëtare; **(ii)** Publikimi i raporteve financiare vjetore dhe atyre gjatë vitit përmbajnë informacion për performancën financiare dhe jofinanciare, përfshirë TKP-të; **(iii)** për të ofruar mundësi formale për publikun për t'u angazhuar në procesin e buxhetit; dhe **(iv)** kalimin në një bazë të përkallëzuar për të paraqitur pasqyrat financiare të qeverisë mbi bazë të drejtash dhe detyrimesh të konstatuara. Nuk ka progresuar sikurse planifikuar treguesi i performancës në lidhje me përgatitjen e një regjistri të plotë të aktiveve. Gjatë vitit 2021, niveli i arritjes së objektivave të treguesve të performancës së rezultateve me synim forcimin e Transparencës së Financave Publike u vlerësua “mirë”, me 80% të progresit të bërë, mbetet në të njëjtën kategori si në vitin 2020 (mirë-75%).

Tabela 6: Treguesit e Performancës së Rezultateve për OS 5

Rezultati	Treguesi i performancës	Vlera faktike VF20	Vlera e synuar VF 2021	Vlera faktike VF2021
XV) Fuqëzim i sistemeve dhe kapaciteteve për të përgatitur statistikat financiare të qeverisë sipas standardeve ndërkombëtare	XVa) Përgatitja e llogarive kombëtare të qeverisë sipas metodologjisë ndërkombëtare (ISA 2010)	75%	75.0%	75.0%
XVI) Llogaridhënia dhe transparenca me anë të raportimit të performancës financiare dhe jo-financiare është rritur	XVIa) Publikimi i raporteve financiare vjetore dhe atyre gjatë vitit përmbajnë informacion për performancën financiare dhe jofinanciare, përfshirë TKP-të		25.0%	25.6%
XVII) Ofrohen mundësi formale për pjesëmarrjen e publikut në procesin e	XVIIa) Vlerësimi nga Indeksi për Buxhetin e Hapur (Pjesëmarrja e Publikut)	7 nga 100	≥ (t-1) (tendencë në rritje)	7 nga 100
XVIII) 'Prezantimi i pasqyrave financiare sipas kuadrit të përzgjedhur SNKSP'	XVIIIa) Kalimi në fazën ku pasqyrat financiare të qeverisë do të paraqesin kontabilitetin në bazë të drejtash dhe detyrimesh të konstatuara.	0%	≥ (t-1) (tendencë në rritje)	10.0%
XIX) Përgatitja e regjistrit të plotë të aktiveve të sektorit Publik bazuar në rregulloret e përmirësuara për vlerësimin dhe inventarin e këtyre aktiveve	XIXa) Aktivitet publike të regjistruara në SIFQ	3	5	0

Grafiku 8: Statusi i objektivave të produkteve të OS 5 për vitin 2021



Forcimi i sistemeve dhe kapaciteteve për të përgatitur statistika financiare të qeverisë në përputhje me standardet ndërkombëtare ka qenë në fokus kryesor që kur është publikuar strategjia. Numri i tabelave të kompletuara dhe të dërguara në Eurostat ishte 75 për qind në vitin 2021, përqindje e njëjtë me vitin 2020. Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet MFE-së, Institutit të Statistikave (INSTAT) dhe BSH-së u krijua në vitin 2016. Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit, në vitin 2016 u krijuan dy Grupe Pune Ndërinstitucionale dhe në vitin 2021 u mbajtën takime të rregullta. Gjatë vitit 2017, për herë të parë INSTAT përpiloi dhe transmetoi Statistikat e Financave të Qeverisë (SFQ) për llogaritë jofinanciare për sektorin e qeverisjes së përgjithshme në vijim të Sistemit Evropian të Llogarive (SELL 2010). INSTAT ka publikuar çdo vit Listën e Institucioneve Publike¹³, të cilat klasifikohen brenda sektorit të Qeverisjes së Përgjithshme S.13. Kjo listë përditësohet dhe miratohet çdo vit nga tre institucionet e përfshira: INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Banka e Shqipërisë. Lista përfshin të gjitha institucionet e sektorit publik që janë pjesë e sektorit të Qeverisë së Përgjithshme, njësitë buxhetore dhe jashtëbuxhetore, gjithashtu Korporatat Financiare Publike dhe Korporatat Publike Jofinanciare që janë në pronësi të subjekteve publike. Gjatë muajit nëntor 2019 u publikua “Politikat e Harmonizuara të Rishikimit për Statistikat Makroekonomike¹⁴” nga INSTAT, e cila bazohet në Politikën e Harmonizuar të Rishikimit Evropian (PHRE) dhe në manuale të tjera të publikuara nga EUROSTAT, ku përcaktohen politikat që duhen ndjekur nga institucionet statistikore të vendeve të ndryshme që të bëjnë statistika të krahasueshme me vendet e tjera. Gjatë vitit 2021, INSTAT ka përdorur sistemin TI të zhvilluar për përpilimin e statistikave SFQ dhe EDP. Duke përdorur Sistemin e ri të Përpilimit të Integruar të SFQ Shqiptare (AIGCS), 5 tabela SFQ iu transmetuan EUROSTAT-it. Duke përdorur të njëjtin sistem, tabelat EDP përpilohen dhe i transmetohen Eurostat dy herë në vit (fundi prill/fundi i tetorit). Në këtë aspekt, tabelat për sektorin e Qeverisjes së Përgjithshme, bazuar në Programin e Transmetimit të SELL, janë të automatizuara dhe është krijuar sistemi statistikor. Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet MFE-së, INSTAT-it dhe Bankës së Shqipërisë nuk u pa i nevojshëm për rishikim në vitin 2021. INSTAT do të vazhdojë të përmirësojë sistemin duke përfshirë burimet dhe metodat e reja të të dhënave për të prodhuar statistika SFQ dhe EDP në përputhje me metodologjinë SELL 2010.

Llogaridhënia dhe transparenca përmes raportimit të performancës financiare dhe jofinanciare është rritur gjatë vitit 2021 me 25,6 % në përputhje me objektivin e synuar, 10 nga 39 raportet monitoruese të paraqitura nga ML/IB kishin raportuar në përputhje me të dhënat e gjeneruara nga sistemi SIMFSH. Për vitin 2020 nuk kishte asnjë objektiv në lidhje me këtë tregues të performancës. Sipas Anketës së Buxhetit të Hapur të vitit 2017, që nga viti 2015 Shqipëria ka rritur (a) disponueshmërinë e informacionit buxhetor të dhënë në Raportin e Auditimit dhe Pasqyrën e Para-Buxhetit, dhe (b) numrin e raporteve të publikuara të ekzekutimit të buxhetit. Gjithashtu, procedurat për zbatimin e buxhetit të “gjatëvitit” janë përmirësuar dhe për herë të parë në faqen e internetit të MFE-së¹⁵ në vitin 2017 u publikuan: Raporti i Mesit të Vitit i Performancës Makroekonomike, Fiskale dhe Buxhetore të qeverisë. Shqipëria u përmirësua pak më tej në Anketën e Buxhetit të Hapur të 2019 pasi ka publikuar edhe Rishikimin e Mes-vitit në internet. Modelet dhe përmbajtja e raporteve të ekzekutimit të buxhetit vjetor dhe atij brenda vitit të qeverisë u rishikuan gjatë vitit 2019. Seancat në punë me menaxherët e programit dhe departamentet e financave të dy ML-ve me qëllim përmirësimin e modeleve të ekzekutimit të buxhetit vjetor dhe brenda vitit u zhvilluan në vitin 2020. Për më tepër, SIMFSH është shpërndarë në të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet buxhetore dhe të dhënat përkatëse janë ngarkuar në sistem. Gjatë vitit 2021 është hartuar dhe zbatuar një model i ri për Raportin Vjetor të Ekzekutimit të Buxhetit, duke përfshirë TKP që janë të harmonizuara me SIMFSH dhe informacionet financiare. Formatet e reja të Udhëzuesit për anekset e monitorimit të buxhetit, që përfshijnë TKP-të, nuk janë hartuar sikurse planifikuar gjatë vitit 2021 për shkak të modulit MPPB me problemet në sistemin SIMFSH.

Vlerësimi i fundit nga **Indeksi i Buxhetit të Hapur (OBI) në ofrimin e mundësive formale për përfshirjen e publikut në procesin buxhetor** është bërë në vitin 2019 dhe pjesëmarrja e publikut për Shqipërinë vlerësohet

¹³ <http://www.instat.gov.al/en/themes/economy-and-finance/national-accounts-gdp/publication/2021/list-of-public-institutions-2020/>

¹⁴ <http://www.instat.gov.al/media/6557/harmonized-revision-policies-for-macroeconomic-statistics.pdf>

¹⁵ <http://www.financa.gov.al/raporti-i-mes-vitit-mbi-zbatimin-e-buxhetit-2017/>

7/100 pikë. Të njëjtat vlerësime mbeten për vitin 2020 dhe 2021. OBI është matësi i vetëm i pavarur dhe krahasues në botë i transparencës së buxhetit të qeverisë qendrore. OBI u cakton vendeve të mbuluara nga Anketa e Buxhetit të Hapur një rezultat transparence në një shkallë 100 pikësh duke përdorur 109 nga 140 pyetjet në Anketë. Këto pyetje fokusohen në mënyrë specifike nëse qeveria i ofron publikut qasje në kohë në informacionin gjithëpërfshirës të përmbajtur në tetë dokumente kyçe buxhetore në përputhje me standardet e praktikave të mira ndërkombëtare. MFE-ja është asistuar nga nisma BOOST, një mjet i Bankës Botërore që i jep akses në të dhënat e buxhetit dhe nxit përdorimin efektiv për procese të përmirësuara vendim-marrëse, transparencë dhe besueshmëri. Duke filluar që prej vitit 2015, Ligji Buxhetor Vjetor¹⁶ u formulua në një mënyrë më transparente dhe të kuptueshme dhe u publikua “Buxheti me një Vështrim” dhe një version i thjeshtësuar i “Buxheti I Qytetarëve”. Gjatë vitit 2020 u përgatit dhe u zbatua një kalendar me proceset kyçe të buxhetit. Gjithashtu, gjatë vitit 2019, 2020 dhe 2021 u përpunua dhe u publikua një udhëzues për Buxhetin e Qytetarëve. U kryen gjithashtu trajnime (2019-2021) për OShC-të për të nxitur kapacitetet e tyre për të kuptuar ciklin e buxhetit.

Në lidhje me kontabilitetin, u krye një analizë hendeke, e cila krahasonte kuadrin aktual rregullator të kontabilitetit me SNKSP-të, gjetjet e kësaj analize u prezantuan në seminarin e zhvilluar në maj të vitit 2017. Bazuar në analizën e hendeke, qeveria miratoi një Plan Veprimi Strategjik për vendin për kalimin në SNKSP në muajin tetor 2019. Gjithashtu, u krijua një funksion specifik brenda DPHKBFP-së i dedikuar kontabilitetit, përgjegjës për përditësimin e metodologjisë së kontabilitetit në sektorin publik si edhe të akteve ligjore dhe nënligjore në sektorin privat.

Gjatë vitit 2021 është bërë progress në lidhje me **kalimin në fazën në paraqitjen e pasqyrave financiare të qeverisë me bazë të drejtash dhe detyrimesh të konstatuara, të vlerësuara me një rritje prej 10 % krahasuar me 0 % në vitin 2020**. Objektivi strategjik final është përgatitja e pasqyrave financiare në institucionet e sektorit publik bazuar në SNKSP të përzgjedhura. Objektivat që synojnë të përmirësojnë kuadrin rregullator të kontabilitetit dhe të përmirësojnë SIFQ për të regjistruar të dhënat e kontabilitetit në bazë të drejtash dhe detyrimesh të kontatuara nuk u arritën në vitin 2021. Edhe pse, janë kryer disa aktivitete si analiza e hendeke të standardeve kombëtare të kontabilitetit në krahasim me SNKSP dhe një raport që vlerëson ndikimin sasior për zbatimin e secilit SNKSP individualisht është ofruar nga konsulenti. Gjithashtu, janë draftuar disa udhëzime kontabël lidhur me elementë të ndryshëm të pasqyrave financiare, që do të përdoren në përgatitjen e pasqyrave financiare bazuar në SNKSP. Gjatë vitit 2021 janë trajnuar vetëm 25 kontabilistë të sektorit publik nga 50 të planifikuar

Lidhur me “Aktivet publike të regjistruara në SIFQ” nuk është bërë progres gjatë vitit 2021 pasi Institucionet Buxhetore online në SIFQ nuk kanë përgatitur inventarin e aktiveve për t'u migruar në SIFQ. Zhvillimi i metodologjisë për njohjen e aktiveve nuk u finalizua siç ishte planifikuar për 2020-2021. Tre IB, përkatësisht Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Autoriteti Rugor Shqiptar kanë futur inventarin e aktiveve në modulën e aktiveve gjatë vitit 2020 dhe janë trajnuar 6 staf të këtyre IB-ve, ndërsa për vitin 2021 nuk është bërë asnjë progres.

Ecuria e komponentëve gjatë vitit 2021

Komponenti 5.1: Llogaritë Kombëtare të Qeverisë

Progres është bërë gjatë vitit 2021 nga INSTAT në krijimin e një e një sistemi të qëndrueshëm statistikor për njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Dy objektivat e prapë të planifikuar për vitin 2021 u përmbushën, ndërsa objektivi që lidhet me Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet MFE-së, INSTAT-it dhe Bankës së Shqipërisë nuk u pa i nevojshëm për rishikim. Megjithatë, sa i përket dy Grupeve Ndërinstitucionale të Punës të krijuara në vitin 2016, takimet të rregullta janë mbajtur në vitin 2021.

¹⁶ <http://www.financa.gov.al/buxheti-2016/>

Për të pasur një sistem statistikor të qëndrueshëm për Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme **u krijua sistemi i përpilimit të buxhetit të qeverisë dhe sistemet ndihmëse** (njësi jashtëbuxhetore, borxhe dhe interes, lidhje me metodologjinë e llogarive kombëtare). Duke përdorur sistemin e ri të TI-së për përpilimin e Statistikave Financiare të Qeverisë, 5 tabela SFQ u shpërndanë në EUROSTAT. Të tre institucionet po përdorin këtë sistem për gjenerimin e Statistikave Financiare të Qeverisë vetëm për përdorim të brendshëm, jo për publikim. Disa module të sistemit u testuan gjatë vitit 2020, por sistemi u përfundua në vitin 2021. INSTAT është aktori kryesor në këtë proces dhe në këtë drejtim Grupi i Punës Ndërinstitucional është mbledhur rregullisht. Sistemi i TI-së për përpilimin e Statistikave Financiare të Qeverisë u krijua me mbështetjen e AT-së nga SECO dhe i asistuar nga ekspertë të FMN-së. Sistemi do të përdoret nga tre institucionet për përgatitjen e të dhënave (SFQ) sipas kërkesave të Programit të Transmisionit (SELL) 2010. INSTAT duke përdorur sistemin e ri të zhvilluar ka dërguar në Eurostat të gjitha tabelat për llogaritë jofinanciare për sektorin e qeverisjes së përgjithshme duke filluar nga të dhënat e vitit 2017 e në vazhdim. Të dhënat dërgohen në bazë eksperimentale dhe nuk janë për publikim. Me sistemin e ri të TI-së të dhënat janë rishikuar dhe mbulimi i tabelave është përmirësuar.

Produkti **“Tabelat EDP janë rishikuar dhe sistemi statistikor gjithëpërfshirës është krijuar”** mund të konsiderohet i përmirësuar pasi të gjithë objektivat e tij janë përfunduar dhe nuk ka objektiva të planifikuara për vitin 2022. Në këtë aspekt tabelat për Programin e Transmisionit EDP janë të automatizuara dhe sistemi statistikor është krijuar, edhe pse ishte parashikuar të përfundojë në TM2 2021 përfundoi në TM4 2021, sepse projekti që ka ndihmuar në realizimin e objektivit për këtë tregues performance nuk mundi të kryente aktivitetet e tij sipas planit fillestar për shkak të situatës COVID-19.

Komponent 5.2: Raportimi dhe Monitorimi Financiar dhe ai i Performancës

Raporti vjetor i ekzekutimit të buxhetit të qeverisë është përmirësuar gjatë vitit 2021. Në këtë aspekt është hartuar dhe zbatuar një model i ri për Raportin Vjetor të Ekzekutimit të Buxhetit, duke përfshirë TKP që janë të harmonizuara me SIMFSH dhe informacionet financiare. Raporti i ekzekutimit të buxhetit vjetor paraqet realizimin e fondeve buxhetore dhe realizimin e objektivave në nivel produkti dhe tregues të performancës.

Raportet e ekzekutimit të buxhetit të gjatë-vitit, duke përfshirë edhe rishikimin e mes-vitit, nuk kanë përparuar sikurse planifikuar gjatë vitit 2021. Në këtë aspekt, formatet e reja të Udhëzuesit për anekset e monitorimit të buxhetit, që përfshijnë TKP-të, nuk janë hartuar sikurse planifikuar. Zëvendësimi i anekseve të Udhëzuesit nuk është finalizuar, kjo derisa të përfundojë moduli MPPB në sistemin SIMFSH dhe raportet e planifikuara të bëhen pjesë e anekseve dhe do të përditësohen plotësisht me të gjithë treguesit financiarë. Gjatë vitit 2021, DMB ka ndjekur disa seanca testimi në vend, përkatësisht në disa ML, për të monitoruar performancën e Modullit MPPB. Si rezultat, janë ngritur disa çështje, kështu që njësitë përgjegjëse dhe kompania projektuese janë informuar për mospërputhje të raporteve të gjeneruara nga Moduli MPPB i sistemit SIMFSH. Hapi i radhës që konsiderohet se do të ndërmerret nga njësia përgjegjëse do të jetë vijimi i zgjidhjeve të problemeve të hasura gjatë gjenerimit të raporteve në sistemin SIMFSH me qëllim finalizimin e dizajnit të ri të anekseve udhëzuese.

Komponenti 5.3: Angazhimi i qytetarëve

Udhëzuesi për Buxhetin për Qytetarët¹⁷ u publikua sikurse planifikuar. Qëllimi kryesor i udhëzuesit është të rrisë angazhimin e qytetarëve, OShC-ve dhe grupeve të tjera të interesit në procesin e buxhetit të qeverisë.

Objektivat e produktit **“Një kalendar për dëgjuesat mbi buxhetin me proceset kyçe buxhetore është përgatitur dhe zbatuar” kanë patur progres gjatë vitit 2021.** Në këtë aspekt në seancat dëgjimore buxhetore të organizuara gjatë korrikut 2021 ishin të pranishëm 17 OShC nga 26 të ftuar. Procesverbalet e sugjerimeve të OShC-ve janë mbajtur dhe janë publikuar si pjesë e Programit Buxhetor Afatmesëm të fazës teknike. Gjithashtu, në vitin 2021 u zhvilluan një sërë seminaresh online për ngritjen e kapaciteteve me

¹⁷ <https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/Buxheti-per-Qytetaret-2022.pdf>

organizatat e shoqërisë civile. Trajnimet kishin për synim rritjen e kapaciteteve të OShC-ve për të kuptuar buxhetin e shtetit dhe forcimin e kapaciteteve të tyre për të luajtur një rol mbikëqyrës për financat publike. Seria e seminareve filloi me dy seminare të mbajtura përkatësisht në nëntor dhe dhjetor 2021. Seminari i parë u përqendrua në ciklin buxhetor dhe pikat hyrëse për advokimin e OShC-ve; ndërsa i dyti mbi fazat e ndryshme të kalendarit buxhetor dhe ofrimin e aftësive për vlerësimin e buxhetit sektorial për OShC-të. Seminarët u mbajtën në distancë, për shkak të kufizimeve të lidhura me Covid-19 dhe niveli i pjesëmarrjes ishte i kënaqshëm (webinar-i i parë: 14 persona nga OShC(10) të ndryshmedhe MFE(4); webinar-i i dytë: 13 persona). Webinar-ët online mundësuan përfshirjen e një gamë më të gjerë OShC-sh.

Komponenti 5.4: Kontabiliteti

Vlera e synuar që ka për qëllim të përmirësojë kuadrin rregullator të kontabilitetit dhe të zgjerojë SIFQ për të regjistruar të dhënat kontabël të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara nuk u përmbush në vitin 2021, edhe pse ka patur progres. Në lidhje me kuadrin rregullator të kontabilitetit gjatë vitit 2021, konsulenti i përzgjedhur nga MFE-ja në bashkëpunim me stafin e MFE-së, ka ndihmuar në hartimin e akteve ligjore dhe standardeve të kontabilitetit, bazuar në analizën e hendeut të kryer nga ky konsulenti. Gjatë vitit 2021, kompania konsulente në bashkëpunim me MFE-në **ka kryer analizën e hendeut të standardeve kombëtare të kontabilitetit në krahasim me SNKSP dhe një raport që vlerëson ndikimin sasior për zbatimin e secilit SNKSP individualisht.** Gjithashtu, janë dhënë disa draft udhëzime për kontabilitetin në lidhje me elementë të ndryshëm të pasqyrave financiare që do të përdoren në përgatitjen e pasqyrave financiare bazuar në SNKSP. Konkretisht është hartuar draft udhëzimi për trajtimin kontabël të inventarëve dhe pasurive jomateriale në sektorin publik. Gjatë vitit 2021, konsulenti ka ndërmarrë disa aktivitete për të mbledhur të dhëna në lidhje me raportin mbi rregullimin institucional dhe proceset e biznesit për kontabilitetin, raportimin dhe fushat e ndërlidhura, si dhe mbi raportin e vlerësimit të funksionimit të SIFQ, i cili do të japë rekomandime për rregullime, duke përfshirë prezantimin ose aktivizimin e llogari dhe module të reja.

Plani i zhvillimit të kapaciteteve nuk mund të zbatohet siç ishte synuar për vitin 2021, por progres është bërë. Në këtë aspekt janë trajnuar 25 kontabilistë të sektorit publik nga 50 të planifikuar. Gjithashtu janë trajnuar 28 staf, 18 më shumë nga sa ishte planifikuar. Në lidhje me planin e zhvillimit të kapaciteteve, raporti i vlerësimit të nevojave për trajnim është dorëzuar nga konsulenti në shkurt 2021, duke vlerësuar aftësitë dhe njohuritë e grupit të ekspertëve, vendimmarrësve dhe mbajtësve të buxhetit, stafit të kontabilitetit dhe financave, stafit të regjistrimit të të dhënave të transaksioneve, auditues të brendshëm dhe të jashtëm. Korniza e kompetencave, e cila përmban kompetencat thelbësore dhe nivelet e aftësive, objektivat e të mësuarit drejt aftësive dhe kompetencat bazuar në gamën e karakteristikave të përzgjedhura, u përgatit gjithashtu në shkurt 2021, 28 ekspertë u zgjedhën nga zyrtarët e financave të sektorit publik (kryesisht MFE dhe Thesari, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), akademik dhe Zyrtarët Kontabilistë Publikë (ZKP)) dhe ishin pjesë e planit të trajnerëve, i cili u përmbyll me një provim në 10 dhjetor. Gjithashtu, gjatë vitit 2021, u krye për herë të parë pilotimi i trajnimit të 25 zyrtarëve financiarë dhe kontabilistëve nga grupi prej 100 kontabilistësh, nga rreth 17 institucione të ndryshme të sektorit publik.

Komponenti 5.5: Menaxhimi i aktiveve

Metodologjia për një inventar të plotë të aktiveve publike në institucionet e Qeverisë Qendrore (QQ) nuk u përfundua. Bazuar në ndryshimet e bëra nga konsulentët nëpërmjet aktiviteteve të projektit SNKSP, MFE-ja ka hartuar draft metodologjinë për inventarizimin, vlerësimin dhe zhvlerësimin e aseteve në sektorin publik. Kjo metodologji do të miratohet brenda vitit 2022. Moskoordinimi brenda strukturave të përfshira në hartimin e metodologjisë, çon në mosdhënien në kohë të opinioneve/sugjerimeve/komenteve, çka rezulton në vonimin e finalizimit të aktit ligjor brenda afatit të caktuar. Gjithashtu, kjo metodologji bazohet në udhëzimet e parashikuara nga projekti, ndaj do të finalizohet gjatë vitit 2022.

Vlerat e synuara të produktit për vitin 2021 me qëllimin e regjistrimit të plotë të aktiveve publike në SIFQ (për IB-të në sistem) nuk u përmbushën sikurse planifikuar sepse Institucionet Buxhetore online në SIFQ nuk kanë përgatitur në kohë informacionin e inventarit të aktiveve për t'u migruar në SIFQ. Si rezultat, nuk ka patur arsye për të trajnuar stafin e IB-ve për modul AF për t'u përdorur nga ata: Bashkia Tiranë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Transportit dhe Energjetikës, Kryeministria.

Sfidat kryesore dhe hapat e ardhshëm

Në lidhje me këtë objektiv specifik, komponenti kryesor sfidues lidhet me Menaxhimin e Aktiveve, më konkretisht në lidhje me Metodologjinë e pa finalizuar dhe udhëzimet për një inventar të plotë të aktiveve publike në institucionet e Qeverisë Qendrore (QQ), dhe me mospasjen progres në regjistrimin e inventarit të aktiveve në SIFQ. Këto kanë ardhur kryesisht për shkak të: moskoordinimit brenda strukturave të përfshira në hartimin e metodologjisë, çon në mosdhënien në kohë të opinioneve/sugjerimeve/komenteve, gjë që rezultoi në vonimin e finalizimit të aktit ligjor brenda afatit të caktuar; Gjithashtu, kjo metodologji bazohet në udhëzimet e parashikuara nga projekti, ndaj do të finalizohet gjatë vitit 2022; dhe Institucionet Buxhetore online nuk kanë përgatitur në kohë informacionin e inventarit të aktiveve për t'u migruar në SIFQ.

Për sa i përket komponentit të Kontabilitetit, pavarësisht punës së bërë nga Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit (DHMFKK) dhe ndërmarrjes së masave të nevojshme për menaxhimin e situatave të pafavorshme, disa nga sfidat/risqet që ndikuan në realizimin e produkteve në këtë komponent ishin: 1. Kufizimi i aktiviteteve në terren për shkak të faktorëve madhorë si pandemia Covid-19, ndaj ekspertët patën vështirësi në realizimin e aktiviteteve të vizitave në terren për të mbledhur të dhëna të rëndësishme për këto udhëzime; 2. Në disa raste, për shkak të ngarkesës së punës, ka munguar angazhimi i drejtuesve dhe stafit në institucione lidhur me disponueshmërinë e takimit të kërkuar, mbledhjen e të dhënave, të cilat janë të rëndësishme për këto aktivitete. Për të kapërcyer këto sfida në periudhën e ardhshme (2022), konsulenti do të sigurojë të gjitha draft-udhëzimet në lidhje me elementë të ndryshëm të pasqyrave financiare. Parashikohet që deri në prill 2022 të përgatitet udhëzimi për kontabilitetin në bazë të drejtash dhe detyrimesh të kontatua, provizione, përfitime të punonjësve, instrumente financiare dhe konsolidimin e pasqyrave financiare. Të gjitha udhëzimet që do të jepen nga konsulenti do të përdoren në përgatitjen e pasqyrave financiare bazuar në SNKSP. Pra, për vitin 2022 parashikohet të ketë analiza të pasqyrave financiare të institucioneve të ndryshme të sektorit publik për përzgjedhjen e këtyre institucioneve pilot dhe pilotimin e këtyre udhëzimeve në 7 institucione pilot. Gjithashtu, gjatë vitit 2022, në bazë të draft udhëzimeve të përgatitura nga konsulenti, do të finalizohet raporti në lidhje me funksionalitetin e SIFQ për përcaktimin e përshtatjeve apo nevojës për aktivizimin e llogarive apo moduleve të reja në sistem.

Një sfidë tjetër lidhet me monitorimin dhe raportimin e performancës financiare, sepse rivendosja e anekseve të Udhëzuesit nuk u finalizua pasi moduli MPPB në sistemin SIMFSH nuk ishte kompletuar dhe raportet e planifikuara për t'u bërë pjesë e anekseve ishin jo plotësisht të përditësuar me të gjithë treguesit financiarë. Gjatë vitit 2021, DMB ka ndjekur disa seanca testimi në vend, përkatësisht në disa ML, për të monitoruar performancën e Modulit MPPB. Si rezultat, janë ngritur disa çështje, kështu që njësitë përgjegjëse dhe kompania projektuese janë informuar për mospërputhje të raporteve të gjeneruara nga Moduli MPPB i sistemit SIMFSH. Për tejkalimin e kësaj problematike nevojitet vazhdimi i zgjidhjeve të problemeve të hasura gjatë gjenerimit të raporteve në sistemin SIMFSH për të finalizuar dizajnin e ri të anekseve udhëzuese.


3.6 Ecuria për Objektivin Specifik 6 “Kontroll i Brendshëm Efektiv”

Gjatë vitit 2021, niveli i arritjes së objektivave të treguesve të performancës së rezultateve me synim forcimin e sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në nivel qendror dhe vendor mbetet në të njëjtën kategori si në vitin 2020 (shumë mirë), me 104 % të progresit të bërë, duke treguar një përmirësim në krahasim me vitin 2020 (100% - shumë mirë).

Tabela 7: Treguesit e Performancës së Rezultateve për OS 6

Rezultati	Treguesi i Performancës	Vlera faktike VF 2020	Vlera e synuar VF 2021	Vlera faktike VF 2021
XX) Llogaridhënie efektive menaxhierale në të gjithë institucionet publike	XXa) Niveli i zbatimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në praktikë brenda institucioneve buxhetore	2.56	>(t-1) (Tendencë në rritje)	2.61
	XXb) Mekanizmat për llogaridhënien menaxhierale në kuadrin rregullator	2.90	>(t-1) (Tendencë në rritje)	2.95
XXI) Forcimi i funksionit të auditimit të brendshëm në sektorin publik	XXIa) % e rekomandimeve të zbatuara të auditimit të brendshëm	65%	>(t-1) (Tendencë në rritje)	62%
	XXIb) Kuadri për auditimin e brendshëm është harmonizuar me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm	Është kryer analiza e hendeqeve	Kuadri ligjor është përditësuar	a) Është përgatitur versioni i parë i draft ligjit të rishikuar për AB b) Janë përditësuar 3 udhëzime për AB
	XXIc) % e rekomandimeve bazuar në sistem që janë adresuar kundrejt numrit total të gjetjeve që janë adresuar	42%	>(t-1) (Tendencë në rritje)	67%
XXII) Inspektim financiar publik efikas	XXIIa) % e rekomandimeve të zbatuara të inspektimit financiar (të nxjerra me urdhrë të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë)	85%	>(t-1) (Tendencë në rritje)	88%

Grafiku 9: Statusi i objektivave të produkteve të OS 6 për vitin 2021



Përsa i përket llogaridhënies efektive menaxheriale në të gjitha institucionet publike, të dy objektivat e rezultateve u arritën duke treguar një përmirësim të lehtë në krahasim me vitin 2020. Për të matur shkallën në të cilën sistemet e kontrollit të brendshëm zbatohen në praktikë dhe nëse mekanizmat e llogaridhënies menaxheriale janë të rregulluara, DPHKBFP ka përgatitur një metodologji vlerësimi për vlerësimin vjetor të institucioneve buxhetore. Nga vlerësimi i kryer për vitin 2021, rezultoi se institucionet buxhetore shënuan respektivisht 2.61 dhe 2.95 pikë nga 4 pikë, duke shënuar një përmirësim krahasuar me vitin 2020 (përkatësisht 2.56 dhe 2.9). Zhvillimet kryesore gjatë vitit 2021 u fokusuan në përmirësimin e funksionalitetit të sistemit duke ofruar asistencë teknike dhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e zbatimit të instrumenteve të MFK-së. Megjithatë, ka ende institucione që nuk kanë respektuar kërkesat ligjore për raportimin e situatës së sistemit të kontrollit të brendshëm në MFE. Në këtë kontekst, lind nevoja për marrjen e masave efektive për ndërgjegjësimin e menaxherëve për të vlerësuar problematikat e identifikuara përmes aktiviteteve raportuese dhe monitoruese. Përsa i përket mekanizmave të llogaridhënies menaxheriale në kuadrin rregullator, të gjitha institucionet kanë adoptuar struktura organizative të përshtatshme me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së tyre. Gjithashtu, institucionet kanë përcaktuar deklaratat e misionit dhe objektivat e tyre strategjike dhe operacionale, pjesë e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm, duke pasur një lidhje organike midis këtyre prioritetëve dhe objektivave të performancës. Problem mbetet mungesa e raportimit të rregullt periodik dhe marrja e masave konkrete për adresimin e çështjeve që lidhen me sistemin e kontrollit të brendshëm, si dhe përdorimi i procedurave të rregullta të delegimit të detyrave dhe përgjegjësi të vlerësuara në nivele jo të kënaqshme në të gjitha institucionet. Në këtë kontekst, duhet të rritet ndërgjegjësimi i drejtuesve dhe të merren masa për adresimin e çështjeve dhe përcaktimin e qartë të termave, rregullave dhe procedurave që duhen ndjekur në procesin e delegimit të detyrave brenda njësisë publike.

Gjatë viteve 2015-2021, janë bërë përmirësime dhe ndryshime në Ligjin “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, si dhe janë miratuar disa akte nënligjore në mbështetje të legjislacionit parësor. DHMFKK ka zhvilluar disa aktivitete për të rritur ndërgjegjësimin e zyrtarëve të lartë dhe menaxherëve mbi rëndësinë e zbatimit të suksesshëm të MFK-së. Për të pasur një sistem të fortë të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në vitin 2020 u miratuan tre dokumente të rëndësishme, konkretisht (1) Dokumenti i Politikave për Zhvillimin e Mëtejshëm të KBFP-së në Shqipëri për periudhën 2021–2022, (2) Udhëzim për delegimin e detyrave dhe (3) Metodologjia për rishikimin e cilësisë së kontrollit të brendshëm. DPHKBFP ka punuar në disa drejtime për të forcuar sistemin e KBFP. Një analizë e mangësive të ligjit të MFK-së është kryer gjatë vitit 2021 dhe është përgatitur drafti i parë i projektligjit. Ligji i rishikuar i MFK-së pritet të miratohet brenda TM4 2022. Është ofruar asistencë teknike për pesë njësi të përzgjedhura (njëra prej tyre është Ministri Linje) për zbatimin e udhëzimit të delegimit të detyrave. DHMFKK ka kryer vlerësimin e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në 20 njësi publike si dhe trajnime me synim vendosjen e një sistemi funksional të kontrollit të brendshëm. Gjatë periudhës 2015-2021 janë zhvilluar aktivitete monitorimi në terren të funksionimit të sistemit të MFK-së në disa institucione buxhetore, si dhe disa aktivitete për ngritjen e kapaciteteve, përfshirë trajnime, këshillime dhe vizita studimore. Gjatë vitit 2020 janë krijuar baza të veçanta të dhënash për gjetjet dhe rekomandimet e AB dhe përditësuar gjatë vitit 2021, të cilat i raportohen Bordit të KBFP.

Përsa i përket forcimit të funksionit të auditimit të brendshëm në sektorin publik, jo të gjitha objektivat e rezultateve u arritën siç ishte planifikuar gjatë vitit 2021 duke treguar një përkeqësim të lehtë krahasuar me vitin 2020. Gjatë vitit 2021, 62% e rekomandimeve të auditimit të brendshëm janë zbatuar duke treguar një përkeqësim në krahasim me vitin 2020 (65%). Meqenëse treguesi merr në konsideratë zbatimin e rekomandimeve të AB brenda dy viteve (2020 dhe 2021), implikimet e COVID-19 gjatë 2020 dhe pjesërisht 2021 si dhe rritja e numrit të rekomandimeve të auditimit për ndryshime në kuadrin ligjor dhe sisteme të tjera të cilat gjithashtu kërkojnë kohë për t’u zbatuar për shkak të kufizimeve të situatës pandemike,

shkalla e rekomandimeve të zbatuara është ulur gjatë vitit 2021. 67% e rekomandimeve bazë të sistemit janë adresuar duke treguar një përmirësim në krahasim me vitin 2020 (42%) për shkak të përmirësimeve në qasjen e auditimit duke u fokusuar më shumë mbi auditimet e bazuara në sistem. Përsa i përket kornizës së auditimit të brendshëm të përafuar me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm, janë bërë përpjekje për të përditësuar kuadrin ligjor. Gjatë vitit 2021, Ligji për AB¹⁸ është rishikuar dhe drafti i parë është finalizuar, si dhe janë përditësuar tre udhëzime të AB. Gjatë viteve 2015-2021 janë bërë përmirësime dhe ndryshime në Ligjin “Për Auditimin e Brendshëm”, si dhe janë miratuar disa akte nënligjore në mbështetje të legjislacionit primar. Ndryshimet në ligjin e AB synojnë të krijojnë mjedisin e duhur për AB që të kryejë auditime në përputhje të plotë me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm. Për më tepër, janë përgatitur tre udhëzime të AB që mbulojnë temat e (a) Vlerësimit të Riskut në angazhimin e auditimit; (b) Zhvillimi i një programi të kontrollit të brendshëm të cilësisë dhe përmirësimit; dhe (c) Auditimi i detyrimeve të prapambetura. Bazat e të dhënave të veçanta për gjetjet dhe rekomandimet e AB janë krijuar gjatë vitit 2020 dhe janë përditësuar gjatë vitit 2021, dhe gjetjet i raportohen Bordit të KBFP. Gjatë periudhës 2015-2021 janë zhvilluar aktivitete monitorimi në terren të funksionimit të AB në disa institucione buxhetore, si dhe disa aktivitete për ngritjen e kapaciteteve, duke përfshirë trajnime dhe këshillime. Janë krijuar 135 Njësi të AB në qeverinë qendrore dhe vendore deri në fund të vitit 2021. 79% e auditorëve të brendshëm në detyrë janë të certifikuar nga Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm dhe pjesa tjetër do të certifikohet gjatë viteve 2022-2023.

Puna për krijimin e një Inspektimi Financiar Publik efikas është në rrugën e duhur ku zbatimi i rekomandimeve të inspektimit financiar është përmirësuar në krahasim me vitin 2020 (88% në 2021 kundrejt 85% në 2020). Inspektorët e jashtëm janë përzgjedhur për të ndihmuar Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik (DIFP) për të kryer inspektime sipas ekspertizës së kërkuar. Një shqyrtim i listës së inspektorëve të jashtëm me qëllim zëvendësimin ose punësimin e të rinjve u krye gjatë vitit 2020 dhe u finalizua gjatë vitit 2021. Vlerësimi i nevojave për trajnim për inspektorët financiarë të brendshëm dhe të jashtëm është kryer në tremujorin e parë të çdo viti dhe janë organizuar trajnime për disa tema sipas kërkesës. Nënshkrimi i 17 marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të ndryshme ndihmoi në forcimin e funksionimit të rrjetit të Shërbimit të Koordinimit Anti-Mashttrim (ShKAM) ndër vite. Strategjia kombëtare kundër mashttrimit për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së nuk u miratua brenda afatit, por puna ka nisur dhe urdhri për ngritjen e grupit të punës për hartimin e strategjisë u miratua në vitin 2022.

Ecuria e komponentëve gjatë vitit 2021

Komponenti 6.1: Menaxhimi financiar dhe kontrolli në të gjitha institucionet publike

DHMFKK ka arritur shumicën e objektivave duke synuar krijimin e një sistemi më të fortë të menaxhimit financiar dhe mjedisit të kontrollit të brendshëm. Disa masa të planit të veprimit të Dokumentit të Politikave¹⁹ “Për Zhvillimin e Mëtejshëm të KBFP në Shqipëri për periudhën 2021–2022” u zbatuan me sukses sipas afatit kohor të përcaktuar. Pas miratimit të udhëzimit “Për delegimin e detyrave të punonjësve në njësitë e sektorit publik²⁰”, është dhënë asistencë teknike për pesë njësi të përzgjedhura (njëra prej tyre është Ministri Linje) për zbatimin e udhëzimit. Stafi i këtyre njësive është trajnuar gjithashtu për konceptin e llogaridhënies menaxheriale dhe rëndësinë e përdorimit të procedurave të delegimit dhe linjave të raportimit, si dhe është ofruar asistencë në terren për përdorimin e procedurave të sakta të delegimit. Përsa i përket rishikimit të bazës ligjore të MFK-së në drejtim të integritetit të planifikimit strategjik, planifikimit afatmesëm dhe vjetor dhe përdorimit të sistemeve të informacionit, nevoja për përmirësimin e bazës ligjore

¹⁸ Lidhur me funksionin e AB-së, ligji i AB-së nuk u finalizua siç ishte planifikuar sepse u pa e nevojshme të merreshin parasysh gjetjet e Raportit të Vlerësimit të MPMQ-së 2021 i cili u lançua në dhjetor 2021.

¹⁹ Urdhër i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 305, datë 18.12.2020

²⁰ <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Udhëzimi-nr.4-date-29.01.2020-Per-delegimin-e-te-drejtave-dhe-detyrave-ne-njesite-e-qeverisjes-se-pergjithshme.pdf>

lidhje me problematikat e evidentuara në raportet vjetore të vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, rekomandimet e dhëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, Auditimi i Brendshëm dhe organet ndërkombëtare. Gjatë vitit 2021 është kryer një analizë e mangësive, ku fokusi kryesor ishte (a) rritja e efektivitetit të funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike; (b) funksionaliteti i Bordit të KBFP dhe (c) forcimi i masave sanksionuese për funksionimin e duhur të sistemit të kontrollit të brendshëm. Gjithashtu, reflektimi i ndryshimeve të parashikuara në ligjin ekzistues është realizuar me sukses dhe është përgatitur drafti i parë i ligjit.

DHMFKK ka kryer vlerësimin e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe trajnimet me synim vendosjen e një sistemi funksional të kontrollit të brendshëm. Në zbatim të Metodologjisë së miratuar për Vlerësimin e Cilësisë të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjatë vitit 2021 është kryer vlerësimi i cilësisë në 20 njësi të përzgjedhura. Në përfundim të procesit të vlerësimit të cilësisë, është hartuar një raport i detajuar me gjetje dhe rekomandime konkrete për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të MFK-së. Sistemi i kontrollit të brendshëm në këto institucione rezulton të jetë kryesisht “pjesërisht efektiv”. Për të forcuar kapacitetet e punonjësve në fushën e kontrollit të brendshëm, janë zhvilluar disa trajnime me temat: (a) për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut, (b) mbi parimet dhe konceptet e menaxhimit të riskut dhe kontabilitetit në sektorin publik dhe (c) mbi konceptet dhe rëndësinë e zbatimit të një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm.

Të gjithë objektivat e përcaktuar për vitin 2021 për forcimin e sistemit të monitorimit në fushën e KBFP-së janë arritur. Gjatë vitit 2021 është kryer një analizë e mangësive të ligjit të MFK-së dhe është përgatitur drafti i parë i ligjit. Ligji i rishikuar i MFK-së pritet të miratohet brenda TM4 2022. Gjatë vitit 2021 janë përditësuar bazat e veçanta të të dhënave për gjetjet dhe rekomandimet e MFK-së dhe AB-së. Këto gjetje dhe rekomandime u përfshinë në raportin vjetor të KBFP. Në mbledhjet e Bordit të KBFP janë diskutuar pikat e forta dhe të dobëta në sistemet e MFK-së në njësitë publike si dhe gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm për përmirësimin e sistemeve.

Komponenti 6.2: Auditimi i brendshëm

Progres është bërë për përmirësimin e funksionit të AB në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Ligji i AB u rishikua bazuar në analizën e hendeqeve ndërmjet kuadrit ligjor të AB në Shqipëri krahasuar me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm të kryer gjatë vitit 2019, gjetjet dhe dobësitë e identifikuara nga Raporti i Vlerësimit MPMQ 2021, Raportet e Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë të Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm (DHAB) dhe gjetjet e KLSH. Ndryshimet në ligjin e auditimit të brendshëm synojnë të krijojnë mjedisin e përshtatshëm për AB për të kryer auditime në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të AB-së. Projektligji është përgatitur në bashkëpunim me Asistencën Teknike të MPMQ-së dhe ka qenë në proces konsultimi publik deri në fund të vitit 2021. Për më tepër, janë përgatitur tre udhëzime me mbështetjen e ekspertëve të MPMQ-së që mbulojnë temat (a) Vlerësimi i Riskut në angazhimin e auditimit; (b) Zhvillimi i një programi të kontrollit të brendshëm të cilësisë dhe përmirësimit; dhe (c) Auditimi i detyrimeve të prapambetura. Të gjitha udhëzimet iu prezantuan komunitetit të AB si dhe janë kryer trajnime për këto tema për audituesit e brendshëm nga DHAB. Udhëzime të tilla do t'u ofrojnë audituesve të brendshëm udhëzime dhe njohuri shtesë për vlerësimin e riskut, Programin e cilësisë së kontrollit të brendshëm dhe auditimin e detyrimeve të prapambetura, në mënyrë që të rrisin kapacitetet e tyre audituese.

Dy objektivat e synuara të produktit për rritjen e kontributit të AB-së në përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, u përmbushën. Siç u raportua nga njësitë për auditimin e brendshëm, gjatë vitit 2021, audituesit vlerësuan përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm duke u fokusuar në: (a) sistemin e menaxhimit financiar në tërësi b) nxjerrjen e rekomandimeve për të përmirësuar efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe (c) ndjekjen e statusit të rekomandimeve të nxjerra. Më shumë se 7,660 gjetje u identifikuan në lidhje me dobësitë e sistemit dhe rekomandime të përshtatshme në lidhje me MFK-në u raportuan në Bordin e KBFP në Raportin Vjetor të vitit 2021.

Komponenti 6.3: Inspektimi financiar publik

Të gjitha objektivat që synonin rritjen e rolit të inspektorëve financiarë u përmbushën gjatë vitit 2021.

Në tremujorin e parë të vitit 2021 u krye një vlerësim i nevojave për trajnim për inspektorët financiarë të brendshëm dhe të jashtëm. U organizuan trajnime në module të veçanta si “Kodi i Etikës”, “Konceptet bazë të inspektimit financiar publik”, “Trajtimi i provave” etj. Në këto module morën pjesë 67% e inspektorëve financiarë të brendshëm dhe të jashtëm. Është përgatitur Raporti Vjetor për vitin 2020, si dhe është ndarë dhe publikuar në faqen zyrtare të MFE-së, duke përfshirë gjetjet mbi inspektimet financiare publike.

Strategjia Kombëtare Kundër Mashtrimit për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së nuk u miratua brenda afatit. Hartimi i strategjisë ishte parashikuar të fillonte brenda tremujorit të dytë të vitit 2020, por për shkak të COVID-19 u vendos që të shtyhej fillimi i procesit për në tremujorin e tretë të vitit 2021, gjë që u pasqyrua edhe në PKIE 2021-2023. Strategjia pritet të miratohet brenda tremujorit të katërt të vitit 2024.

Sfidat kryesore dhe hapat e ardhshëm

Përsa i përket rishikimit të bazës ligjore të MFK-së, moskoordinimi brenda strukturave të përfshira në hartimin e ligjit, çon në mosdhënien në kohë të opinioneve/sugjerimeve/komenteve, çka rezultoi në shtyrjen e finalizimit të ligjit të MFK-së brenda vitit 2021. Drafti i parë i projektligjit do të ndjekë procedurën e konsultimeve dhe pas reflektimit të të gjitha komenteve dhe rekomandimeve do të dërgohet për miratim brenda TM4 2022. Ndërsa për shkak të mosndërgjegjësimi të institucioneve për konceptin e delegimit sipas ligjit të MFK-së dhe devijimit të rregullave të dokumentuara të delegimit, do të ofrohet asistencë teknike për pesë njësi të qeverisjes së përgjithshme (Ministria e Mbrojtjes, Bashkia Lezhë dhe Belsh, Prokuroria e Përgjithshme dhe Agjencia e Prokurimit Publik) me qëllim zbatimin me sukses të instrumenteve të MFK-së (udhëzimi i delegimit dhe përdorimi i linjave të raportimit, hartimi i manualeve të proceseve të punës, gjurmës së auditimit, regjistri i riskut dhe plani i veprimit për ngritjen e sistemit të MFK-së). Përsa i përket sistemeve funksionale të kontrollit të brendshëm, pavarësisht punës së bërë nga DHMFKK, disa nga sfidat e hasura për arritjen e objektivave konsistonin në kufizimin e aktiviteteve në terren për shkak të faktorëve kryesorë si pandemia COVID-19; lloji i aktivitetit të institucionit pritës që redukton disponueshmërinë e stafit përgjegjës për ndjekjen e procesit të vlerësimit të cilësisë dhe zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm; mungesa e angazhimit të menaxherëve dhe stafit në institucionin pritës në lidhje me disponueshmërinë e dokumentacionit të kërkuar gjatë procesit të vlerësimit të cilësisë; mungesa e infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e trajnimeve dhe mungesa e buxhetit të planifikuar për trajnime. Në vijim janë planifikuar të zhvillohen trajnime në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike dhe Projektin e Financave Vendore. Në lidhje me forcimin e sistemit të monitorimit të KBFP-së, mbingarkesa e punës për shkak të aktiviteteve të shumta çoi në rishikimin e parakohshëm të bazës së të dhënave dhe disponueshmërinë e anëtarëve të bordit të KBFP-së për të analizuar dhe dhënë sugjerime për çështjet e raportuara.

Lidhur me funksionin e AB-së, ligji i AB-së nuk u finalizua siç ishte planifikuar sepse u pa e nevojshme të merren parasysh gjetjet e Raportit të Vlerësimit të MPMQ-së të vitit 2021 i cili u lançua në dhjetor 2021. Për të pasur udhëzime të AB me instruksione të qarta dhe të dobishme, draft udhëzimet u prezantuan në 135 njësitë e AB përmes aktiviteteve të trajnimit pilot. Pas fazës së pilotimit dhe reflektimit të komenteve përfundimtare, tre udhëzimet do të dërgohen për miratim brenda shtatorit të vitit 2022.

Përsa i përket inspektimit financiar publik, COVID-19 dhe mungesa e ekspertizës së nevojshme penguan procesin e fillimit të hartimit të strategjisë kombëtare kundër mashtrimit për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së. Megjithatë, gjatë vitit 2022 është miratuar urdhri për ngritjen e grupit të punës për hartimin e strategjisë, si dhe të disa strukturave/institucioneve, pjesë e rrjetit të raportimit të shërbimit “ShKAM”. Për më tepër, DIFP/ShKAM do të vazhdojë të koordinojë ofrimin e asistencës teknike nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm me Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF).

3.7 Ecuria për Objektivin Specifik 7 “Mbikëqyrja e jashtme efektive e financave publike”


Niveli i arritjes së objektivave të treguesve të performancës së rezultateve që synojnë forcimin e funksionit të mbikëqyrjes së jashtme duke e sjellë atë në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA) është 120% në vitin 2021 duke treguar përmirësim në krahasim me vitin 2020 (111 %), por duke mbetur në të njëjtën kategori si në vitin 2020 (tejkualuar).

Tabela 8: Treguesit e Performancës së Rezultateve për OS 7

Rezultati	Treguesi i Performancës	Vlera faktike VF 2020	Vlera e synuar VF 2021	Vlera faktike VF 2021
XXIII) Përmirësimi i mëtejshëm i auditimit të jashtëm për të rritur sa më shumë vlerat dhe përfitimin e tij në shoqëri	*XXIIIa) % e rekomandimeve të pranuar dhe të zbatuara të auditimit nga subjektet a audituara	N pr:94% N zb:47%	N pr: ≥ t-1 (Tendencë në rritje) N zb: ≥ t-1 (Tendencë në rritje)	N pr: 93% N zb: 55%
	XXIIIb) Pesha e auditimeve finansiare (auditim financiar i pastër + auditim i kombinuar) dhe auditim performance	AF: 7% AP: 12,5%	AF: ≥ 20% AP: ≥ 14%	AF: 36,7% AP: 11,5%

* Treguesit janë matur për periudhën janar – dhjetor 2020 pasi shkalla e zbatimit të rekomandimeve matet vetëm 6 muaj pas nxjerrjes së tyre.

Grafiku 10: Statusi i objektivave të produkteve të OS 7 për vitin 2021



Progres është bërë për të forcuar funksionin e mbikëqyrjes së jashtme duke e sjellë atë në përputhje me standardet e ONISA. Për sa i përket treguesit të performancës “% e rekomandimeve të pranuar dhe zbatuara të auditimit nga subjektet e audituara”, për vitin 2021 vihet re një rënie me 1% për rekomandimet e pranuar dhe një rritje me 8% për rekomandimet e zbatuara nga subjektet e audituara, gjë që tregon përmirësim të cilësisë së punës audituese të KLSH-së. Për sa i përket treguesit të performancës “Pesha e auditimit financiar të pastër + auditim i kombinuar dhe e auditimit të performancës”, për vitin 2021 vihet re një rritje me rreth 16.7% për auditimin financiar + auditime të kombinuara dhe një rënie me 2.5% për auditimin e performancës. KLSH ka rishikuar planin vjetor të auditimit²¹ për vitin 2021 duke kryer 158 auditime nga 120 të planifikuara, duke kryer në këtë mënyrë më shumë auditime financiare dhe të kombinuara. Gjithashtu, për shkak të interesit të lartë publik për çështje specifike, si COVID-19 apo punimet e rindërtimit pas tërmetit të nëntorit 2019, KLSH në vitin 2021 ka rritur numrin e auditimeve tematike (gjithsej 7) të cilat nuk ishin planifikuar në planin vjetor. Ndryshimi i planit vjetor të auditimit dhe rritja e numrit të auditimeve të pastra financiare, auditimeve financiare dhe të kombinuara, si dhe auditimeve tematike ka ulur peshën specifike të planifikuar të auditimeve të performancës përkundrejt faktit.

Gjatë viteve 2015-2021 është punuar për të rritur pavarësinë e audituesve. Një ligj i ri “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”²² u miratua në vitin 2014 nga Kuvendi. Qëllimi kryesor i tij ishte të rregullonte pavarësinë funksionale, operacionale dhe financiare, mandatin dhe organizimin e Organizatës si dhe të përafronte disa prej kërkesave nga Standardet Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit (SNISA) si përdorimi i auditimeve financiare dhe/ose të performancës. Në vitin 2020 u krijua një grup pune për të punuar për ndryshimet e ligjit bazuar në disa gjetje të raportit të progresit të Komisionit Europian të vitit 2020, si dhe zbatimin e praktikave më të mira që synojnë përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë për hapjen e negociatave për kapitullin 32 “Kontrolli financiar”.

KLSH miratoi disa Standarde të reja Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit, të cilat sollën kalimin nga auditimet e përputhshmërisë në ato financiare dhe të performancës. KLSH ka adoptuar qasje të reja auditimi dhe janë zhvilluar dhe përditësuar metodologjitë dhe udhëzimet e duhura. Në fund të vitit 2015 janë miratuar manualët për auditimin e përputhshmërisë, financiar, performancës dhe TI-së, të cilët janë rishikuar dhe ndryshuar gjatë vitit 2020 dhe 2021. Gjatë vitit 2021 është ndryshuar edhe manuali i Auditimit të Performancës. Në vitin 2019 u miratua një metodologji e re për planifikimin e aktivitetit të auditimit bazuar në risk dhe gjithashtu u përgatit një manual për Sigurimin e Cilësisë që plotëson standardet SNISA 40. Plani vjetor i auditimit përgatitet çdo vit bazuar në këtë metodologji. Ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi profesional i stafit të auditimit ishte një nga objektivat strategjikë të KLSH-së dhe çdo auditues ka marrë mesatarisht 25-28 ditë trajnim gjatë periudhës 2015 - 2021 për t'i ndihmuar ata të thellojnë njohuritë e tyre në lidhje me auditimin financiar, të performancës dhe auditimin e TI-së si dhe qasjet e tjera të auditimit tematik.

Ndikimi i auditimit nëpërmjet një komunikimi më të mirë me të gjitha palët e interesuara është rritur. Komunikimi dhe angazhimi me Parlamentin, Qeverinë, median dhe qytetarët u përmirësuan me zbatimin e Strategjive të Zhvillimit të KLSH-së dhe Kodit të ri të Etikës. Hapat për të adresuar shqetësimet në lidhje me uljen e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së janë bërë nëpërmjet një rregulloreje parlamentare që synon të sigurojë një mekanizëm më efektiv për monitorimin e ndjekjes së gjetjeve, megjithëse nevojitet punë e mëtejshme. Gjithashtu, u krijua një Sekretariat i Përbashkët me anëtarë nga KLSH dhe MFE, me qëllim gjetjen e mënyrave për të përmirësuar shkallën e zbatimit të rekomandimeve të KLSH dhe të auditimit të brendshëm. Gjatë vitit 2020 u miratua një plan i bazuar në aktivitetet dhe u përfunduan të gjitha aktivitetet e planifikuara, ndërsa gjatë vitit 2021 nuk u zhvillua asnjë takim për shkak të lëvizjeve të stafit në nivele të ndryshme drejtuese

²¹ Për përmbushjen e detyrimit, në zbatim të Vendimit të Gjykatës së Lartë nr. 9, datë 23.02.2021 i cili ka lënë në fuqi detyrimin që rrjedh nga neni 50 i ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” për auditimin vjetor nga KLSH të pasqyrave financiare të njësisë të vetëqeverisjes vendore.

²² Ligji nr. 154, datë 21 nëntor 2014

në KLSH-së dhe MFE-së. Një sërë raportesh mbi aktivitetet e KLSH-së iu dorëzuan Kuvendit, përfshirë raportin për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Ecuria e komponentëve gjatë vitit 2021

Komponenti 7.1: Auditimi i jashtëm

Objekti që synon të rrisë pavarësinë e audituesve nuk është arritur siç është planifikuar. Projektligji është dërguar në Kuvend për miratim që nga janari i vitit 2020. Megjithatë, bazuar në disa gjetje të progres raportit të KE-së të vitit 2020, si dhe në zbatimin e praktikave më të mira që synojnë përmbytjen e detyrimeve të Shqipërisë për hapjen e negociatave për kapitullin 32 “Kontrolli financiar”, u vendos që të rishikohet Ligji i cili parashikohet të miratohet nga Kuvendi deri në fund të vitit 2022.

U përmbytën të gjitha objektivat e planifikuara për vitin 2021 që synonin përafrimin e mëtejshëm të qasjeve të auditimit me standardet ndërkombëtare. Së pari, u përgatit plani vjetor i auditimit për vitin 2021 bazuar në metodologjinë e rishikuar “Metodologjia e planifikimit vjetor strategjik për aktivitetin auditues bazuar në risk”. Si rezultat, për çdo auditim të planifikuar për t’u kryer gjatë vitit 2021, u përcaktua niveli i riskut, si dhe për çdo auditim individual u përcaktuan programi dhe drejtimet e auditimit bazuar në analizën e riskut. Së dyti, gjatë vitit 2021, stafi i KLSH-së u angazhua në rishikimin dhe ndryshimin e kuadrit rregullator të institucionit, si: rishikimi i manualit të auditimit në përputhje me “Deklaratat Profesionale të Kuadrit të ONISA”. Manuali i Auditimit të Performancës u përditësua dhe u miratua në Nëntor 2021. Në Dhjetor 2021 u zhvillua një trajnim me audituesit e Departamentit të Auditimit të Performancës dhe audituesit e departamenteve të tjera të auditimit për t’u njohur me manualin e përditësuar. Së treti, audituesit e KLSH-së, përfshirë edhe të sapo punësuarit, kanë kryer mesatarisht 26.7 ditë trajnime. Audituesit e rinj me përvojë deri në 1 vit në KLSH kanë kryer 30.5 ditë trajnim. Trajnimet u organizuan si brenda institucionit, ashtu edhe jashtë tij. Temat kryesore të trajnimeve ishin Standardet Profesionale të ONISA-s, manualët dhe udhëzimet e auditimit që janë në fuqi në lidhje me menaxhimin financiar, kontrollin e brendshëm dhe auditimin e brendshëm në sektorin publik, Antikorrupsionin dhe Integritetin, mbi auditimin e çështjeve që lidhen me pandeminë e COVID-19 dhe për Prokurimet Publike dhe Koncesionet.

Jo të gjitha objektivat e vendosura për vitin 2021 janë përmbytshur për të rritur ndikimin e auditimit përmes një komunikimi më të mirë me të gjitha palët e interesuara. Objekti i parë ka të bëjë me funksionalizimin e Sekretariatit të Përbashkët të krijuar në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet KLSH-së dhe MFE-së. Gjatë vitit 2021, nuk u zhvillua asnjë mbledhje e Sekretariatit të Përbashkët për shkak të lëvizjes së stafit në nivele të ndryshme drejtuese në KLSH dhe MFE. Për shkak të ndryshimeve të stafit në KLSH, grupi që përfaqëson KLSH-në në Sekretariatin e Përbashkët është riformuar me Vendimin Nr.88, datë 20.09.2021. Në shtator 2021, KLSH-ja informoi MFE-në për ndryshimet e stafit të saj dhe propozoi organizimin e një takimi me temën “Miratimi i planit vjetor të veprimtarisë së Sekretariatit për vitin 2021”. Për sa i përket objektivit të dytë, KLSH ka paraqitur në Kuvend raporte të ndryshme si: (a) Raportin për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimit; (b) Raportin për Performancën Vjetore 2020; dhe (c) Raportin për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2020.

Sfidat kryesore dhe hapat e ardhshëm

Sa i përket auditimit të jashtëm, disa sfida penguan arritjen e disa objektivave si miratimi i Ligjit për KLSH-në dhe funksionalizimi i Sekretariatit të Përbashkët. Ligji për KLSH nuk ishte në axhendën e Kuvendit për vitin 2021. Megjithatë, bazuar në gjetjet e raportit të progresit të KE-së dhe nevojës për plotësimin e kërkesave, u krijua një grup pune për të punuar për ndryshimet e ligjit. Ndërsa, ndryshimet e stafit në KLSH dhe MFE ndikuan edhe në grupin përfaqësues të Sekretariatit të Përbashkët, i cili u riformua në vitin 2021. Megjithatë, një takim online i Sekretariatit të Përbashkët u mbajt më 2 shkurt 2022, me qëllim diskutimin e draft planit të veprimit të Sekretariatit. Gjatë vitit 2022 janë planifikuar të mbahen katër takime në të cilat do të trajtohen çështjet e mëposhtme: (a) Krijimi i një grupi të përbashkët pune ndërmjet dy institucioneve për hartimin e

metodologjisë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm me qëllim standardizimin e hartimit, monitorimit dhe raportimit për zbatimin e rekomandimeve; (b) Diskutimi dhe adresimi i rekomandimeve të KLSH-së pas gjetjeve të Raportit “Për zbatimin e buxhetit aktual 2021” dhe (c) Diskutimi i problemeve të identifikuara nga auditimet në lidhje me detyrimet e prapambetura.

4. Performanca e kategorizuar sipas standarteve

Arritjet kryesore gjatë vitit 2021 të treguesve të performancës për çdo OS janë paraqitur si më poshtë:

Për OS1 “Kuatër fiskal i qëndrueshëm dhe i matur” të gjithë treguesit e performancës kanë ecur siç është planifikuar gjatë vitit 2021:

- Raporti i borxhit ndaj PBB-së ishte 2,9 % më pak se viti paraardhës.
- PBB nominale e parashikuar në krahasim me parashikimin e Perspektivës Ekonomike Botërore të FMN-së është më pak se 0.
- Balanci primar është 2.1% më pak se viti paraardhës.
- Deficiti faktik i vitit 2021 ishte më i vogël se deficiti i planifikuar në buxhet (-29.8%)
- Devijimi në përqindje i arkëtimit aktual ishte 1.2%, që ishte më pak se -5% e vlerësimit fillestar të buxhetit të miratuar për të ardhurat tatimore dhe doganore
- Raportimi i rrezikut fiskal sipas (PEFA PI 10) është vlerësuar me shkronjën “B”.

Për OS 2 “Planifikim i Mirëintegruar dhe Efikas” shumica e treguesve të performancës ka ecur siç ishte planifikuar gjatë vitit 2021:

- Raporti “Totali i shpenzimeve të planifikuara për KPBA miratuar në vitin n / total i shpenzimeve të planifikuara në vitin n në buxhetin vjetor” në vitin 2021 ishte 2.5% dhe kishte një përmirësim të konsiderueshëm krahasuar me vitin 2020;
- Realizimi faktik i shpenzimeve sipas funksionit (PEFA PI-2, 2.1) kishte të njëjtin vlerësim krahasuar me vitin 2020. Varianca e përbërjes ndërmjet kostove aktuale sipas funksionit dhe shpenzimeve të buxhetuara është më pak se 10% në të tre vitet e vlerësimit.
- Pjesa e projekteve të investimeve publike që janë propozuar bazuar tek prioritetet strategjike të qeverisë (vlera e projekteve për vitin specifik), në vitin 2021 ishte 90.5%. Kishte një rritje me 8.5% krahasuar me vitin 2020.
- Disbursimet aktuale për projektet e mëdha të investimit krahasuar me disbursimet e planifikuara shoqëruar me shpjegimet përkatëse në rastet kur ka devijime: ndërkohë që në vitin 2020 ky tregues nuk është arritur, në vitin 2021 është bërë progres dhe treguesi është përmbyshur në vlerën 99%.
- Raporti i investimeve të reja publike të dorëzuara në ciklin e PBA kundrejt totalit të investimeve të reja publike të miratuara në një vit në vitin 2021 u rrit me 26.05%
- Norma e mbledhjes së tatimeve (RLGRG) është rritur me 26.2% krahasuar me vitin 2020 (-4.9% në 2020; 21.3% në 2021).

Për OS 3 “Mbledhja e të ardhurave” shumica e treguesve të performancës ka ecur siç ishte planifikuar gjatë vitit 2021:

- % e mbledhjes faktike të tatimeve në vitin N /mbledhja faktike në vitin N-1 -100% (nga tatimet) u rrit në vitin 2021. Raporti 2021/2020 është më i lartë se raporti 2020/2019.
- Objektivi i treguesit të rezulttit “Raporti i deklarimeve tatimore kundrejt vitit paraardhës” u arrit.
- Niveli i të ardhurave nga dogana është rritur në vitin 2021. Mbledhja e të ardhurave nga dogana në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 është rritur me 31.8% (-6.10% në 2020; 25.7% në 2021).

Për OS 4 “Ekzekutimi Efikas i Buxhetit” shumica e treguesve të performancës ka ecur siç ishte planifikuar gjatë vitit 2021:

- Stoku i shpenzimeve (detyrimet e prapambetura si përqindje e totalit të shpenzimeve për vitin fiskal) ishte 2.2%, u arrit objektivi i synuar nën 3% dhe më i ulët se vlera faktike në vitin 2020 (4.4%).
- Objektivi i lidhur me treguesin e rezultatit PEFA 22.2 Monitorimi i detyrimeve të prapambetura të shpenzimeve është përmbushur, me vlerësimin A, në të njëjtin nivel në vitin 2020.
- Stoku i borxhit të brendshëm të risistemuar brenda një viti ishte 48% në vitin 2021.
- Maturimi mesatar i borxhit të brendshëm ishte 793 ditë në vitin 2021.
- Përqindja në vlerë e procedurave të finalizuara me fitues brenda semestrit të parë kundrejt shumës së parashikuar në regjistrin e parashikimeve ishte 60.2% në vitin 2021, ka pasur një përmirësim në krahasim me vitin 2020.
- Përqindja e rasteve kur organi i shqyrtimit nuk ka respektuar afatet kohore të shqyrtimit të rastit është ulur me 11.3% krahasuar me vitin 2020, duke arritur në vlerën 10.8% në vitin 2021.

Për OS5 “Transparenca e Financave Publike” shumica e treguesve të performancës ka ecur siç ishte planifikuar gjatë vitit 2021:

- Përpilimi i Llogarive Kombëtare të Qeverisë sipas Metodologjisë Ndërkombëtare (ESA 2010) është bërë në nivelin 75%, duke mbetur në të njëjtat nivele të vitit 2020.
- Publikimi i raporteve financiare vjetore dhe atyre të gjatë-vitit përmbajnë informacion për performancën financiare dhe jofinanciare, përfshirë TKP për 25.6% e ML-ve.
- Vlerësimi nga Indeksi për Buxhetin e Hapur qëndron në nivelin 7 nga 100 që prej vitit 2019.
- Për herë të parë gjatë vitit 2021 është bërë progres 10% në IP “Kalimi në fazën ku pasqyrat financiare të qeverisë do të paraqesin kontabilitetin në bazë të drejtash dhe detyrimesh të konstatuara” dhe më shumë progres parashikohet në vitet në vijim.

Për OS 6 “Kontrolli i Brendshëm Efektiv” shumica e treguesve të performancës ka ecur siç ishte planifikuar gjatë vitit 2021:

- Niveli i zbatimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në praktikë brenda institucioneve buxhetore;
- Mekanizmat për llogaridhënien menaxheriale në kuadrin rregullator;
- % e rekomandimeve bazuar në sistem që janë adresuar kundrejt numrit total të gjetjeve që janë adresuar;
- % e rekomandimeve të zbatuara të inspektimit financiar (të nxjerra me urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë).

Për OS 7 “Mbykëqyrja e Jashtme Efektive e Financave Publike” shumica e treguesve të performancës ka ecur siç ishte planifikuar gjatë vitit 2021:

- % e rekomandimeve të pranuar dhe të zbatuara të auditimit nga subjektet e audituara;
- Pesha e auditimeve financiare (auditim financiar i pastër + auditim i kombinuar) dhe auditim performace.

5. Risqet dhe hapat për t'i trajtuar

Për të menaxhuar në mënyrë efektive reformat, si dhe bazuar në përvojën e përfutur gjatë periudhës 2014-2021, është bërë një menaxhim më aktiv i risqeve. Këto mbulojnë jo vetëm ato risqe që lidhen me zbatimin e aktiviteteve brenda kuadrit logjik, por edhe risqe të mundshme në përmbushjen e objektivave të përgjithshme të Objektivave Specifikë dhe komponentëve brenda tyre. Gjatë vitit 2021, disa lloje risqesh që ishin parashikuar dhe përfshirë në dokumentin strategjik, ishin të pranishëm dhe penguan përmbushjen e plotë të rezultateve të planifikuara për atë vit. Gjithashtu, pandemia COVID-19 ka rritur ndikimin e saj negativ në arritjen e objektivave strategjike dhe është bërë pengesa kryesore për ecurinë e tyre, jo vetëm për vitin 2020 por gjithashtu ka paraqitur efektet dhe rreziqet edhe për vitin 2021.

Përsa i përket rregullave fiskale, rreziku i jashtëm lidhur me pasojat e COVID-19 dhe rreziku i brendshëm si Burimet Njerëzore (stafi, përgjegjësitë, bashkëpunimi) është materializuar gjatë vitit 2021. Për zbutjen e tyre, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit ka bërë kërkesa për rritje të stafit. Masat lehtësuese që do të ndërmerren për vitin 2022 po plotësojnë kërkesën për staf shtesë.

Lidhur me **zhvillimin e politikave dhe qeverisjes strategjike**, risqet kryesore u lidhën me ndryshimet në fund të vitit 2021 me krijimin, organizimin dhe funksionimin e SASPAC, në varësi të Kryeministrit. Masat zbutëse që do të ndërmerren për vitin 2022 janë: i) Punësimi i stafit të ri për strukturën e SASPAC; dhe ii) Trajnimi i stafit të ri të punësuar.

Në lidhje me **programin buxhetor afatmesëm**, risqet e identifikuar si risqe të brendshme janë sistemet e TI-së; misionet e organizimit të brendshëm (menaxhimi, rolet dhe përgjegjësitë). Për vitin 2022, DAPB, ka vendosur praktikatat/procedurat që do të zbatohen nëse një ose më shumë risqe materializohen.

Në lidhje me planifikimin dhe mbikëqyrjen e investimeve publike, u materializua risku i brendshëm: Burimet Njerëzore (stafi, përgjegjësitë, bashkëpunimi). Departamenti i PIM ka pasur mungesë të stafit. Masat zbutëse që do të ndërmerren për vitin 2022 janë: i) Punësimi i stafit të ri për strukturën SASPAC; dhe ii) Trajnimi i stafit të ri të punësuar.

Në lidhje me **MFP në pushtetin vendor**, gjatë vitit 2021 u materializuar risqet e brendshme si Burimet Njerëzore (stafi, përgjegjësitë, bashkëpunimi), proceset operative; Sistemet e TI-së dhe faktorët e jashtëm si Covid-19 dhe faktorët Mac-roekonomikë. Për zbutjen e tyre janë ndërmarrë disa masa si: i) Trajnimi i stafit të bashkive; ii) Standardizimi i formateve për përgatitjen e dokumenteve buxhetore, iii) Trajnime online për të kuptuar procese të ndryshme operationale. Për vitin 2022 është parashikuar një plan trajnimi më i detajuar; Janë bërë analiza dhe një plan masash për rikuperimin e të ardhurave nga efektet e pandemisë COVID-19 gjatë vitit 2020.

Për sa i përket administratës tatimore, është materializuar risku i jashtëm që lidhet me pasojat e Covid-19. Kishte mungesë stafi për shkak të Covid-19. Për zbutjen e tyre, u ndërmorën disa masa si puna në distancë dhe rishpërndarja e detyrave.

Për sa i përket kadastrës fiskale të pronave, Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë, gjatë vitit 2021 është përballur me risqet operationale që lidhen me mungesën e të dhënave, situatën pandemike dhe vonesën në nënshkrimin e marrëveshjes. Për zbutjen e tyre, u ndërmorën disa masa si kërkimi i tregut nga burime të tjera alternative dhe vazhdimi i punës përmes komunikimit dixhital. Masa zbutëse që do të ndërmerret për vitin 2022 është procesi i vazhdueshëm i kërkimit të tregut.

Lidhur me **menaxhimin doganor**, u materializua risku i jashtëm lidhur me pasojat e Covid-19. Masa e ndërmarrë për të zbutur këtë risk ishte organizimi i përshtatshëm strukturor i burimeve të brendshme. Masat zbutëse që do të ndërmerren për vitin 2022 janë: i) Organizimi i përshtatshëm strukturor i burimeve të brendshme; dhe ii) bashkëpunimi i zgjeruar me agjencitë e brendshme dhe të huaja.

Për sa i përket **zgjerimit të përdorimit të SIFQ-së**, risqet e brendshme si proceset financiare dhe disbursimet e fondeve dhe sistemi i TI-së u materializuan gjatë vitit 2021. Nuk kishte buxhet të disponueshëm për blerjen e licencave të reja të përdoruesve të SIFQ dhe asnjë shërbim i disponueshëm i ekspertizës funksionale të SIFQ (mbështetje funksionale e kualifikuar e jashtme e SIFQ). Për vitin 2022 është miratuar buxheti për licencat e reja të përdoruesve të SIFQ për 5 IB të reja. Megjithatë, ky numër varet nga çmimi i licencës së përdoruesit dhe nga kursi i këmbimit të euros gjatë procesit të prokurimit.

Në lidhje me **kontrollet e angazhimeve shumëvjeçare dhe detyrimet** u materializua risku i brendshëm si: burimet njerëzore (stafi, përgjegjësitë dhe bashkëpunimi). Masa zbutëse të ndërmarra gjatë vitit 2021 ishte komunikimi formal (shkresë-email) me IB-të. Masa zbutëse që do të ndërmerret për vitin 2022 është rritja e përgjegjësisë së BI-ve pilote për informacion cilësor dhe në kohë.

Lidhur me **menaxhimin e borxhit dhe likuiditetit**, gjatë vitit 2021, u materializuan risqe të brendshme si: Komunikimi dhe Informacioni; dhe Burimet Njerëzore (stafi, përgjegjësitë, bashkëpunimi), gjithashtu risku i jashtëm i lidhur me pasojat e COVID 19. Janë ndërmarrë masat zbutëse si në vijim: Komunikimi formal (shkresa-email); fokus i shtuar në qëndrueshmërinë e kapaciteteve të burimeve njerëzore; punësimi i stafit të ri; dhe aktivitete për ngritjen e kapaciteteve. Gjatë vitit 2022 do të ndërmerren masat në vijim: rritja e përgjegjësisë së IB-ve pilote për informacion cilësor dhe në kohë dhe aktivitete për ngritjen e kapaciteteve.

Lidhur me **prokurimin publik**, për APP-në u materializua risk i jashtëm lidhur me pasojat e COVID 19 dhe vendimet politike. Pandemia ka ndikuar në afatin kohor të parashikuar për miratimin e akteve nënligjore duke shkaktuar vonesa. Pas propozimit të Ministrisë së Kulturës, Këshilli i Ministrave ka vendosur heqjen e disa kodeve të Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (PPV) nga VKM 768, datë 15.12.2021. Për sa i përket Komisionit të Prokurimit Publik u materializuan risqe që lidhen me mungesën e financimit dhe vështirësitë e operatorëve për tu përshtatur me sistemin e ri të paraqitjes dhe shqyrtimit të ankesave. Lidhur me përshtatjen e operatorëve ekonomik me sistemin, një nga masat e marra ka qenë zhvillimi i trajnimeve për të gjithë operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktore në të gjitha qarqet e vendit brenda vitit 2021. Për financimin e trajnimeve për vitin 2022, si krahas kërkesës për fonde buxhetore, KPP ka parë edhe mundësinë e financimit nga organizatat ndërkombëtare. Në vitin 2022, KPP do të përgatisë manuale për të ndihmuar OE në përdorimin e sistemit; për trajnime të specializuara KPP ka krijuar kontakte me shkollën e magistraturës si dhe mundësi financimi për të vazhduar trajnimin në Universitetin e Tiranës dhe subjekte të tjera të licencuara që kryejnë trajnime në terren.

Përsa i përket **menaxhimit të ndihmës së jashtme**, është materializuar risku i jashtëm i lidhur me partnerët e huaj i shoqëruar me nivel të pamjaftueshëm të të dhënave të projekteve të regjistruara në sistem nga pikat përgjegjëse të kontaktit. Kjo ka ardhur si rezultat i vëllimit të konsiderueshëm të informacionit të nevojshëm për t'u populluar në SIMAJ, pjesa më e madhe e të cilit bëhet manualisht nga pikat e kontaktit, gjë që kërkon një angazhim të konsiderueshëm kohor. Megjithatë, janë ndërmarrë disa masa si: (a) përmirësimi i sistemit për të ofruar një përvojë më miqësore për përdoruesit lidhur me automatizimin e proceseve të brendshme për miratimin dhe vlefshmërinë e draft projekteve; (b) është kryer një fushatë ndërgjegjësimi nga MFE për të rritur ndërgjegjësimin e komunitetit të Partnerëve për Zhvillim dhe Integrim dhe për të rigjallëruar angazhimin dhe kontributin e tyre për popullimin e sistemit dhe (c) është zhvilluar një sesion trajnimi njëditor përditësues për pikat e kontaktit të grupit të agjencisë së Kombeve të Bashkuara, me kërkesë të tyre. Për më tepër, duke qenë se sistemi SIMAJ tani është nën përgjegjësinë e AShPSKN, nevojitet punësimi i stafit të ri të njësive përkatëse, si dhe ndërtimi i kapaciteteve të tyre mbi funksionalitetet e sistemit.

Për sa i përket **forcimit të ndihmës shtetërore**, arritja e disa objektivave është penguar nga mungesa e Burimeve Njerëzore adekuate, pasi nuk ka staf/njësi të dedikuara. Për këtë arsye, janë bërë konsultime ad hoc me palët e interesuara për njohjen e tyre mbi përgjegjësitë përkatëse. Gjatë vitit 2022 do të zhvillohen takime

me grupet e interesit për skemat e ndihmës dhe përputhshmërinë e tyre me legjislacionin për ndihmën shtetërore.

Për sa i përket Llogarive Kombëtare të Qeverisë, risqet e brendshme dhe të jashtme që u materializuan lidheshin me: risqet e Burimeve Njerëzore (stafi, përgjegjësitë, bashkëpunimi), të lidhura me mungesën e stafit dhe Covid-19. Megjithatë, disa masa u ndërmorën, si aplikimi i punës online dhe punës jashtë orarit.

Për sa i përket Raportimit dhe Monitorimit Financiar dhe atij të Performancës, u materializuan risqet e brendshme, si sistemi i TI dhe Burimet Njerëzore (stafi, përgjegjësitë, bashkëpunimi). Gjatë vitit 2021, DMB ka ndjekur disa seanca testimi në vend, përkatësisht në disa ML, për të monitoruar performancën e Modulit MPPB. Si rezultat, janë ngritur disa çështje, kështu që njësitë përgjegjëse dhe kompania projektuese janë informuar për mospërputhje të raporteve të gjeneruara nga Moduli MPPB i sistemit SIMFSH. Për të shprehur më tej arritjen e këtij komponenti është i nevojshëm plotësimi i vendeve vakante dhe ndjekja e zgjidhjes së çështjeve të SIMFSH.

Për sa i përket komponentit në lidhje me ngazhimin e Qytetarit, nuk ka pasur risqe të materializuara gjatë vitit 2021.

Për sa i përket Kontabilitetit dhe Përmirësimit të Menaxhimit të Aktiveve, u materializuan risqet e brendshme dhe të jashtme, të tilla si: Burimet njerëzore (stafi, përgjegjësitë, bashkëpunimi), Organizimi i brendshëm (menaxhimi, rolet dhe përgjegjësitë), harmonizimi ligjor, rregullimi (përshtatja me SNKSP) dhe komunikimi me palët e interesuara, risqe që lidhen me Covid-19; Partnerët e huaj (kompanitë e konsulentëve dhe partnerët/donatorët e huaj), Institucionet Buxhetore me akses të drejtpërdrejtë në SIFQ nuk përgatitën në kohë informacionin e inventarit të aktiveve për t'u migruar në SIFQ. Edhe pse janë ndërmarrë disa masa gjatë vitit 2021, ato janë ende objekt për t'u ndjekur në vitin 2022, si p.sh.: Rishikimi i prioriteteve dhe planeve operacionale të punës për t'u përshtatur me burimet në dispozicion; Gjetja e metodave alternative për kryerjen e aktiviteteve në terren (trajtime online); Rishikimi i kuadrit rregullator të fushës (standardet); Komunikimi i vazhdueshëm për ndërgjegjësimin e vendimmarrësve dhe drejtuesve të njësive publike për rëndësinë e aktiviteteve në kuadër të zbatimit të SNKSP; Ngritja e kapaciteteve në fushën e zbatimit të SNKSP; dhe Vazhdimi i bashkëpunimit të ngushtë me IB-të përkatëse dhe u kërkua angazhim i nivelit të lartë përmes komunikimit zyrtar

Referuar **menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha institucionet publike**, në arritjen e rezultateve ndikuan disa risqe që lidhen me Burimet Njerëzore, organizimin e brendshëm dhe Covid-19. Gjatë vitit 2021 janë ndërmarrë disa masa për zbutjen e tyre, si: (a) Rishikimi i prioriteteve dhe planeve operative të punës; (b) Janë gjetur metoda alternative për kryerjen e aktiviteteve në terren si takimet dhe trajnimet online; (c) Është bërë një rishikim i kuadrit rregullator në fushën e MFK-së (ligje/rregullore/metodologji); (d) Komunikimi i vazhdueshëm për ndërgjegjësimin e drejtuesve të njësive publike për realizimin e aktiviteteve në kuadër të vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe ofrimit të asistencës teknike; dhe (e) Ngritja e kapaciteteve në kuadër të zbatimit efektiv të sistemit të kontrollit të brendshëm. Të njëjtat masa përveç “Rishikimit të prioriteteve dhe planeve operacionale të punës” do të ndërmerren edhe gjatë vitit 2022.

Në lidhje me **auditimin e brendshëm**, Covid-19 ndryshoi fokusin e auditimit gjatë vitit 2021 në disa risqe të reja të lindura gjatë kohës së Covid-19 (Vendimmarrja dhe procedurat e ndjekura nga institucionet në situatë të jashtëzakonshme). Në këtë kuadër, u vendos që të auditohen fushat me risk të lartë dhe të jepen rekomandime për përmirësime të mëtejshme. Gjithashtu, gjatë vitit 2022 do të rriten kapacitetet profesionale për auditimin e brendshëm dhe do të përmirësohen njohuritë për auditimin në distancë dhe auditimin e bazuar në risk.

Për sa i përket **inspektimit financiar publik**, risku që lidhet me Burimet Njerëzore dhe Covid-19 ka ndikuar në procesin e inspektimeve dhe përgatitjen e strategjisë kombëtare kundër mashtrimit. Megjithatë, gjatë vitit 2021, DIFP ka angazhuar inspektorë të jashtëm financiarë publikë për të kryer inspektimet, si dhe vendet

vakante të DIFP do të plotësohen gjatë vitit 2022. Ndërsa, për shkak të Covid-19, fillimi i hartimit të strategjisë u vendos që të shtyhet dhe të fillojë në tremujorin e tretë të vitit 2021. Gjatë vitit 2022 është miratuar urdhri për ngritjen e grupit të punës përgjegjës për hartimin e strategjisë.

Për sa i përket **auditimit të jashtëm**, risqet që lidhen me Covid-19, mungesa e stafit dhe fondeve të mjaftueshme, infrastruktura e pamjaftueshme e TI-së për të mbështetur numrin në rritje të stafit të KLSH dhe ndryshimet e stafit në KLSH dhe MFE (duke reformuar anëtarët e sekretariatit të përbashkët teknik) penguan arritjen e rezultateve. Për zbutjen e këtyre risqeve, në vitin 2021 janë ndërmarrë disa masa si: (a) Puna online dhe përdorimi i TI-së për marrjen e të dhënave dhe dokumenteve të nevojshme për finalizimin në kohë të procesit të auditimit; (b) U miratua financim shtesë nga buxheti i shtetit për të rekrutuar 15 auditues dhe gjithashtu për të mbuluar pagat dhe sigurimet për kontraktimin e ekspertëve të jashtëm të përkohshëm; (c) Plani vjetor i auditimit është rishikuar duke marrë parasysh interesin publik për çështje specifike; (d) grupi që përfaqëson KLSH-në në Sekretariatit të Përbashkët është reformuar dhe është propozuar zhvillimi i takimit për të diskutuar dhe miratuar planin vjetor të Sekretariatit të Përbashkët për vitin 2021. Përveç kësaj, gjatë vitit 2022, do të ndërmerren masat e mëposhtme: (a) Vazhdimi i monitorimit të situatës pandemike duke marrë parasysh vendimet e marra nga qeveria shqiptare për parandalimin e pasojave të pandemisë në shëndetin e qytetarëve; (b) Pajisjet e punës do të sigurohen për personelin shtesë; (c) Një takim online i Sekretariatit të Përbashkët u mbajt në shkurt 2022 me qëllim për të diskutuar dhe miratuar draft planin e veprimit të Sekretariatit për vitin 2022.

Raporti i Monitorimit të Menaxhimit të Financave Publike 2021

	Faktorët e Brendshëm të Riskut									Faktorët e Jashtëm				
	1. Risqet e lidhura me Proceset e Planifikimit dhe Sistemet Operacionale				II. Burimet Njerëzore dhe Institucionet			III. Aspektet Ligjore dhe Supervizimi	IV. Komunikimi dhe Informacioni	I. Gjeopolitikë,	II. Faktorët Makro Ekonomikë	III. Forca madhore	IV. Vendimet Politike	V. Partnerët e Jashtëm (Agjensi, konsulent, media, partnerët e biznesit)
	1.1. Strategjia, planifikimi i politikave,	1.2. Proceset operative	1.3. Proceset financiare dhe disbursimet e fondeve	1.4. Sistemet e TI	2.1. Burimet Njerëzore (staf, përgjegjësi, bashkëpunim)	2.2. Sjellja Etike dhe Institucionale (mashttrim, Konflikt i Interesit)	2.3.organizim I Brendshëm, (menaxhimi, rolet dhe përgjegjësitë)	3.1. Harmonizimi dhe Rregullimi Ligjor,	4.1. Metodat dhe kanalet e komunikimit, Informacioni cilësor dhe në kohë.			pasoja e COVID 19, Lufta		
Objektivi specifik 1 – Kuadër fiskal i qëndrueshëm dhe i matur														
1.1 Rregullat fiskale dhe parashikimi														
1.2 Menaxhimi i riskut fiskal														
Objektivi specifik 2: Planifikim i mirëintegruar dhe efikas														
2.1 Zhvillimi i politikave dhe qeverisje strategjike														
2.2 Programi buxhetor afatmesëm														
2.3 Planifikimi dhe mbikqyrja e investimeve publike														
2.4 MFP në qeverisjen vendore														
Objektivi specifik 3: Mbledhja e të ardhurave														
3.1 Administrimi tatimor														
3.2 Kadastra fiskale e pronave														
3.3 Menaxhimi doganor														
Objektivi specifik 4: Zbatimi efikas i buxhetit														
4.1 Zgjerimi i përdorimit të SIFQ-së														
4.2 Kontrollat e angazhimeve shumëvjeçare dhe llogaritë e pagueshme														
4.3 Menaxhimi i borxhit dhe likuiditetit														
4.4 Prokurimi Publik														
4.5 Menaxhimi i fondeve të jashtme														
4.6: Forcimi i rolit të ndihmës shtetërore														
Objektivi Specifik 5: Transparenca e Financave Publike														
5.1 Llogaritë Kombëtare të Qeverisë														
5.2 Raportimi dhe Monitorimi Financiar dhe ai i Performancës														
5.3 Angazhimi I Qytetarëve														
5.4 Kontabiliteti														
5.5 Menaxhimi i Akriveve														
Objektivi Specifik 6:Kontrolli i brendshëm efektiv														
6.1 Menaxhimi financiar dhe kontrolli në të gjitha institucionet publike														
6.2 Auditimi i brendshëm														
6.3 Inspektimi financiar publik														
Objektivi Specifik 7: Mbiqëqyrje e jashtme efektive e financave publike														
7.1 Auditimi i jashtëm														

6. Kostoja e Strategjisë MFP

Më poshtë është një përmbledhje e shkurtër e burimeve të përdorura për zbatimin e reformës, duke paraqitur të dhënat financiare për shpenzimet gjatë zbatimit të secilit objektiv specifik si shumën e fondeve të buxhetit të qeverisë të shpenzuara dhe financimin e donatorëve në euro.

Shumat në Euro

	Financim i brendshëm	Financim i huaj	TOTALI	Plani 2021	% e ndryshimit
OS 1 Kuadër fiskal i matur dhe i qëndrueshëm	106,629	0	106,629	99,804	7%
1.1 Rregullat fiskale dhe parashikimi	36,000	0	36,000	48,000	-25%
1.2 Menaxhimi i riskut fiskal	70,629	0	70,629	51,804	36%
OS 2 Planifikim i mirëintegruar dhe efikas	1,927,180	9,147,016	11,074,196	3,459,083	220%
2.1 Zhvillimi i politikave dhe qeverisje strategjike e integruar	1,893,547	0	1,893,547	497,280	281%
2.2 Plani buxhetor afatmesëm	13,453	633,679	647,132	555,721	16%
2.3 Planifikimi dhe mbikëqyrja e investimeve publike	0	3,483,938	3,483,938	917,186	280%
2.4 MFP-ja në qeverisjen vendore	20,180	5,029,400	5,049,579	1,488,896	239%
OS 3 Mbledhja e të ardhurave	4,886,658	1,366,222	6,252,880	11,446,901	-45%
3.1 Administrata tatimore	4,381,338	0	4,381,338	3,324,492	32%
3.2 Kadastra fiskale e pronave	0	63,824	63,824	777,778	-92%
3.3 Menaxhimi doganor	505,320	1,302,398	1,807,718	7,344,631	-75%
OS 4 Zbatimi efikas i buxhetit	408,393	1,650,330	2,058,723	1,334,054	54%
4.1 Zgjerimi i përdorimit të SIFQ-së	0	0	0	461,104	-100%
4.2 Kontrollat e angazhimeve shumëvjeçare dhe llogaritë e pagueshme	30,270	0	30,270	129,510	-77%
4.3 Menaxhimi i borxhit dhe likuiditetit	50,449	361,721	412,170	86,030	379%
4.4 Prokurimi Publik	260,408	1,288,609	1,549,017	398,391	289%
4.5 Menaxhimi i fondeve të jashtme	13,453	0	13,453	51,804	-74%
4.6 Forcimi i rolit të ndihmës shtetërore	53,813	0	53,813	207,216	-74%
OS 5 Transparenca e financave publike	1,849,509	993,956	2,843,464	7,591,806	-63%
5.1 Llogaritë kombëtare të qeverisë	1,802,422	85,345	1,887,767	6,372,582	-70%
5.2 Monitorimi dhe raportimi financiar dhe i performancës	0	727,273	727,273	563,265	29%
5.3 Angazhimi qytetarëve	16,816	0	16,816	64,755	-74%
5.4 Kontabiliteti	0	181,338	181,338	392,213	-54%
5.5 Menaxhimi i përmirësuar i aktiveve	30,270	0	30,270	198,991	-85%
OS 6 Kontroll i brendshëm efektiv	127,805	26,400	154,205	329,685	-53%
6.1 Menaxhimi financiar dhe kontrolli në institucionet publike	97,536	0	97,536	192,363	-49%
6.2 Auditimi i brendshëm	10,090	26,400	36,490	46,853	-22%
6.3 Inspektimi financiar publik	20,180	0	20,180	90,469	-78%
OS 7 Mbikëqyrje efektive e jashtme e financave publike	1,393,336	0	1,393,336	1,392,000	0.1%
7.1 Auditimi i jashtëm	1,393,336	0	1,393,336	1,392,000	0.1%
TOTALI	10,699,509	13,183,924	23,883,433	25,653,333	-6.90%

7. Përfundime dhe Rekomandime

Raporti vjetor i monitorimit janar - dhjetor 2021, në zbatim të Planit të Veprimit 2020-2022 të Strategjisë së MFP 2019-2022 përmban informacion mbi zbatimin e shtatë objektivave specifike të strategjisë, treguesit e performances së Objektivave Specifike / produkteve sipas vlerave të objektivave të synuara, arritjeve dhe aktiviteteve konkrete të parashikuara. Ky dokument është raporti i dytë i monitorimit duke përdorur metodologjinë e sistemit SIPI/IPSIS dhe janë bërë përpjekje për të patur një përafrim më të mirë me standardet e sistemit IPSIS.

Ky raport ofron informacion specifik për objektivat e synuara të vitit 2021 të Objektivave Specifike dhe produkteve, problemet e hasura gjatë zbatimit, sfidat e institucioneve si dhe identifikimin e masave të nevojshme korrigjuese për periudhat në vijim. Gjithashtu, përmban të dhëna statistikore dhe analitike të bazuara në raportimin e drejtpërdrejtë të institucioneve përgjegjëse, në raportet dhe informacionet e publikuara, konsultimet me të gjithë aktorët e MFP-së.

Qeveria e Shqipërisë ka bërë progres të mirë në zbatimin e Strategjisë së Reformës së Menaxhimit të Financave Publike. Ky raport ofron një vlerësim të kriterëve të pranueshmërisë së MFP-së për BE-në për të ofruar mbështetje buxhetore për Shqipërinë. Kriteri i pranueshmërisë së MFP-së kërkon ekzistencën e një programi të besueshëm dhe të rëndësishëm për të përmirësuar menaxhimin e financave publike si dhe progres të kënaqshëm në zbatimin e programit. Bazuar në vetë-vlerësimin tonë, progresi i MFP-së ka qenë përgjithësisht i kënaqshëm. Monitorimi tregon një ecuri shumë të mirë të strategjisë së MFP-së gjatë vitit 2021, me nivel realizimi prej 100% të arritjes së rezultateve të objektivave specifike, përkatësisht OS1 100%, OS2 106%, OS3 86%, OS4 106%, OS5 80 %, OS6 104 % dhe OS7 120%. Niveli i realizimit të bazuar në nivelin e arritjes së objektivave të synuara të produktit për vitin 2021 ishte 79.31%, me 57.76% të objektivave të synuara të produkteve të përmbushura plotësisht në vitin 2021 dhe me 21.55% të tyre në progres, për të cilin puna do të vazhdojë dhe në vitin e ardhshëm. OS3 ka numrin më të madh të objektivave të synuara të produktit që nuk kanë progresuar siç ishte planifikuar gjatë vitit 2021 (52.94%), i ndjekur nga OS5 (50%), ndërsa OS6 ka numrin më të ulët (vetëm 20% nuk ka patur progres siç ishte planifikuar).

Informacioni i raportuar duhet të përpunohet dhe dorëzohet në përputhje me kategorinë e informacionit, të jetë faktik, të ketë evidenca të qarta dhe të dhëna analitike në përputhje me raportet e përgatitura nga institucionet përgjegjëse. Për më tepër, njësitë përgjegjëse duhet të ndjekin masat zbutëse për risqet e identifikuar në mënyrë që të sigurojnë përmbushjen e objektivave të përcaktuara për vitin 2022. Gjithashtu, duhet të monitorojnë progresin në mënyrë të vazhdueshme për të ndërmarrë veprime në kohë për ato objektiva të synuara që nuk po funksionojnë mirë.

Shkurtime dhe Akronime

AB	Auditi i Brendshëm
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
AT	Asistenca Teknike
BE	Bashkimi Evropian
BPGJ	Buxheti i Përgjegjshëm Gjnor
DAPB	Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor
DHAB	Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm
DHMFKK	Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit
DIFP	Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik
DFV	Drejtoria e Financave Vendore
DMB	Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit
DMIP	Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DPTP	Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë
DPHKBFP	Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik
DRF	Deklarata e Riskut Fiskal
DWH	Data Warehouse
DZHM	Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IB	Institucione Buxhetore
INSTAT	Instituti i Statistikave
KBFP	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik
KD	Komitet Drejtues
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KPS	Komiteti i Planifikimit Strategjik
KNSh	Komisioni i Ndihmës Shtetërore
KT	Komitet Teknik
LOB	Ligji Organik i Buxhetit
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFP	Menaxhimi i Financave Publike
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MIP	Menaxhimi i Investimeve Publike
ML	Ministri Linje
MPMQ	Mbështetja për Përmirësim në Menaxhim dhe Qeverisje
MSFQ	Manuali i Statistikave Financiare të Qeverisë
NSH	Ndërmarrje Shtetërore
NjRF	Njësia e Riskut Fiskal
OBZhe	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OEA	Operatorët Ekonomikë të Autorizuar
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
OSHC	Organizata të Shoqërive Civile

PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PBB	Produkti i Brendshshëm Bruto
PEFA	Shpenzimet Publike dhe Llogaridhënia Financiare
PPP	Partneriteti Publik Privat
QQ	Qeverisja Qendrore
QSH	Qeveria e Shqipërisë
RA	Rishikimi Afatmesëm
RAP	Reforma e Administratës Publike
SAA	Strategjia Afatmesme e të Ardhurave
SAMB	Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit
SELL	Sistemi Evropian i Llogarive
SFQ	Statistikat Financiare të Qeverisë
SIFQ	Sistemi Informativ Financiar Qeveritar
SIMAJ	Sistemi Informatik i Menaxhimit të Asistencës së Jashtme
SIMBNJ	Sistemi Informatik i Menaxhimit të Burimeve
SIMFSH	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar Shqiptar
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
TVSH	Tatim mbi Vlerën e Shtuar
ZKM	Zyra e Kryeministrit

Shtojca 1: Treguesit e Rezultateve të Performancës

Tabela 1: Rezultatet kryesore dhe treguesit e performancës për OS 1 “Kuangër Fiskal i Qëndrueshëm dhe i Matur”

Rezultati	Treguesi i performancës	Institucion i lider	Vlera bazë	Vlera Faktike VF 2019	Vlera Faktike VF 2020	Vlera e synuar VF 2021	Vlera faktike VF 2021
I) Rritja e besueshmërisë së kuadrit fiskal	Ia) Raporti mes borxhit dhe PBB	DP Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale	68%	66.3%	76.1%	< FY 20	73.2%
	Ib) PBB nominale e parashikuar në krahasim me parashikimet e FMN-së Fondi Monetar Ndërkombëtar		-5.9 bilion ALL	-16.5billion ALL	ALL -0.2 bilion	< 0	-0.03 bilion ALL
	Ic) Bilanci primar		+0.5%	0.20%	-4.7%	> FY20	-2.6%
	Id) Diferenca mes tepcicës /deficitit të synuar të parashikuar në buxhet për vitin buxhetor		-18%	-4%	-17.0%	≤ deficitit i planifikuar	-29.2%
	Ie) Përqindja e devijimit të mbledhjes konkrete është brenda % të përcaktuar/miratur të vlerësimit buxhetor për të ardhurat tatimore dhe doganore		-1.4%	-3.50%	-16.80%	> -5%	1.20%
II) Identifikimi dhe frenimi i risqëve fiskale më efektivisht	Ila) Raportimi i riskut fiskal (PEFA PI 10)		C (2017)	B+	B	B	B

Tabela 2: Rezultatet kryesore dhe treguesit e performancës për OS 2 “Planifikimi i Mirëintegruar dhe Efikas”

Rezultati	Treguesi i performancës	Institucioni lider	Vlera bazë	Vlera Faktike VF 2019	Vlera Faktike VF 2020	Vlera e synuar VF 2021	Vlera faktike VF 2021
III) Dokumentet qeveritarë që shërbejnë për planifikim, si SKZHI, Strategjitë Sektoriale dhe PBA-ja janë harmonizuar plotësisht me njëra-tjetrën.	IIIa) është identifikuar raporti mes financimit total të parashikuar në strategjitë sektoriale dhe financimit total që është identifikuar për sektorët korespondues brenda PBA-së.	DP e Buxhetit	56% (2017)	NA	NA*	> (t-1) (tendencë në rritje)	NA*
IV) Përmirësimi i buxhetit vjetor dhe procesit dhe dokumentacionit të PBA-së për të rritur besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e planifikimit afatmesëm.	IVa) Totali i shpenzimeve të planifikuara për KPBA miratur në vitin n/total i shpenzimeve të planifikuara në vitin n në buxhetin vjetor.		0.78% (2018)	-0.14%	22.8% (2020)	< (t-1) (tendencë në rënie)	2.5%
	IVb) Realizimi faktik i shpenzimeve sipas funksionit (PEFA PI-2, 2.1)		D (2017)	B	B	C	B
V) Përmirësimi i Mbikqyrjes së Menaxhimit të Investimeve Publike	Va) Pjesa e projekteve të investimeve publike që janë propozuar bazuar tek prioritetet strategjike të qeverisë (vlera e projekteve për vitin specifik)		64% (2018)	78%	82%	> (t-1) (tendencë në rritje)	90.5%
	Vb) Disbursimet aktuale për projektet e mëdha të investimit krahasuar me disbursimet e planifikuara shoqëruar me shpjegimet përkatëse në rastet kur ka		97% (2018)	97%	95%	97%	99.0%
	Vc) Raporti i investimeve të reja publike të dorëzuara në ciklin e PBA kundrejt totalit të investimeve të reja publike të miratuara në një vit		30.38%	28.90%	46.35%	> (t-1) (tendencë në rritje)	72.4%
VI) Forcimi i menaxhimit financiar në qeverinë vendore	VIa) Normat e mbledhjes së tatimeve (RLGRG)		4.62%	5.6%	-4.90%	15.7% (fact 2021/2020)	21.3%
	VIb) Niveli vendor PEFA PI-22.1 Stoku i detyrimeve të prapambetura		6.8 mld lekë (2018)/ 49.6 mld leke (13.7 %)	8.1 mld lekë/ 56.2 mld leke (14.4 %)	6.9 bln ALL/51.6 billion ALL (13.3%)	3.5 bln ALL/56.8 bln ALL (6.1%)	6.5 bln ALL/52.583 bln ALL (12.3%)

Tabela 3: Rezultatet kryesore dhe treguesit e performancës për OS 3 “Mbledhja e të ardhurave”

Rezultati	Treguesi i performancës	Institucioni lider	Vlera bazë	Vlera Faktike VF 2019	Vlera Faktike VF 2020	Vlera e synuar VF 2021	Vlera faktike VF 2021
VII) Rritja e nivelit të të ardhurave nga tatimi	VIIa) Baza e tatimit të bizneseve	DP Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale	112 428 biznese (2017)	113 829 (+1.24%)	47.6% (165,955 biznese në 2020)		62.4% (182,632 biznese në 2021)
	VIIb) % e mbledhjes faktike të tatimeve në vitin N /mbledhja faktike në vitin N-1 -100% (nga tatimet)		>0	259.462 milion Lekë(PBB,in 2019) (5.23%)	-7.20%	12.0%	14.5%
	VIIc) Përpjestimi i borxhit të tatimit të mbledhur në vitin N kundrejt shumës së prapambetur të detyrimeve tatimore		63%	74.00%	78.39%	62%	62.7%
VIII) Ulja e informalitetit nga rritja e vet-deklarimit dhe rritje e forcës së kontrollit të zbulimit	VIIIa) Raporti i deklarimeve tatimore kundrejt vitit paraardhës		6.60%	3.48%	2.21% (2,876,202 të kthyer në 2020, vs 2,814,005 në 2019)	< 0%	-8.08% (2,641,559 të kthyer në 2021 vs 2,876,202 në 2020)
IX) Kadastra fiskale tërësisht funksionale	IXa) Numri i ndërtesave të regjistruara dhe të faturuara		46.67% (2017) (700 000/1 500 000)	47.5% (570000/1200000)	80% (1 200 000/1 500 000)	86.7% 1 300 000/1 500 000	80% (1 200 000/1 500 000)
X) Rritje e nivelit të të ardhurave nga doganat	Xa) % e mbledhjes faktike të ardhurave doganore në vitin N /mbledhja faktike e të ardhurave doganore në vitin N-1 -100% (nga doganat)		>0	2.09%	-6.10%	9%	25.7%
	Xb) Koha e përpunimit të deklaratave doganore		(2018) 143.81	453 min/ deklarime	97	70	88

Tabela 4: Rezultatet kryesore dhe treguesit e performancës për OS 4 “Ekzekutimi efikas i buxhetit”

Rezultati	Treguesi i performancës	Institucioni lider	Vlera bazë	Vlera Faktike FY 2019	Vlera Faktike VF 2020	Vlera e synuar VF 2021	Vlera faktike VF 2021
XI) Zbatimi efikas i buxhetit me anë të përdorimit të Tl-së)	XIa) Shuma totale e buxhetit që është ekzekutuar me anë të SIFQ në raport me shumën totale të buxhetit të ekzekutuar nga qeveria qendrore.	DP e Thesarit	74% (2018)	75%	78%	≥ (t-1) (tendencë në rritje)	75.5%
XII) Detyrimet e prapambetura minimizohen	XIIa) PEFA 22.1. Stoku i shpenzimeve (detyrimet e prapambetura si përqindje e totalit të shpenzimeve për vitin fiskal)		nën 6% (B PEFA)	A	4.40%	nën 3%	nën 3% (2.2%)
	XIIb) PEFA 22.2 Monitorimi i detyrimeve të prapambetura të shpenzimeve (në SIFQ)		C (2017)	C	A	A (të dhënat jepen cdo tremujor, brenda 4 javëve në fund të secilit tremujor)	A (të dhënat jepen cdo tremujor, brenda 4 javëve në fund të secilit tremujor)
XIII) Ulet kostoja e huasë dhe likuiditeti është i disponueshëm kur nevojitet	XIIa) Stoku i borxhit të brendshëm të risistemuar brenda një viti		56.7%	50.90%	46.7	Max 48%	48.0%
	XIIb) Maturimi mesatar i borxhit të brendshëm		780 days	787 days	783	792 - 864 ditë	793
XIV) Rritet efikasiteti dhe transparencja e sistemit të prokurimit	XIVa) % në vlerë për procedurat e përfunduara me fitues brenda semestrit të parë kundrejt shumës së parashikuar në regjistrin e parashikimeve		22% (2018)	49.80%	47.4%	(tendencë në rritje)	60.2%
	XIVb) Përqindja e rasteve kur organi i shqyrtimit nuk ka respektuar afatet kohore të shqyrtimit të rastit		54.7%	16%	22.10%	≤ (t-1) (tendencë në ulje)	10.8%

Tabela 5: Rezultatet kryesore dhe treguesit e performancës për OS 5 “Transparenca e Financave Publike”

Rezultati	Treguesi i performancës	Institucioni lider	Vlera bazë	Vlera Faktike VF 2019	Vlera faktike VF20	Vlera e synuar VF 2021	Vlera faktike VF2021
XV) Fuqëzim i sistemeve dhe kapaciteteve për të përgatitur statistikat financiare të qeverisë sipas standardeve ndërkombëtare	XVa) Përgatitja e llogarive kombëtare të qeverisë sipas metodologjisë ndërkombëtare (ISA 20210)	INSTAT	50% (2018)	75%	75%	75.0%	75.0%
XVI) Llogaridhënia dhe transparenca me anë të raportimit të performancës financiare dhe jo-financiare është rritur	XVIa) Publikimi i raporteve financiare vjetore dhe atyre gjatë vitit përmbajnë informacion për performancën finan-ciare dhe jo-financiare, përfshirë TKP-të	DMB	janë përgatitur formate të reja për RZVB & te gjatë vitit	Janë implementuar formate të reja		25.0%	25.6%
XVII) Ofrohen mundësi formale për pjesëmarrjen e publikut në procesin e buxhetit	XVIIa) Vlerësimi nga Indeksi për Buxhetin e Hapur (Pjesëmarrja e Publikut)	DABP	2 out 100 (2017)	7/100	7 nga 100	≥ (t-1) (tendencë në rritje)	7 nga 100
XVIII) 'Prezantimi i pasqyrave financiare sipas kuadrit të përzgjedhur SNKSP"	XVIIIa) Kalimi në fazën ku pasqyrat financiare të qeverisë do të paraqesin kontabilitetin në bazë të drejtash dhe detyrimesh të konstatuara.	DHMFVK	0%	0%	0%	≥ (t-1) (tendencë në rritje)	10.0%
XIX) Përgatitja e regjistrimit të plotë të aktiveve të sektorit Publik bazuar në rregulloret e përmirësuara për vlerësimin dhe inventarin e këtyre aktiveve	XIXa) Aktivitet publike të regjistruara në SIFQ	DP Thesari	6 (2018)	6	3	5	0

Tabela 6: Rezultatet kryesore dhe treguesit e performancës për OS 6 “Kontroll i Brendshëm Efektiv”

Rezultati	Treguesi i Performancës	Institucioni i lider	Vlera bazë	Vlera faktike VF 2019	Vlera faktike VF 2020	Vlera e synuar VF 2021	Vlera faktike VF 2021
XX) Llogaridhënie efektive menaxhiale në të gjithë institucionet publike	XXa) Niveli i zbatimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në praktikë brenda institucioneve buxhetore	DPHKBFP	2.71 nga 4 (Urdhër i Ministrit të Financave nr. 117, datë 01.04.2019 Metodologjia e Monitorimit të Performancës)	2.4	2.56	>(t-1) (Tendencë në rritje)	2.61
	XXb) Mekanizmat për llogaridhënien menaxheriale në kuadrin rregullator	DPHKBFP	2.7 nga 4 (Urdhër i Ministrit të Financave nr. 117, datë 01.04.2019 Metodologjia e Monitorimit të Performancës)	2.5	2.90	>(t-1) (Tendencë në rritje)	2.95
XXI) Forcimi i funksionit të auditimit të brendshëm në sektorin publik	XXIa) % e rekomandimeve të zbatuara të auditimit të brendshëm	DPHKBFP	57% (2018)	60%	65%	>(t-1) (Tendencë në rritje)	62%
	XXIb) Kuadri për auditimin e brendshëm është harmonizuar me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm	DPHKBFP	Kuadri i auditimit të brendshëm nuk është plotësisht në përputhje me SNAB	Rishikimi i Manualit të AB	Është kryer analiza e hendeqeve	Kuadri ligjor është përditësuar	a) Është përgatitur versioni i parë i draft ligjit të rishikuar për AB b) Janë përditësuar 3 udhëzime për AB
	XXIc) % e rekomandimeve bazuar në sisteme që janë adresuar kundrejt numrit total të gjetjeve që janë adresuar	DPHKBFP	35% (2018)	37%	42%	>(t-1) (Tendencë në rritje)	67%
XXII) Inspektim financiar publik efikas	XXIIa) % e rekomandimeve të zbatuara të inspektimit financiar (të nxjerra me urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë)	DIFP	VF18 70%	83.30%	85%	>(t-1) (Tendencë në rritje)	88%

Tabela 7: Rezultatet kryesore dhe treguesit e performancës për OS 7 “Mbikëqyrja e jashtme efektive e financave publike”

Rezultati	Treguesi i Performancës	Institucion i lider	Vlera bazë	Vlera faktike VF 2019	Vlera faktike VF 2020	Vlera e synuar VF 2021	Vlera faktike VF 2021
XXIII) Përmirësimi i mëtejshëm i auditimit të jashtëm për të rritur sa më shumë vlerat dhe përfitimin e tij në shoqëri	*XXIIIa) % e rekomandimeve të pranura dhe të zbatuara të auditimit nga subjektet a audituara	KLSH	N pr 2017 = 93% N zb 2017 = 50,5 %	N pr 2018= 95% N zb 2018= 52.2 %	N pr:94% N zb:47%	N pr: ≥ t-1 (Tendencë në rritje) N zb: ≥ t-1 (Tendencë në rritje)	N pr: 93% N zb: 55%
